REJ
BREDBËRI

451° FAHRENHAJT

(Vitet e Feniksit)

roman fantastik

E përktheu
PIRO MISHA

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Titulli i origjinalit:

Ray Bradbury
FAHRENHEIT 451°

Redaktor
JORGJI DOKSANI

PARATHËNJE

Një roman fantastik, me një titull enigmatik «451° fahrenhajt», që të lë shkas ta çosh mendjen në ca botëra të tjera të largëta, të çuditshme, të avullta, por ku në të vërtetë s'bëhet fjalë as për pyje e as për njerëz të ardhur nga planetë të tjerë, por veç për një shoqëri njerëzore të përçudnuar, sa fantastike, aq edhe të njohur e reale. I botuar në vitin 1953, në klimën e histerisë makartiste, ky roman tronditi publikun amerikan, i cili pa aty, si në një pasqyrë magjike, një të ardhme, farat e së cilës dukej shkoqur se si kishin nisur të mugullonin në gjirin e shoqërisë amerikane, dëgjoi aty të kumbonte fort një thirrje alarmi, një britmë e hidhur, e dhimbshme paralajmërimi, për t'i bërë njerëzit të kuptonin e të mbronin ato vlera kulturore, shpirtërore që njerëzimit i është dashur shekuj që t'i krijojë.

I quajtur si roman fantastik-shkencor, por që në të vërtetë qëndron në skaj të kësaj gjinie, në vijim të asaj tradite të shquar veprash fantastike e njëkohësisht plotësisht realiste, si: «Utopia» e Tomas Morit, «Historia

komike e shteteve dhe e mbretërive të hënës» të Sirano dë Berzherakut, «Udhëtimet e Guliverit» të Suiftit, «Makina e kohës» e H. Uellsit, për të përmendur vetëm disa, ky roman i shkrimtarit amerikan Rei Bredbëri (1920), një ndër emrat më të shquar sot në këtë zhanër, nuk kërkon as të zbavitë me ca fluturime të lezetshme në fantazi, as të parashikojë të materializuara aspiratat e njeriut për të çuar më tej arritjet e shkencës e të teknikës, por mundohet të krijojë një tablo sa më prekëse, sa më tronditëse, të një shoqërie, që të jetë një projektim në të ardhmen, në një sfond deri diku fantastik, i problemeve, halleve, shqetësimeve, frikërave e dhimbjeve të shoqërisë konkrete ku vetë autori jeton. «Një ëndërr e makthshme, por që fatkeqësisht, ja shiheni vetë, s'është larg nga realiteti!» — duket sikur do të thotë autori.

Kjo botë e automatizuar, e superautomatizuar, kjo shoqëri që nuk synon veçse të krijojë manekinë, kukulla të kurdisura, njerëz të bindur se gjithçka shkon në rregull, se janë të lumtur, se jetojnë në më të mirën e botëve, e cila s'mund të jetë kurrsesi ndryshe, që pranojnë pa vënë për asnjë çast në dyshim gjithë ç'u serviret, se, në fund të fundit, e dinë mirë se dënohet rreptë e pa mëshirë gjithkush që merr guximin të çojë qoftë edhe në mend se ekziston dhe ana e kundërt e medaljes, se ndarja e së mirës dhe e së keqes s'është bërë tamam ashtu siç duhet. Një shoqëri ku gjithçka lëviz në një vërtitje të marrë, pa pauza për të menduar, pa asnjë grimë të lirë për të shkëmbyer dy fjalë më nge, për të shprehur një mendim, për të menduar me kokën e vet. Dhe mbi gjithë qytetin, mbi gjithkënd, «një tru i përgjithshëm» që s'resht së derdhuri fjalë, imazhe, ngjyra, tinguj, që të lajë trurin e njerëzve nga çdo gjë që del jashtë kuadrit, jashtë skemës së përcaktuar.

Një shoqëri ku është plotësisht e ndaluar të mbash libra, të lexosh libra, dhe ndaj është krijuar ai organ i gjithfuqishëm dhune, frike, veç për të nuhatur, për të gjurmuar, për të ndjekur, për t'u vënë zjarrin li-

brave, bibliotekave, që prej tyre, prej asaj që është shkruar në ta, të mos mbetë asnjë shenjë, asnjë kujtim, i cili të mund të turbullojë, «të minojë» atë organizim aq të «përkryer», që në thelb të vet ka, së pari, synimin që të mos lejojë kurrsesi njerëzit të mendojnë vetë, me kokën e tyre, t'i bëjë ata të gjithë të njëllojtë, robotë të kataloguar, që të vënë në lëvizje ingranazhet e makinës së madhe të sistemit shfrytëzues, t'i kanalizojë mendjet vetëm në ato drejtime që nuk sjellin asnjë rrezik për autoritetet.

«Le të bëhen njerëzit të ngjashëm me njëri-tjetrin, sì dy pika uji, paskëtaj të gjithë do të jenë të lumtur, sepse s'ke më male përpara, që, mjaft që t'i shohësh, që të të lërë zemra, s'ke më male me të cilat je i detyruar të vesh e të matësh shtatin tënd! Ja pse një libër në shtëpinë e komshiut është njëlloj si një pushkë e ngrehur kundër teje. Atëherë t'i hedhim në zjarr! Ta bëjmë këtë armë të padëmshme. T'ia tredhim mendjen njeriut. E kush e merr dot vesh se ç'synime ka një njeri i mësuar?» — siç shprehet në libër Biti, kapiteni i skuadrës së zjarrvënësve, zëdhënësi i ideologjisë, i mentalitetit të sistemit.

Ndaj dhe në themel të shoqërisë s'është krijimi, por shkatërrimi. Ndaj dhe zjarri s'është më dritë, por, së pari, është spastrim, siç po shprehet Biti. Dhe zjarri është protagonist i rëndësishëm dhe bashkë me të edhe librat. Dhe vetë titulli enigmatik që ka romani «451° fahrenhait» shpreh pikërisht këtë bashkim të panatyrshëm të zjarrit me librin, se në të vërtetë ai nuk do të tregojë gjë tjetër por veç temperaturën në të cilën digjet letra, digjen librat.

Libri, si simbol, si mbartës i trashëgimisë shpirtërore, kulturore të brezave, si mjet shprehjeje mendimi, komunikimi mendimi, është shpallur i rrezikshëm, pengesë që duhet spastruar. Dhe këtu është me vend të hapet një parantezë.

Duke lexuar një historik të shkurtër të zhvillimit të librit, e kupton pse Rei Bredbëri ka zgjedhur pikërisht librin si strumbullarin prej ku nis vërtitja,

shpështjellja e gjithë asaj tabloje që ai do të paraqesë. Të citojmë një pjesë nga një kronikë e vjetër kineze:

«Në Kinë, në vitin 213 p.e.r., princi Çeng dha urdhër dhe vrau brenda një dite të vetme 470 letrarë, e dogji çdo libër, me përjashtim të teksteve të mjekësisë, të bujqësisë dhe të profecisë. Ata pak studiues që shpëtuan pa u kapur e pa u masakruar, në ato ditë terrori, që shihnin ushtarët dhe spiunët të vënë në kërkim të librave të lashtë e të letrarëve, që t'i arrestonin, t'i vrisnin apo t'i dënonin me punë të detyruar në Murin e Madh, u përpoqën të fshihnin e të shpëtonin tekstet më të vyera... Të tjerë, në syrgjyn apo që kishin marrë arratinë, zunë të rishkruanin ato pjesë që i kishin mësuar përmendsh, pasi i kishin lexuar kushedi sa herë...» Dhe më pas, le të përmendim 10 marsin 1933, kur një turmë prej 40.000 vetash brohoriste në sheshin e Universitetit të Berlinit djegien publike të 25.000 vëllimeve, mes të cilave veprat e Marksit, e Hajnes, Ajnshtajnit, T. Manit, Drajzerit, Londonit, Barbysit etj. etj.

Ajo që parashikon Bredbëri, s'është thjesht një fantazi, por i ka rrënjët thellë në kohë, në të gjitha ato periudha kur njerëzimi ka vuajtur më ligsht nga errësira, nga injoranca në pushtet.

Por gjithnjë në fund të fundit njerëzimi, përparimtarja, libri, kultura kanë mbijetuar, kanë fituar, dhe ndaj edhe Bredbëri është optimist, ashtu turbullt, pa kuptuar as vetë shumë gjëra, por, sidoqoftë, pa e humbur besimin në të ardhmen.

Dhe ja pikërisht nëpër këtë skenë rrugësh të zbrazëta, pallatesh të larta, nën ulurimën e përhershme të aeroplanëve reaktivë, nën vërshimin e tingujve e ngjyrave, e fjalëve boshe të pareteve televizive, nën ndriçimin e kobshëm të flakëve, lëviz një njeri, heroi i romanit, Gaj Montagu, anëtar i organeve të zjarrvënësve të Los Anxhelosit. Një njeri si gjithë të tjerët, që ka jetuar i qetë në mes të kësaj shoqërie, ka kryer normalisht e pa vrarje ndërgjegjeje detyrën e tij si zjarrvënës i librave e bashkë me ta të shtëpive të atyre që

i fshehin, se e di se ashtu si ai mendojnë edhe gjithë kolegët e tij, mendon rrethi i tij, mendon gruaja e tij: se me atë punë ka arritur të sigurojë për vete e për gruan njëfarë komforti, një jetë në dukje pa andralla, që ngjan aq shumë me jetën e gjithë të tjerëve, që madje ndihet krenar për punën që bën, se ajo i jep një ndjenjë fuqie përmbi të tjerët. Një njeri që s'bën pyetje, se përgjigjet i ka gjithnjë aty të gatshme, si të bëra me porosi.

Me një fjalë, një njeri që simbas mendimit të tij jeton i lumtur si gjithë të tjerët.

Por ja, një ditë befas gjithçka ndryshon, në jetën e tij ndodh një tronditje. Befas «u ndje një zhurmë e mbytur, sikur u shemb e u bë copë e çikë një ëndërr e sajuar me kristal, me pasqyra e prizma prej kuarci.»

Mbase duhej ajo diçka fare e vogël, fare e parëndësishme në dukje, ai takim me një vajzë, të ndryshme nga të tjerët, me emrin Klarisa, së cilës i pëlqente të shëtiste natën, të kundronte yjet e hënën, të prekte barin e t'u merrte erë luleve, të ndiente shiun mbi fytyrë, të qeshte e të mendonte, duheshin të gjitha këto që të çahej ajo cipa e brishtë që i kishte mbështjellë Montagut trurin, që prej aty të dilnin vërshimthi \ato dhjetëra ·dyshime, ,hamendje, ·ndjenja, 'mendime, gjysmë të fjetura, përgjysmë të formuara, përgjysmë të belbëzuara, të mbledhura aty pak nga pak e pa u ndier në vite. Dhe atëherë gjithçka nis e shpështillet vetëtimthi: gjithsej një javë zgjat gjithë ngjarja, një javë jetë, kur nis e fitohet një vetëdijë e re, e dhimbshme, e domosdoshme, çliruese. Një sërë situatash nëpër të cilat kalon Montagu që e tronditin, se tani nis e i sheh gjërat ndryshe, edhe punën e tij, edhe jetën në familje, edhe ato vlera që gjer dje kishin qenë aq të padiskutueshme. Dhe kështu nis rebelimi i tij, më tepër emocional, po ku veç pak e nga pak zënë e hyjnë mendimet, vetëdija e ngadalshme, sefte aq e turbullt, pastaj që kthjellohet, sikur një çikë e nga një çikë po qërohej pamja, po tretej mjegulla e atij po i hapeshin sytë. Dhe atëherë sheh se njerëzit për asgjë s'mendo-

jnë vetë, por i marrin të gjitha të gatshme, se ata s'thonë asgjë të re por veç përsëritnin atë ç'kanë dëgjuar, sheh se si ata në të vërtetë s'arrijnë të komunikojnë mes tyre, se në jetën e tyre diçka mungon e kështu nis e lind kureshtja për të lexuar librat, për të parë e për të gjykuar vetë se ç'është ajo që me aq fanatizëm mbahet e fshehur, ndalohet. Dhe pas kësaj, natyrshëm lind dëshira që të ndryshojë bashkë me veten edhe të tjerët, dhe botën ku jeton, sigurisht një dëshirë ashtu e turbullt, kaotike, anarkike, por njëkohësisht edhe si një vetëdijë se rebelimi kundër gjendjes është e vetmja mundësi jete të denjë, pavarësisht se s'e di as vetë se ç'do të sjellë e ardhmja. Dhe le të sjellim ndër mend skenën në shtëpinë e tij, me gruan e mikeshat e saj, ku Montagu i provokon, i gërvisht me poezinë që u lexon, e cila befas ka marrë trajtat e një arme të mprehtë, që çjerr atë maskë lumturie, që lë të duket pas saj gjithë zbrazëtia, kotësia, paqënd:ueshmëria, imoraliteti, një armë që prish baraspeshimin, që fut mendime, që vë në lëvizje trurin, i bën ato gra sqimatare të ndihen fatkeqe. Se ai mendon se vetëm duke i bërë të ndiejnë dhimbje, do të mund t'i bëjë ato ta çojnë shikimin në ca drejtime e vise gjer atëherë të panjohura, të shohin se si është jeta në të vërtetë, përtej asaj sfere të qelqtë, të shndritshme, ku janë futur, ku rrojnë.

Romani «451° fahrenhait» është një roman i ngjeshur me mendime, me ide, secila syresh ia vlen ta nxjerrësh në pah veçan e të flasësh për të gjërë e gjatë, se shpreh një të vërtetë të rëndësishme për kahet e zhvillimit të sotëm të shoqërisë kapitaliste, për atë makinë gjigante që përpunon mendjen e shpirtin e njeriut. Shkurtoni, ngjeshni. Përmbledhje e përmbledhjes. Pjesë të zgjedhura nga përmbledhjet e lëngut të lëngut. Fakte e probleme shoqërore. Një kolonë, dy fraza, një titull. Pas pak asgjë s'të mbetet më në tru! Truri i njeriut nis e vërtitet me aq shpejtësi, nën këtë shtytje të botuesve, shfrytëzuesve radiospekulatorëve, saqë forca centrifuge zhvendoset tutje, duke i shpërndarë të gjitha me-

ndimet e kota që s'vlejnë për gjë tjetër veçse për të humbur kohën!»

Dhe, siç thotë autori, kësisoj ecuria intelektuale e shekujve të fundit ka qenë nga çerdhja në universitet e që aty sërish në çerdhe.

Dhe që të mos arrihet kjo, ky roman është një thirrje, një demaskim, një paralajmërim, por jo, natyrisht, një rrugëzgjidhje. Se protesta e autorit mbetet gjithnjë më shumë në një plan etik. Është një thirrje që shoqëria njerëzore të ketë në themel të saj — ashtu si çdo njeri të ketë në themel të jetës së tij — dëshirën, shtytjen për të krijuar diçka dhe jo për të shkatërruar, për të prishur.

«Gjithkush duhet të lërë diçka pas vetes kur vdes. Qoftë një fëmijë o një libër, o një pikturë, o një shtëpi, o një mur, që e ka ngritur me duart e veta, një palë këpucë të qepura vetë. O një kopsht të mbjellë me djersën e tij. Me një fjalë, diçka që ta ketë prekur dora e tij, diçka për të cilën të na kujtojnë, kur ne të vdesim, që më pas, kur njerëzit të vështrojnë pemën e lulen që ne kemi mbjellë, të na gjejnë edhe ne vetë aty...» thotë Grenxhëri, një nga personazhet e librit, që kuptohet se shpreh kështu edhe mendimin e vetë autorit. Është një protestë për atë paradoks që zhvillimi i shkencës e i teknikës në vend që ta pasurojë e ta plotësojë njeriun, si qenia më e lartë në gjirin e natyrës, në shoqërinë kapitaliste e zhvesh atë nga tiparet më thelbësore, duke e shterpëzuar nga aftësitë e tij krijuese. Një protestë kundër «brain washing», lavazhit të trurit, që çdo amerikan e ndien çdo sekondë, çdo minutë, çdo orë ta rrethojë, ta depërtojë nëpërmjet atyre dhjetëra burimeve që përbëjnë propagandën e regjimit. Dhe vetëm kaq. Mesazhi i Rei Bredbërit s'shkon dot më tej. Ai është një kambanë alarmi për të zgjuar njerëzit, por jo një pishtar ndriçues.

PIRO MISHA

PJESA E PARË

VATRA DHE SALAMANDRA

Ç'qejf i madh ishte të vije zjarrin! Ç'gëzim i madh të shihje se si flakët gllabëronin gjithçka, t'i shihje sendet të nxira, të shndërruara. Mjaft që të prekte majën e bakërt të pompës, atë piton të stërmadh, që villte përmbi botë vajgurin e vet të helmtë, që të ndiente t'i regëtinte gjaku fort në tëmtha, që duart t'i bëheshin duart e një dirigjenti të panjohur, që po ekzekutonte simfonitë e flakëve dhe të zjarrit, që me to të bënte pluhur e hi gjithë gërmadhat e zhelet e shkrumbëzuara të historisë. Me numrin simbolik 451° në kaskën e rrasur thellë në kokë, me sytë që i flakërinin e i merrnin një ngjyrë portokalli, sa sillte ndër mend atë që do të ndodhte, ai shtypte sustën e ndezësit dhe ja, shtëpia niste e dridhej e tëra mes flakëve, që po e gllabëronin, që përskuqnin qiellin mbrëmësor e që pastaj vinin e zbeheshin derisa zhdukeshin fare, mbasi ta kishin fshirë nga faqja e dheut krejt shtëpinë. Ai ecte përmes një shakulline shkëndijëzash. Por veç, më shumë nga çdo gjë tjetër, ia kishte ënda të merrte një shkop e të trazonte me të prushin, ashtu siç bënte kur ishte fëmijë, ndërkohë që librat, duke rrahur ata krahë pëllumbi, jepnin shpirt në verandë a në kopshtijen e shtëpisë, çoheshin përpjetë në ca vorbulla të shndritshme, gjersa era, e nxirosur nga zjarri, i merrte e i shpinte tutje.

Një buzëqeshje e vrazhdë i ngriu Montagut në fytyrë. Ishte buzëqeshja — ngërdheshje që shfaqet te njerëzit kur zmbrapsen rrëmbimthi, që t'i shpëtojnë prekjes së përvëluar të flakëve.

E dinte fare mirë se si ai, ministrel[1]) i zjarrit, kur të kthehej në kazermën e zjarrvënësve, do të shihte veten në pasqyrë e do t'i shkelte syrin tërë kënaqësi shëmbëlltyrës së vet të nxirë nga bloza. Dhe më pas, në errësirë, duke e zënë gjumi, do ta ndiente ende atë buzëqeshje ngërdheshëse, që i tendoste çdo muskul të fytyrës, atë ngërdheshje që nuk zhdukej kurrë, që, me ç'mbante mend ai, kurrë ndonjëherë s'ishte ndarë nga fytyra.

Ai fshiu kaskën e zezë e të shndritshme dhe e vari; pastaj vari edhe veshjen antipirike dhe për një copë herë të gjatë u kënaq duke bërë dush; pastaj, me duart në xhepa e duke fërshëllyer, eci përmes katit të sipërm të shtëpisë së zjarrtarëve e u lëshua në vrimë. S'i hoqi duart nga xhepat, që të ndërpriste rënien, duke u kapur pas shtyllës së praruar, veçse në çastin e fundit, kur dukej sikur katastrofa s'shmangej dot më. Rrëshqiti kështu, gjersa, më së fundi, frenoi tërë zhurmë me thembra dhe u ndal mbi dyshemenë e katit të poshtëm.

Ishte mesnatë. Ai eci nëpër rrugën e shkretë dhe mori për nga metroja, ku i hipi një treni të heshtur me ajër të kompresuar, që shkau si një hije nëpër tubin e vajisur mirë për në brendësi të dheut, gjersa bashkë me një rrymë të fuqishme ajri të ngrohtë doli e u ndal para një shkalle vetëlëvizëse, të shtruar me ca pllaka ngjyrë kremi, e cila të shpinte lart, në sipërfaqe në një zonë të periferisë së qytetit.

Duke fërshëllyer, ai priti gjersa shkalla vetëlëvizëse ta ngjiste lart, në ajrin e amullt të natës, dhe pastaj mori drejtimin për aty ku kthehej rruga, pa e vrarë mendjen për asgjë. Por ende s'kishte mbërri-

---

1) Këngëtar dhe poet endacak i mesjetës në Francë dhe në Angli.

tur te kthesa e rrugës, kur ja ku e ngadalësoi çapin, sikur befas nga kushedi se ku të qe çuar një erë e madhe, sikur dikush ta kishte thirrur në emër.

Pikërisht tek kalonte në atë trotuar, aty pas qoshes, pikërisht aty ku, nën ndriçimin e yjeve, ai merrte udhën e shtëpisë, kishte disa net që seç e pushtonte një ndjenjë e turbullt dhe e çuditshme. Sesi i bëhej sikur një grimë para se ai të merrte kthesën sekush kishte qenë aty. Sesi i dukej ajri i ngarkuar me një qetësi të veçantë, tamam sikur dikush të kishte qenë aty duke ndenjur në pritje e në heshtje e vetëm atëherë, një grimë para se të dukej ai, qe shndërruar në një hije, që ta linte atë të kalonte. Mbase ngaqë flegrat e tij seç ndienin aty një aromë të lehtë, mbase ngaqë lëkura e duarve dhe e fytyrës seç ndiente një si ngritje të lehtë të temperaturës në atë vend, që e kishte shkaktuar me nxehtësinë e trupit të vet dikush që kishte qenë aty. Këtë ai s'arrinte dot ta merrte vesh. E megjithatë, sa herë që kthente atë qoshe, s'shikonte veçse trotuarin e bardhë, të shkretë e të lakuar, ku ndoshta një grimë më parë diçka do të kishte pasur, por që tani qe zhdukur me të shpejtë tej, në një lëndinë, në mes të territ të natës, para se ai të kishte pasur kohë t'i thoshte një fjalë a t'i hidhte një sy.

Por kësaj nate ai e ngadalësoi hapin aq shumë, sa thuajse u ndal fare në vend. Me mendjen e vet ai ndodhej tani mbas qoshes dhe ndiente aty një fëshfërimë të lehtë. Dikë që merrte frymë! Apo mos vallë s'qe veçse një tendosje e ajrit nga ai dikushi, që qëndronte e po priste i heshtur aty pas qoshes?

Ktheu qoshen.

Në trotuarin e ndriçuar nga drita e hënës, era ndiqte pas gjethet e vjeshtës, aq sa të dukej sikur ajo vajza që po ecte mbi të në të vërtetë nuk shkelte përmbi pllaka, por qe ngulur në atë pistë të lëvizshme, e shtyrë pas nga era e nga gjethet. Kokën e mbante paksa të përkulur, për të vërejtur më mirë se si majat e këpucëve trazonin gjethet, fytyrën e kishte të brishtë e me një bardhësi qumështi, të ndriçuar nga

një kureshtje e çiltër dhe e pashuar. Seç kishte në fytyrë një shprehje të zbehtë, të habitur, kurse sytë e saj të zinj dukej sikur e vështronin botën me aq ngulm, sa të thoshe se atyre s'u shpëtonte dot gjë prej gjëje. Kishte veshur një fustan të bardhë, që vazhdimisht fëshfëriste. Atij iu bë sikur atë çast, ja, po dëgjonte se si i lëviznin asaj duart, tek ndiqnin hapat, po dëgjonte atë zhurmë gati të pakapshme për veshin, që bëri ai zbardhëllim e ajo dridhje e lehtë e fytyrës së saj, kur ajo befas çoi kokën, ngaqë ndjeu aq afër praninë e një burri, që ishte ndalur dhe po e priste në mes të rrugës.

Përmbi ta drurët lëshuan një zhurmë të madhe, si të bëheshin gati të zhvisheshin e të lëshonin përposh një shi gjethesh të thara.

Vajza u ndal në vend si e shtangur, e për një çast u duk sikur donte të zmbrapsej, por, megjithatë, prapë s'luajti nga vendi: ajo vazhdoi të vështronte ngultazi Montagun, me ata sytë e saj aq të zinj, aq të shndritshëm, aq të gjallë, saqë atij iu bë sikur i kishte thënë diçka tepër të bukur që të meritonte atë shikim. Por në të vërtetë e dinte fare mirë se goja e tij s'qe hapur veçse për të shqiptuar atë përshëndetje të thjeshtë «mirëmbrëma». Dhe pastaj, kur pa se si ajo ia kishte ngulur sytë e po shihte si e hipnotizuar salamandrën, që ai kishte të vizatuar në mëngën e bluzës, dhe diskun me feniksin, që kishte mbi gjoks, Montagu i tha:

— Besoj se ju jeni fqinja jonë e re, apo jo?

— Po ju, me sa duket... — ajo, më në fund, i shkëputi sytë nga emblema e profesionit të tij, — me sa duket, ju jeni njeriu i zjarreve, pirofili, — zëri i saj pak nga pak u shua.

Me ç'ton të çuditshëm që e thatë.

— Unë do t'ju kisha njohur... edhe sikur me sy mbyllur të kisha qenë, — foli ajo ngadalë.

— E qysh? Apo ndoshta nga era e vajgurit. Ime shoqe gjithnjë më ankohet se kundërmoj era vaj-

guri, — tha ai me të qeshur. — Sa do të lahesh, prapë s'të ikën që s'të ikën.

— Po, ashtu është vërtet, nuk ikën kurrë, — tha ajo dhe në zërin e saj u ndje drojë.

Ai pati përshtypjen sikur ajo po i vinte rrotull, duke e detyruar edhe atë të vërtitej nga të gjitha anët, sikur po e shkundte ashtu lehtë-lehtë e ëmbël-ëmbël e po i zbraste xhepat, megjithëse në të vërtetë gjatë gjithë kësaj kohe ajo s'kishte luajtur fare nga vendi.

— Era e vajgurit, — filloi prapë ai të fliste, meqë heshtja po zgjaste si tepër, — është bërë tani për mua aroma më e këndshme që ekziston në botë.

— Vërtet? Vërtet e thoni?

— Oh, sigurisht. Pse ju duket kaq e çuditshme?

— Nuk e di, — ajo u kthye dhe pa trotuarin, që vijonte gjer te shtëpitë e tyre. — Nuk ju shqetësoj po të vij me ju gjer te shtëpia? Mua më quajnë Klarisa Maklellën.

— Klarisa. Kurse mua Gaj Montag. Eja, shkojmë. Po ç'bëni kështu rrugës kaq vonë natën? Sa vjeç jeni?

Nisën të ecnin përmes natës. Frynte një erë e vakët përmbi rrugën e argjendtë, e atij iu bë sikur në ajër seç ndihej një aromë thuajse e pakapshme kajsish e luleshtrydhesh, por, kur pa përqark, e kuptoi se në atë stinë që ishin s'kishte si të ishte e mundur.

Aty ishte vetëm ajo vajzë, që tani po i ecte në krah, me fytyrën që i shndriste si dëbora nën rrezet e hënës, dhe atë çast ai e kuptoi se gjatë tërë kësaj kohe ajo po bluante në mendje ato pyetje që i kishte bërë ai, ngaqë donte t'u përgjigjej sa më mirë.

— Ja pra, — nisi të fliste vajza, — jam shtatëmbëdhjetë vjeç e jam e çmendur. Xhaxhai im thotë se këto janë dy gjëra që shkojnë gjithnjë mirë bashkë. Kur të të pyesë njeri se sa vjeç je, më ka thënë ai, thuaji gjithmonë se je shtatëmbëdhjetë e se je e çmendur. Le që pastaj, a nuk të duket kjo një orë e bukur për të dalë shëtitje natën? Mua më pëlqen të ndiej aromën e gjërave, t'i shoh se si janë bërë e ngandonjëherë ndodh

që bredh, ja, kështu, si tani, tërë natën e natës, që të shoh pastaj se si lind dielli.

Vazhduan të ecnin ashtu, në heshtje, gjersa, më në fund, ajo foli, si të dilte ashtu nga ca mendime të thella fort:

— E di? Unë nuk kam frikë fare nga ju.

Ai mbeti i habitur.

— E pse të më kesh frikë?

— Uh, shumë njerëz ju kanë frikë. Desha të thosha, kanë frikë nga zjarrtarët. Por, fundja, edhe ju s'jeni veçse një njeri si të gjithë të tjerët...

Në sytë e saj ai pa shëmbëlltyrën e vetes, si në dy pikëza të shndritshme e vezulluese uji, e pa veten aq të zvogëluar e të errësuar, por veç me të gjithë hollësitë, gjer tek ato rrudhëzat në cepat e buzëve, si të qenë ata dy sy dy copëza qelibari ngjyrë vjollce, me aftësinë magjike të kapnin atë vetë e ta mbanim të mbyllur aty brenda. Fytyra e saj, një kristal i brishtë qumështi, e ndriçuar nga brenda nga një dritë e shkrifët, e pandërprerë, ishte kthyer tani nga ai. S'ishte ndriçimi i ethshëm i elektrikut... ç'të ishte vallë? Një ndriçim kaq çuditërisht prekës, i rrallë, i këndshëm, me këtë butësi ledhatuese prej flake qiriri. Njëherë, kur kishte qenë fëmijë, ishin prerë dritat dhe e ëma se nga kishte gjetur e kishte ndezur qiririn e fundit që kishin pasur, dhe atëherë kishin kaluar një orë të shkurtër, të mbushur plot me zbulime, duke e ndier veten përbrenda aq shumë të ndriçuar, ndërsa hapësira përreth e kishte humbur tërë atë stërmadhësinë e saj e butë-butë ishte mbledhur rreth tyre, përqark atyre të dyve, nënë e bir, që, ashtu të shndërruar, kishin zënë të shpresonin se mos drita elektrike do të vonohej edhe ca...

Befas Klarisa Maklellëni tha:

— A mund t'ju bëj një pyetje? Sa kohë keni që punoni me zjarret?

— Që dhjetë vjet më parë, kur isha njëzet vjeç.

— Asnjëherë nuk lexon ndonjë nga ata librat që djeg?

Ai zuri të qeshte.

— Po një gjë e tillë është e kundërligjshme!

— Oh, po, natyrisht.

— E dini që është një punë e bukur. Të hënën djeg yjet e poezisë, të mërkurën Melvilin, të premten Uitmanin, i bën hi e pastaj, po deshe, u djeg edhe vetë hirin. Kjo është edhe motoja jonë profesionale.

Vazhduan të ecnin në heshtje, gjersa, më në fund, vajza pyeti:

— A është e vërtetë se shumë kohë më parë ka pasur zjarrfikës e jo zjarrvënës.

— Jo, kjo s'është veçse një legjendë. Shtëpitë kanë qenë gjithmonë të padjegshme, për këtë më beso mua.

— Është për t'u çuditur. Unë kam dëgjuar që shumë e shumë kohë më parë shtëpitë merrnin flakë nga ndonjë pakujdesi, dhe atëherë vinin zjarrfikësit, që të shuanin zjarrin.

Montagu nisi të qeshte.

Ajo ktheu kokën me vrull nga ai.

— Përse qeshni?

— Nuk e di, — ai ia plasi përsëri të qeshurit, por pastaj befas heshti. — Përse qesh?

— Unë nuk e marr vesh, ju qeshni, megjithëse unë s'thashë asgjë për të qeshur. Kurse përgjigjen e keni gjithnjë në majë të gjuhës, pa e marrë mundimin ta vrisni një fije mendjen për ato gjëra që unë ju pyes.

Montagu u ndal menjëherë në vend.

— Qenkeni një vajzë shumë e çuditshme, — i tha ai duke e vështruar me ngulm. — Nuk paskeni pikën e respektit për bashkëfolësin.

— Unë s'doja t'ju fyeja. Vetëm se mua më pëlqen shumë të vërej se si janë njerëzit, ja kjo është e gjitha.

— E po mirë, po kjo s'do të thotë asgjë për ty? — Dhe rrahu me majën e gishtit numrin 451°, që e kishte të qepur mbi mëngën e hirtë të xhakaventos.

— Oh, natyrisht që po, — murmuriti ajo dhe shpejtoi hapin.

— A keni parë ndonjëherë se me ç'shpejtësi ma-

rramendëse shkojnë tek ajo rrugë aty automobilat reaktivë?

— Tani po ndërroni bisedë, më duket!

— Herë-herë zë e dyshoj se automobilistët as që e kanë idenë se ç'është bari, as që dinë se si janë bërë lulet, sepse as që kanë kaluar ndonjëherë ngadalë pranë tyre, që të mund t'i shohin. Tregoji një automobilisti një njollë të gjelbër, e ai do t'ju thotë: «Oh, po, ky është bar!» Tregoji një njollë ngjyrë rozë, e do të thotë se është një trëndafilishte, njollat e bardha janë për të shtëpi, kurse ato ngjyrë gështenje lopë që kullosin. Tim ungj e zunë njëherë tek po e ngiste makinën ngadalë në një autostradë, me gjashtëdhjetë kilometra në orë, dhe e mbajtën dy ditë në burg. A nuk është për të qeshur, por dhe ca e trishtuar ama, po ta mendosh mirë?

— Ju e vrisni mendjen shumë, — foli Montagu ca si me pahir.

— Unë shumë rrallë shoh programe televizioni, rrallë shkoj në garat a në parqet e argëtimit. Kështu që më mbetet gjithë ajo kohë për të menduar edhe për gjërat më të çuditshme. I keni parë ndonjëherë ato pankartat e reklamave të larta sa dhe qiellgërvishtësit, buzë autostradave, në të dalë të qytetit? E dini që njëherë e një kohë pankartat ishin të shumtën — të shumtën nja pesë a gjashtë metra të larta? Por më pas makinat zunë të ecnin aqë shpejt, saqë u bë e nevojshme të shtohej sipërfaqja e reklamave, në mënyrë që automobilistët, kur kalonin rrugës, të kishin mundësi t'i lexonin.

— Ja, këtë nuk e dija! — Dhe Montagu ia plasi befas të qeshurit.

— Por ka edhe gjëra të tjera që unë i di e ju s'i dini. Për shembull, që në mëngjes herët bari është i mbuluar me vesë.

Pavaritur Montagu pa se s'ishte në gjendje të sillte ndër mend nëse e kishte ditur ndonjëherë këtë gjë apo jo, dhe kjo gjë e nervozoi.

— Dhe, po ta vëresh mirë, — dhe ajo tregoi me dorë qiellin, — edhe hëna ka fytyrë njeriu.

Kishte kaluar kushedi se sa kohë që kur ai s'e kishte parë hënën. Pjesën tjetër të rrugës e bënë pa folur, ajo heshtte e kredhur në mendime, atij i vinte inat me veten se i dukej vetja e ngathët sa më s'bëhej, ndërsa kohë më kohë hidhte nga ajo vështrime qortuese.

Kur mbërritën para shtëpisë së vajzës, panë se ajo i kishte të gjitha dritat brenda të ndezura.

— Ç'po ndodh këtu? — Rrallëherë kishte parë Montagu kaq shumë drita të ndezura në një shtëpi.

— Oh! Asgjë! Ja, babai, mamaja e xhaxhai janë ende zgjuar e bisedojnë. Kjo tani është bërë një gjë aq e rrallë, saqë është njëlloj, bile edhe më e pazakontë, sesa të ecësh në këmbë. A ta thashë se tim ungj e kanë arrestuar edhe njëherë ngaqë... e gjetën duke ecur në këmbë? Oh, jemi njerëz të çuditshëm ne në familjen tonë!

— Ç'janë këto që thua?

Tani e pati radhën ajo që të qeshte.

— Natën e mirë! — Thirri ajo. Dhe hyri në rruginën që e shpinte në shtëpi. Por befas, duket, u kujtua për diçka, se u kthye nga ai dhe e pa me ngulm drejt e në fytyrë, tërë kureshtje e çudi njëherësh. — A jeni i lumtur? — e pyeti.

— Çfarë? Çfarë të jem? — i thirri ai nga ana e tij.

Por ndërkohë vajza kishte shkuar, po largohej me vrap nën dritën e hënës. Pastaj u dëgjua se si u mbyll pa zhurmë porta e shtëpisë së saj.

— Më pyeti nëse jam i lumtur! Ç'pyetje idiote!

Tani ai s'po qeshte më.

Futi dorën në boshllëkun në formë doreze të portës së shtëpisë dhe priti sa t'ia njihnin gishtërinjtë: pas pak porta u hap pa zhurmë.

— Natyrisht që jam i lumtur. Pse, ç'kujton ti, se s'jam? — pyeti ai muret e heshtura që kishte përreth.

U ndal dhe, pa e pasur shumë mendjen aty, ia kishte nguliur sytë grilës së ajrimit të paradhomës, dhe papritur, ja, iu kujtua diçka që ishte fshehur aty prapa asaj grile e që tani dukej sikur po e vështronte vjedhurazi prej andej. E largoi menjëherë shikimin prej aty.

Ç'takim i çuditshëm në një natë të tillë të çuditshme! S'mbante mend t'i kishte ndodhur ndonjëherë një gjë e tillë, veç një mbasditeje, vitin e shkuar, kur kishte takuar një plak në park e kishte bërë ca muhabet me të...

Montagu tundi kokën. Vështroi njërën nga faqet e zhveshura të murit e pa aty fytyrën e vajzës, ashtu siç i kishte mbetur në mend, me të vërtetë shumë e bukur, bile edhe më tepër se kaq, e mrekullueshme. Ajo kishte një fytyrë të hajthme, të ngjashme me fushën e një ore të vogël që e sheh ashtu turbull në një dhomë të errët, në mes të natës, kur çohesh për të parë sa është ora dhe sheh se si akrepat të tregojnë orët, minutat, sekondat; kjo fytyrë, që, me atë heshtjen e saj të bardhë, të ndriçuar, gjithë siguri e vetëdije, të thotë ty se nata po shkon me të shpejtë aty përtej, drejt terreve të mëtejshme, por njëkohësisht edhe drejt një dielli të ri.

— Çfarë? — pyeti Montagu atë unin tjetër, atë të shastisurën pavetëdije të tij, që kohë më kohë bëhej e pabindur me ato belbëzimet e saj, duke dërdëllitur pa pikën e vullnetit, të shprehisë e të arsyes. U kthye dhe prapë ia nguli sytë murit. Ishte vërtet e çuditshme sa i shëmbëllente fytyra e saj, veç të tjerash, pasqyrës. E çuditshme, e sa njerëz kishte njohur ai gjer tani që ta kishin këtë aftësi, që ta pasqyronin dritën që dilte prej teje e ta kthenin prapë te ti? Në më të shumtën, njerëzit ngjasonin — dhe ai kërkoi të gjente një krahasim, që e gjeti, më në fund, nga fusha e profesionit të tij — me pishtarët, të cilët flakërojnë duke u tretur, gjersa shuhen me një fërshëllimë të fundme.

Sa gjë e rrallë që ishte të shihje në fytyrat e të

tjerëve shëmbëlltyrën e vetes sate e të vëreje se si ato të kthenin po atë shprehjen tënde, po atë mendimin më të fshehtë e më të drithëruar!

E pabesueshme ishte aftësia e identifikimit që kishte ajo vajzë! Ishte njëlloj si ajo spektatorja e apasionuar në një shfaqje kukullash, që di përmendsh çdo rrahje qepalle, çdo gjest të dorës, çdo lëvizje gishti që do të ndodhë që para se të ketë nisur shfaqja. E sa kohë kishin ecur bashkë? Tri minuta, ja pesë? E megjithatë, sa shumë kohë dukej tani se kishte zgjatur ajo ecja e tyre!

Ç'figurë gjigante që ishte ajo në atë skenë që ai kishte parasysh, ç'hije të stërmadhe lëshonte mbi mur me atë trupthin e vet aq të brishtë! Montagu e ndiente se do të kishte mjaftuar që atij t'i kruhej pak syri, që ta shihte atë duke kapsallitur syrin. Dhe mjaft që atij sadopak t'i tendoseshin muskujt e nofullës, që ajo shumë më parë nga ai të gogësinte.

— Djalli e mori, — tha ai me vete. — Tani që e mendoj, më duket sikur ajo po rrinte e po më priste mua, aty në rrugë, në atë orë aq të vonë të natës!...

Hapi derën e dhomës së gjumit.

Ishte njëlloj si të hyje në sallën e ftohtë, të mermertë të një mauzoleu, pasi të ketë perënduar hëna. Terr i plotë, as edhe një shenjë nga ajo botë e argjendtë, që ishte përjashta. Dritaret qenë të mbyllura hermetikisht, dhoma e shndërruar në një botë varrimtare, ku as edhe një zhurmë nga ato të qytetit të madh s'hynte dot. Por dhoma s'ishte bosh.

Ai mbajti vesh.

Në ajër ndihej zukama e lehtë, vallëzuese e një mushkonje, murmurima e një grerëze elektrike të fshehur gjithë ëndje në atë folenë e vet të veçantë, të

ngrohtë e të trëndafiltë. Muzika ndihej aq mirë, sa mund të njihje motivin.

Montagu e ndjeu se si buzagazi i tij po shkoqej, po shkrinte, po rrudhej, si të ishte një cipë dhjami, si ajo lënda e një qiriu fantastik që ishte djegur e djegur për aq e aq kohë dhe ja, tani, duke u shembur edhe pak e do të fikej. Terr. Jo, ai s'ishte i lumtur. S'ishte i lumtur. E përsëriti prapë këtë fjalë me mend. E kuptoi edhe vetë se ashtu ishte vërtet. Lumturinë ai e kishte mbajtur si një maskë, dhe ajo vajzë kishte shkuar duke ia marrë atij maskën me vete, dhe tani ai s'kishte si shkonte të trokiste në portën e shtëpisë së saj, që t'ia kërkonte sërish.

Pa e ndezur fare dritën, e përfytyroi fare qartë pamjen e dhomës. E shoqja e shtrirë në shtrat, e zbuluar dhe e mbërdhirë, si një kufomë e nxjerrë mbi rrasën e një varri, me sytë e palëvizur, të ngulur në tavan, si me ca fije të padukshme çeliku. Kurse në vesh ato kapsulat e vogla, dy tubetat radiomarrës, që ishin futur mirë brenda veshit, dhe një oqean elektronik me tinguj, me muzikë, me fjalë, me muzikë e fjalë, që vinin, vinin e përplaseshin në atë plazhin e mendjes së saj të pagjumë. Dhoma ishte me të vërtetë si e zbrazët. Çdo natë atë vinin dhe e merrnin valët, që ta mbartnin me atë zbaticën e tyre kumbuese, duke e shtyrë ashtu me syhapur, duke e pluskuar përmbi valë, drejt mëngjesit. Prej vitesh nuk kishte natë që Mildredi të mos e lëshonte veten në rrjedhën e këtyre valëve, që ajo të mos kridhej në to tërë qejf për kushedi të satën herë.

Në dhomë bënte fresk, por ai nuk po ngopej dot me frymë. Nuk donte të ngrinte perdet e të hapte grilat, sepse nuk donte që në dhomë të hynte drita e hënës. Kështu që, në atë gjendje shpirtërore që ishte, si të atij njeriu që e di se brenda një ore ka për të vdekur i asfiksuar, shkoi tërë kujdes drejt shtratit të vet, që ishte i zbuluar, prandaj dhe i freskët.

Një grimë para se këmba t'i godiste atë send që qe mbi dysheme, ai e dinte se ashtu do të ndodhte. I-

shte një ndijim i afërt me atë që kishte provuar para se të merrte kthesën në rrugë, kur gati e për pak sa s'qe përplasur me vajzën. Lëvizjes së ajrit që shkaktoi këmba e tij, i bëri jehonë ajo pengesë e vogël që i kishte dalë përpara, madje para se këmba ta kishte goditur. Objekti lëshoi një tingëllimë të mbytur e rrëshqiti tutje, në errësirë.

Montagu ndenji në këmbë mes errësirës, si i ngrirë, duke mbajtur vesh gruan, që ishte në shtratin e zi, në atë natë, ku asgjë nuk shihej e shquhej. Fryma që i dilte nga hojëzat e hundës, ishte aq e venitur, sa mezi ndihej, mezi arrinte të trazonte atë pak jetë që ende regëtinte: një fletëzë, një pupël e zezë e një fijeje të vetme floku.

Por edhe tani ai prapë nuk e donte dritën që vinte nga jashtë.

Nxori çakmakun, shtypi salamandrën e skalitur mbi diskun e argjendtë; çakmaku u ndez me një shkrehje të beftë.

Dy kristalë e vështruan zbehtësisht që poshtë, në dritën e atij zjarri të vogël që ai mbante mes pëllëmbëve, dy gurë sedefi hënor të kredhur në një rrjedhë të thellë uji të tejdukshëm, ku jeta e botës s'arrinte dot.

— Mildred!

Fytyra e saj ishte një ishull i mbuluar me dëborë, mbi të cilin mund të binte shiu, por që ajo nuk do ta ndiente, një ishull mbi të cilin retë mund të hidhnin hijet e tyre vraparake, por që ajo nuk do t'i ndiente. Mbetej vetëm këngëzimi i grerëzave në tubetthat brenda veshëve të saj të tamponuar, kurse sytë e saj ishin të qelqtë, ndërkohë që fryma e saj shkonte e vinte e dobët, hynte e dilte nga hojëzat e hundës së gruas, e cila as që merrte vesh se ç'bëhej.

Ai sendi që sapo kishte flakur tutje me këmbë, tani po shndriste pikërisht nën buzën e shtratit. Ishte shishka e kristaltë e mbushur me hape për gjumë, tridhjetë hape për gjumë kishte pasur atë mbasdite, kurse tani, nën ndriçimin ledhatues të çakmakut, dukej si e shqyer dhe e zbrazët.

Dhe ndërkohë që burri qëndronte aty, i palëvizur, qielli përmbi shtëpi nisi të ulërinte. Që një zhurmë e tmerrshme, therëse, sikur dy duzr gjigante të kishin zënë të çirrnin nja dhjetë mijë milje çarçafë të zinj, që aty më parë kishin qenë të qepur bashkë. Montagu sikur u nda më dysh. E ndjeu gjoksin të hapur, të shqyer si nga goditje sqepari. Ishin bombarduesit reaktivë, që po kalonin përmbi kokën e tij, shkonin tutje, një dy, një dy, një dy, gjashtë bombardues, nëntë bombardues reaktivë, dymbëdhjetë bombardues, një një një, një tjetër, një tjetër, dhe që të gjithë i ulërinin atij. Ai hapi gojën dhe la që uturima e tyre të zbriste e t'i futej brenda dhëmbëve të skërmitur. E gjithë shtëpia u drodh. Drita iu shua në duar. Kristalet u zhdukën. Ndjeu që befas dora e tij u zgjat për nga telefoni.

Bombarduesit s'ndiheshin më. Ndjeu buzët që po i lëviznin tek i çikën mikrofonin e aparatit.

«Ndihma e shpejtë». Një përshpërimë ogurzezë.

Dukej sikur edhe vetë ajet ishin bërë pluhur nga zhurma e atyre avionëve reaktivë dhe në mëngjes toka do të mbulohej nga pluhuri i tyre, si nga një dëborë e çuditshme. E këto mendime të marra s'iu shkulën nga koka gjithë kohën që ai rrinte në këmbë e dridhej në errësirë, me ato buzë që vazhdonin t'i lëviznin e t'i lëviznin pareshtur.

Aparaturat i kishin me vete, dy copë. Njëra syresh shkiste e futej brenda në stomak, si një kobër e zezë që zbret në një pus kumbimmadh, që të kërkojë ujin e ndenjur, të mbledhur aty që në kohën më të lashtë. Thëthinte gjithë atë lëng të gjelbër, që niste të rridhte përsëri në sipërfaqe, duke vluar pa shumë zhurmë. Mos vallë po pinte ashtu edhe vetë terrin? A mos

thithte vallë ashtu edhe gjithë helmet e mbledhura me vite? Pinte në heshtje dhe herë-herë nxirrte një zhurmë sikur diçka mbytej aty përbrenda, në një qorollisje të verbër, duke kërkuar diçka. Aparati kishte edhe një sy. Njeriu, që krejt indiferent merrej me aparatin, mundte të këqyrte edhe vetë shpirtin e atij që po pomponte për ta rikthyer në jetë. Ç'shihte vallë ashtu syri? Ai nuk e tha. Shikonte, por atë që shihte syri, ai nuk e kishte parë. I gjithë ky operacion kishte diçka të ngjashme me hapjen e një kanali në kopshtin që ka nga prapa shtëpia. Gruaja përmbi shtrat s'qe veçse një copë e fortë mermeri, ku kishte ngecur shtati a beli.

Sidoqoftë, jepi, shtyje pengesën gjer në fund, bëj që të kthehet në sipërfaqe ajo zbrazëti e madhe, po qe se vërtet është e mundur që diçka e këtij lloji të dalë jashtë me anë të këtij pulsimi të drithëruar, të këtij gjarpri thëthinjës. Operatori rrinte në këmbë duke pirë një cigare. Edhe aparati tjetër po punonte.

Aparati tjetër manovrohej nga një tip po aq indiferent, i veshur me një palë tuta ngjyrë gështenje, nga ato që nuk njolloseshin. Ky aparat thithte me pompë gjithë gjakun e trupit dhe e zëvendësonte me gjak e plazmë të freskët.

— Duhet pastruar njëkohësisht stomaku dhe gjaku, — foli operatori, që rrinte në këmbë pranë gruas, që heshtte. — Po nuk pastrove gjakun, është e kotë të dezinfektosh stomakun. Po e le në gjak, të shkon drejt e në tru me forcën e një të goditure çekiçi: dang! Ca mijëra herë dhe ja, truri s'mban dot më, s'punon më, merr fund.

— E mjaft, pra! — tha Montagu.

— Fola sa për të thënë diçka, — iu përgjigj operatori.

— Mbaruat? — pyeti Montagu.

I shuan aparatet, të cilat heshtën me një vendosmëri të ftohtë.

— Mbaruam.

Zemërimi i tij as që u bënte atyre pikë përshty-

pje. I rrinin mu përpara, me atë tymin e cigareve, që u spërdridhej rrotull hundës, e pastaj vinte e u futej në sy, por, megjithatë, prapë s'kishte aq fuqi sa t'i bënte ata të pulisnin a të vëngëronin sytë.

— Pesëdhjetë dollarë.

— Para së gjithash, pa më thoni në do ta marrë dot veten plotësisht?

— Po, sigurisht që do ta marrë veten plotësisht. Gjithë këtë lëng vdekjeprurës që kemi në valixhe, tani ne po e marrim me vete, kështu që s'ka ç't'i bëjë më. Jua thashë edhe më parë, po hoqe gjithë lëngun e vjetër e ta zëvendësosh me të ri, s'ka sesi të mos jesh mirë.

— Asnjë nga ju të dy s'është mjek me profesion. Pse s'më dërgoi një mjek ndihma e shpejtë?

— Dreqi e mori! — Cigarja nisi të kërcente, ashtu e ngjitur pas buzës së operatorit. — Çdo natë kemi nja nëntë ose dhjetë raste të tilla. Ishin bërë aq të shpeshta aty e ca vjet më parë, kur enkas u ndërtuan këto aparate, këto me lentën optike, vetëkuptohet, se sa për të tjerat këto aparate s'kanë asgjë të re. Për raste të tilla as që është nevoja për mjek me patentë; s'është nevoja veçse për dy specialistë të këtyre aparateve, dy teknikë që të dinë të lajnë e të dezinfektojnë një trup brenda gjysmë ore, kurse tani, — dhe bëri të shkonte nga dera, — bëni durim, i duhet vetëm qetësi. Neve na duhet të shkojmë. Sapo pata një thirrje tjetër, me radion që kam brenda në vesh. Nja dhjetë blloqe ndërtesash më tutje. Do të jetë ndonjë tjetër që ka zbrazur tubetin e hapjeve. Po patët nevojë për ne, na thërrisni. Tani lëreni të flejë. I kemi futur në trup një antisedativ. Kur të zgjohet, do të ketë një uri ujku. Mirupafshim!

Dhe të dy burrat, me cigaret e ngulura në gojë, me ata sy të ftohtë nepërke, duke marrë ato aparatet e tubat e tyre, atë kasetën brenda së cilës mbanin melankolinë e lëngshme e atë masën e trashë e të errët, pa emër, dolën nga dhoma.

Montagu u lëshua mbi një kolltuk dhe vështroi

gruan. Ajo i kishte sytë të mbyllur, gjithë ëmbëlsi, dhe ai zgjati dorën drejt saj, që t'i ndiente në pëllëmbë ngrohtësinë e frymëmarrjes.

— Mildred, — tha ai, më në fund.

«Jemi tepër, — mendonte ndërkohë. — Jemi me miliarda qenie që jetojmë mbi këtë tokë, dhe kaq miliarda e miliarda sa janë bërë janë si tepër. As që njihemi mes nesh. Askush nuk e njeh tjetrin. Njerëz të panjohur vijnë e të dhunojnë intimitetin tënd. Të hyjnë në shtëpi e të shkulin zemrën nga gjoksi. Të thithin gjithë gjakun që ke. O zot i madh, cilët ishin ata njerëz? S'i kam parë kurrë ndonjëherë në jetën time!»

Kaloi gjysmë ore.

I ri ishte dhe fluksi i gjakut në rrembat e kësaj gruaje, që dukej sikur e kishte kthyer atë në një krijesë të re. Faqet i kishin marrë një ngjyrim të bukur, si prej trëndafili të posaçelur, buzët ngjyrë alle i kishte të njoma e të mbushura. Dukej që aty rridhte gjaku i një njeriu tjetër. Po sikur të kishte qenë edhe truri, mishi, kujtesa e një njeriu tjetër! Sikur të ishte e mundur që edhe mendja të pastrohej me pastrim kimik dhe, njëlloj siç zbrazje xhepat, ta laje edhe atë me avull, ta shpije ta pastroje e ta rregulloje dhe pastaj në mëngjes të vije e ta merrje prapë! Sikur të ishte...

U ngrit dhe, si largoi menjanë perdet, hapi dritaret, që të linte të hynte brenda ajri i natës. Ishte ora dy pasmesnate. S'kishte kaluar ende as një orë që kur kishte gjetur në rrugë Klarisa Maklellënin, me të cilën për pak sa nuk ishte përplasur, pastaj dhomën e kredhur në errësirë, shkelmin që i kishte dhënë tubetthit të kristaltë. Vetëm një orë kishte kaluar, por brenda kësaj ore e gjithë bota qe shpërbërë, që pastaj sërish të gufonte, duke marrë një formë të re, pa ngjyra. Përmes lëndinës ngjyrë hëne vinin të qeshurat e shtëpisë së Klarisës dhe të atit të saj, të nënës së saj, të xhaxhait të saj, që buzëqeshnin dhimbsurisht e tërë dashuri. Por, përmbi të gjitha, ai vërejti se sa e qetë dhe e përzemërt ishte ajo, sa e çlirë ishte e qeshu-

ra e tyre, që vinte nga ajo shtëpi aq madhërisht e ndriçuar në mes të natës, ndërkohë që të gjitha shtëpitë e tjera rrinin të zhytura mes territ. Montagu dëgjoi murmurimën e zërave, murmurimën e tyre të brishtë, si një drithërimë e zgjatur, ndërkohë që thurnin, kuvendonin, duke thurur e rithurur atë pëlhurën e tyre hipnotizuese.

Montagu doli nga porta-dritare dhe e kapërceu livadhin, pa e marrë as vetë vesh sesi. U ndal para shtëpisë që fliste mes territ, duke menduar se fare mirë edhe mund të shkonte e të trokiste në portën e tyre, duke belbëzuar:

— Më lini të hyj. S'kam për të shqiptuar asnjë fjalë. Dua vetëm të rri e të dëgjoj. Për çfarë po flisni?

Por s'bëri asnjë hap përpara; mbeti aty duke mbërdhirë, me fytyrën që ishte bërë një maskë akulli, me veshët të ngrehur për të dëgjuar atë zë burri (ai i xhaxhait mbase?), që derdhej gjithë përreth, i shpejtë e i qetë:

«E pra, s'ke ç'thua, kjo është epoka e letrës higjenike. Ti shfryn hundët me një njeri, e merr pastaj dhe e mbledh shuk, e hedh në nevojtore, tërheq zinxhirin dhe uji e merr me vete, zgjat dorën që të marrësh një njeri tjetër, shfryn hundët e shukos, tërheq zinxhirin. Të gjithë këtë punë bëjnë, fshijnë hundët në xhaketën e fqinjit. E si dashke ti që të vesh e të bësh tifozllëk për skuadrën vendase, kur s'di as programin e ndeshjeve, as emrat e lojtarëve. Meqë ra fjala, më thuaj, ç'ngjyrë i kanë fanellat që veshin kur dalin në fushën e lojës?»

Montagu u kthye në shtëpinë e vet, i la dritaret të hapura tejpërtej, u përkul, që të shihte njëherë Mildredin, e mbuloi me kujdes me kuvertë e, më së fundi, u shtri edhe vetë dhe ndenji ashtu i shtrirë. me dritën e hënës përmbi mollëza e përmbi rrudhat e ballit të vrenjtur, me dritën e hënës të filtruar në secilin prej syve, ku ajo formonte nga një ujëvarë të argjendtë.

Një pikë shiu, Klarisa. Një tjetër pikë, Mildredi. Tri pika. Xhaxhai. Pika e katërt. Zjarri i kësaj nate. Një, Klarisa. Dy, Mildredi. Tri, xhaxhai, katër, pamja e zjarrit. Një, Mildredi, dy, Klarisa, një, dy, tre, katër, pesë, Klarisa, Mildredi, xhaxhai, zjarri, tableta për gjumë, njerëzit si letër higjenike, xhaketat, shami, të shfrysh hundët, t'i mbledhësh shuk, të tërheqësh zinxhirin e ujit. Një, dy, tre, një, dy, tre! Shiu. Shtrëngata. Xhaxhai qesh. Gjëmimi që vorbullon nga poshtë lart nëpër shkallë. Botë e tërë që kthehet përmbys. Zjarri që gufon përmbi një vullkan. Gjithçka që vërshon, rrëkëllehet, përmbyt gjithë përreth me një oshëtimë shurdhuese, në një rrëke të rrëmbyer që shkon drejt mëngjesit.

— S'po marr dot vesh gjë prej gjëje, — foli ai me vete dhe vuri në gojë një hape të ëmbël gjumi që i shkriu në gjuhë.

Në orën nëntë të mëngjesit krevati i Mildredit ishte bosh. Montagu u ngrit me ngut të madh e me zemrën që i rrihte fort, vrapoi për në paradhomë, por kur mbërriti te pragu i derës së kuzhinës, u ndal. Copa e thekur e bukës kërceu që nga thekësja e argjendtë, u kap fluturimthi nga një dorë metalike, që, si ndonjë merimangë e madhe, e lyeu shpejt e shpejt me gjalpë të shkrirë.

Mildredi po vërente copat e bukës së thekur me gjalpë që i ishin rreshtuar në pjatë. Veshët i kishte zënë me grerëzat elektrike, që, me atë zukatjen e tyre, e ndihnin të shtynte kohën. Befas ajo çoi sytë, pa Montagun dhe e përshëndeti me një të tundur koke.

— Ndihesh mirë? — e pyeti ai.

Pas dhjetë vjetësh praktike me kapsulat e mikrokufjeve, Mildredi ishte bërë specialiste për të lexuar

lëvizjen e buzëve. Polloi sërish me kokë. Pastaj komandoi thekësen që t'i thekte një fetë tjetër buke.

Montagu u ul.

Foli e shoqja:

— S'e marr vesh pse kam kaq shumë uri...

— Por ti...

— Oh, ç'uri që kam!

— Sonte, — nisi të fliste ai.

— Nuk kam fjetur mirë. Kalova një natë të tmerrshme. O zot, ç'uri që kam! S'e marr vesh përse.

— Sonte, — ia nisi përsëri Montagu.

Rastësisht ajo e pa në buzë.

— Ç'ndodhi sonte?

— Nuk e mban mend?

— Ç'farë të mbaj mend? Mos bëmë ndonjë çikë si tepër potere? Më duket vetja sikur kam pirë shumë. E ç'uri që kam! Kush ishte sonte këtu?

— Nja dy a tre miq, — iu përgjigj ai.

— Kështu mendova edhe unë. — Nisi të hante fetën e bukës së thekur. — E kam stomakun shumë keq, e prapësepraprë kam një uri të tmerrshme. Shpresoj që mbrëmë, gjatë festës, nuk bëra e nuk thashë ndonjë gjë që s'shkon.

— Jo, jo, — foli ai i qetë.

Thekësja i zgjati një fetë bukë të lyer me gjalpë, që ai e mori me mirënjohje.

— Edhe ti s'po më dukesh mirë, — i tha e shoqja.

Mbasdite nisi të binte shi, dhe gjithçka mori një ngjyrë të hirtë plumbi. Ai hyri në paradhomën e shtëpisë dhe vuri distinktivin me salamandrën ngjyrë portokalli që i shndriste në mes. Pastaj ndenji një copë herë të gjatë me sytë të ngulur te goja e impiantit të

ajrimit. E shoqja, që ishte në sallën e TV, ngriti sytë që nga libërthi që po lexonte dhe pa nga ai.

— Ei! — i tha — ç'ke që je kaq i kredhur në mendime?

— Në të vërtetë po mendoja diçka, — iu përgjigj Montagu. — Doja të të flisja. (Një pauzë.) — Mbrëmë ti i kishe pirë të gjitha hapet e ilaçit për gjumë.

— Oh, e pamundur të kem bërë një gjë të tillë, — tha ajo e habitur.

— E megjithatë, flakonin e ke të zbrazur.

Të them unë që s'ka asnjë mundësi. E pse ta bëja një gjë të tillë?

— Mbase, në fillim ke pirë dy hape, pastaj ke harruar e ke pirë dy të tjera dhe prapë ke harruar, edhe dy të tjera, dhe ke qenë aq e trullosur, saqë ke vazhduar t'i pish gjersa e ke mbushur stomakun me nja tridhjetë ose dyzet.

— Dreqi e mori, — vërejti gruaja, — e përse u dashka që të katandisem gjer aty sa të bëj një budallallëk të tillë?

— Këtë s'po e marr vesh as unë, — tha ai.

Dukej qartë që e shoqja mezi po e priste që ai të ikte.

— Unë s'kam bërë asgjë të tillë, — tha ajo me vendosmëri. — Dhe s'kam për ta bërë edhe sikur një miliard vjet të kalojnë.

— Aq më mirë atëherë, gjersa e thua ti.

— Kaq kishte për të thënë madhëria e saj, — tha ajo dhe u kthye prapë te libërthi i saj.

— Ç'ka ndonjë gjë të re sonte në TV? — e pyeti ai me një pamje të lodhur.

Kësaj here ajo as që i ngriti sytë nga leximi.

— Kjo që po lexoj është një komedi që do të transmetohet pas dhjetë minutash në kanalin paret-paret. Sot në mëngjes më dërguan me postë rolin tim. Shkruajnë një pjesë ku njëri nga rolet mungon. Është një ide e re e TV. Ajo që rri në shtëpi, domethënë unë, do të luajë rolin që mungon. Kur vjen çasti i batutës që mungon, që të gjithë, që nga të tri paretet,

kthehen e shohin nga unë, e atëherë unë them batutën. Për shembull, këtu, burri thotë: «Si të duket kjo ide, Helenë?» E ndërkohë më vështron mua, që rri e ulur këtu, në qendër të skenës, e sheh? Dhe unë i përgjigjem, i përgjigjem... — Ajo heshti duke ndjekur me gisht rreshtat e librërthit. — «Oh, mua më duket një ide e shkëlqyer!» Pas kësaj komedia vazhdon normalisht, gjersa burri thotë: «Po ti a je dakord, Helenë?» dhe unë i përgjigjem: «Plotësisht dakord!» A nuk është zbavitëse, eh, Gaj?

Montagu vazhdonte të rrinte më këmbë në paradhomë dhe e shihte ngultazi.

— Dëgjomë mua, është shumë zbavitëse, — i tha ajo.

— Po komedia përse bën fjalë?

— Po ta thashë! Janë këta personazhet, që quhen Bob, Ruth dhe Helenë.

— Oh!

— Është një gjë me të vërtetë zbavitëse. Dhe ka për të qenë edhe më shumë kur të vendosim impiantin e paretit të katërt. Sa kohë mendon që do të duhet akoma që ta heqim këtë faqe muri e të instalojmë paretin e katërt TV? Në fund të fundit, më shumë se dy mijë dollarë s'ka për të kushtuar!

— Dy mijë dollarë do të thotë katër muaj të rrogës sime.

— Nuk do t'i kapërcejë të dy mijë dollarët, — ia ktheu ajo. — Dhe mendoj se bën mirë që ngandonjëherë të kujtohesh edhe për mua. Sikur të kishim edhe paretin e katërt, atëherë po, mund të thoshim se kjo dhomë s'do të jetë më jona, por e lloj-lloj njerëzve azotikë. Fundja, një çikë sakrificë sikur të bëjmë...

— Po bëjmë akoma gjithë ato sakrifica për të paguar paretin e tretë TV. Nuk e mban mend, s'ka dy muaj që e montuam?

— Vërtet? Vetëm dy muaj kanë kaluar? — Ajo mbeti duke e parë me vëmendje për një copë herë të mirë, e ulur aty në sallonin e TV. E po, mirupafshim i dashur!

— Mirupafshim! — i tha Montagu. U ndal pak dhe u kthye nga ajo. — T'ë paktën, kjo komedia a përfundon mirë?

— Nuk e di, se s'e kam lexuar gjer në fund.

Ai iu afrua, lexoi faqen e fundit të librërthit, tundi kokën, palosi fashikullin dhe ia dha prapë asaj. Pastaj doli nga shtëpia dhe u largua në mes të shiut.

Pas pak shiu ishte rralluar, dhe vajza po ecte në mes të trotuarit, me kokën e varur paksa mbrapa, në mënyrë që ato pak pika shiu t'i binin drejt e në fytyrë. Ajo buzëqeshi kur pa Montagun.

— Tungjatjeta!

— Tungjatjeta! — iu përgjigj ai e pastaj shtoi:

— A mund të më thuash se ç'po bën?

— Ti e di, unë mbetem gjithnjë e marrë. Shiu ka një aromë të këndshme dhe e ndien veten mirë kur ai të çik. Mua më pëlqen të eci në mes të shiut.

— Mua s'para më pëlqen edhe aq.

— Vë bast që s'e keni provuar asnjëherë!

— Në të vërtetë, asnjëherë s'e kam provuar.

Vajza lëpiu buzët.

— Ka me të vërtetë një shije të mirë.

— E pra, del xhiro që ta provosh çdo gjë nganjëherë, apo jo?

— Shpesh edhe dy herë. — Vajza vështroi diçka që mbante në dorë.

— Ç'shtrëngon ashtu në dorë?

— Besoj se kjo është lule radhiqja e fundit e këtij viti. Nuk ma priste mendja kurrë që ta gjeja kaq vonë në lëndinë. E ke dëgjuar ndonjëherë atë provën që bëhet me të, duke e fërkuar nën gushë? Ja, shiko.

Fërkoi gushën me lulen duke qeshur.

— E pse e bën?

— Po qe se do të lërë ngjyrë, do të thotë se unë kam rënë në dashuri. Ka lënë gjë?

Montagu s'pati nga t'ia mbante dhe e pa.

— E pra? — nguli këmbë ajo.

— E ke gushën të verdhë.

– E mrekullueshme. Pa të shohim ty tani!

– Për mua nuk ka vlerë.

– Shiko. – Para se ai të kishte kohë t'i shmangej, ajo ia kishte vënë lule radhiqen nën gushë. Montagu u tërhoq, dhe ajo ia plasi të qeshurit.

– Mos luaj nga vendi.

E pa nën gushë dhe u vrenjt.

– E pra? – pyeti ai.

– Sa keq! Ju s'qenkeni i dashuruar me asnjeri.

– Kurse në të vërtetë jam.

– Këtu nuk shihet.

– Jam i dashuruar, i dashuruar sa s'bëhet më! – U përpoq të merrte në fytyrë një shprehje që të mos ia hidhte poshtë ato fjalë që po thoshte, por prapë s'e arriti dot.– Me të vërtetë që jam!

– Oh, të lutem, mos e bëj asnjëherë fytyrën.

– E ka fajin lule radhiqja, – tha Montagu. – E harxhove të gjithë për vete. Prandaj me mua nuk doli gjë.

– Tamam, asnjëherë duhet të jetë. Oh, por ama ju shqetësova, duket menjëherë që jeni i trondítur. Ju kërkoj ndjesë, ju kërkoj sinqerisht të falur. – Dhe e çiku në bërryl.

– Jo, jo, – iu përgjigj ai menjëherë. – S'ka përse.

– Tani më duhet të shkoj, prandaj më thuaj që më ke falur, nuk dua të të lë të zemëruar.

– Nuk jam fare i zemëruar. Vetëm pak si i turbulluar.

Tani më duhet të shkoj te psikiatri. Më detyrojnë që të shkoj. Kurse unë i përgatit që më parë ato që do t'i them. Nuk e di se ç'mendim ka ai për mua. Thotë se jam si një qepujkë e bërë, që duhet çvoshkur cipë pas cipe, deri në fund.

– Tani po nis edhe unë të besoj se ke nevojë vërtet të vizitohesh te një psikiatër! – i tha Montagu.

– Këtë e thoni, por nuk e mendoni, apo nuk është kështu?

Burri mori njëherë frymë thellë, pastaj e nxori dalngadalë dhe, më në fund, iu përgjigj:

— Po ashtu është, nuk e mendoj.

— Psikiatri do të dijë përse unë dal e bredh nëpër pyje, vërej zogjtë e mbledh flutura. Ndonjë nga këto ditë do të të tregoj koleksionin që kam.

— Shumë mirë.

— Duan të dinë se me se merrem gjatë tërë kohës. U them se ka raste që rri ulur e mendohem. Por nuk u them për se mendoj. Kjo i tërbon. Ngandonjëherë, u them, më pëlqen ta lëshoj kokën prapa, ja, si tani, që ta lë shiun të më bjerë në gojë. Ka tamam shijen e verës. E ke provuar ndonjëherë?

— Jo, unë...

— Më keni falur, apo jo?

— Sigurisht. — Ai u mendua për një çast. — Patjetër që të kam falur. Po një zot e di përse. Je e çuditshme, të ngre nervat, e megjithatë njeriu e ka të lehtë të të falë. Si më the, sa vjeç je, shtatëmbëdhjetë?

— Po... i mbush muajin që vjen.

Sa e çuditshme! Ç'gjë absurde! Ime shoqe është tridhjetë vjeç, e megjithatë ti ngandonjëherë më ngjan shumë më e madhe nga ajo. Ja një gjë që nuk e marr dot vesh.

— Edhe ju jeni njeri i çuditshëm, zoti Montag. Herë-herë e harroj fare se jeni zjarrtar. Tani, për shembull, ju ngrita nervat prapë, apo jo?

— Vazhdo.

— Si e filluat zanatin? Si hytë në atë punë? Si ndodhi që zgjodhët këtë punë dhe si qe e mundur t'ju shkonte mendja të zinit këtë zanat? Pse nuk jeni si gjithë të tjerët? Kam parë disa: i di se si janë. Kur unë flas, ju më vështroni. Kur thashë natën që shkoi s'mbaj mend se çfarë për hënën, ju ngritët kokën e patë lart nga hëna. Të tjerët nuk do të bënin kurrë kështu. Të tjerët do të iknin pa një pa dy, duke më lënë të dërdëllitja sa të doja. Ose do të më kërcënonin. Askush s'ka më nge për të tjerët. Ju jeni një nga të paktët që ma vënë veshin. Prandaj më duket kaq e çuditshme që jeni në skuadrën e djegieve. Veçse nuk më duket e drejtë, se kjo është diçka që nuk ju shkon.

Ai ndjeu trupin t'i dyzohej në mes: njërën pjesë e kishte të nxehtë, tjetrën të ftohtë akull, njërën të brishtë, tjetrën të ashpër, njëra ishte e drithëruar, tjetra e fortë gur, dhe secila prej tyre mundohej të gllabëronte tjetrën.

— Bën mirë të shkosh, se mos vonohesh në atë takimin që ke me mjekun, — i tha ai vajzës.

Dhe ajo shkoi me vrap. duke e lënë atë si hu në mes të shiut. Vetëm pas një copë here të gjatë Montagu luajti nga vendi...

Pastaj tek ecte ngadalë, e çoi kokën mbrapa për disa çaste, ashtu nën shi dhe hapi gojën...

Zagari Mekanik flinte e në të njëjtën kohë nuk flinte, jetonte e njëkohësisht s'jetonte në atë koliben e tij që zhuzhërinte lehtë, dridhej butë-butë, i kredhur i tëri nën atë ndriçim ledhatues, në një nga qoshet e errëta të shtëpisë së zjarrit.

Drita e venitur e orës një pasmesnate, drita e hënës që derdhej që lart nga qielli përmes kornizës së dritares së madhe, lodronte herë aty e herë këtu mbi pjesët e broncëta, të bakërta, të çelnikta të kafshës, të cilën herë pas here e përshkonin ca regëtima të lehta. Drita farfurinte e vezullonte mbi copat e xhamit ngjyrë rubini e mbi ato fijëza tepër të ndjeshme në formë kapilarësh të hojëzave qimeashpër najloni të kësaj kafshe të çuditshme, që dridhej e fërgëllonte lehtë mbi ato tetë putrat si prej merimange me kushineta gome nga poshtë.

Montagu rrëshqiti përposh me anë të tubit prej bronci. Doli që t'i hidhte një sy qytetit: retë ishin shpërndarë plotësisht; ndezi një cigare dhe, si u fut përsëri brenda, iu afrua Zagarit, që ta vështronte.

Zagari Mekanik të kujtonte një bletë gjigante që sapo është kthyer në zgjua nga një fushë ku nektari është i nginjur me një helm, që të sjell marrëzi dhe makthe, dhe tani po flinte me trupin e mbushur me këtë nektar tepër erëkëndshëm dhe të ëmbël, duke u

'munduar kësisoj të çlirohej nga gjithë ajo e keqe që kishte thithur.

— Ç'kemi — belbëzoi Montagu, i cili, si përherë, e ndiente veten të magjepsur nga kjo bishë, që ishte njëherësh e vdekur dhe e gjallë.

Ato net kur gjithçka bëhej e mërzitshme, e kështu ndodhte në të vërtetë çdo natë, zjarrtarët lëshoheshin përposh, duke rrëshqitur nëpërmjet shtyllës së bronctë, dhe, si vinin në lëvizje ato kombinacionet kërkëllitëse të sistemit nuhatës të Zagarit, lëshonin në oborrin e kazermës tufa minjsh, ngandonjëherë pula dhe ca herë të tjera edhe mace, të cilët, sido që të vinte puna, kishin për t'u mbytur, dhe atëherë nisnin e vinin baste me njëri-tjetrin se cilin nga minjtë ose pulat, ose macet kishte për të zënë të parin Zagari. Pretë lëshoheshin dhe tri sekonda më pas gjithçka kishte marrë fund: miu, maçja, pula kapeshin në mes të oborrit, mbaheshin të rrokura tërë delikatesë mes putrave të ndjeshme të kafshës, ndërkohë që një age çeliku e gjatë nja dhjetë santim dilte prej turirit të Zagarit dhe shponte prenë, duke i injektuar doza të forta morfine ose prokaine. Pastaj viktimat i hidhnin në krematorium dhe lëshonin një gjah tjetër.

Gjatë këtyre gjaheve me baste, Montagu mbeste vetëm në katin e sipërm. Kishte qenë një kohë, dy vjet të shkuar, kur edhe ai kishte vënë bast me më të zotët e shokëve dhe kishte humbur deri edhe një javë të tërë rrogë dhe pastaj i ishte dashur t'i bënte ballë zemërimit e tërbimit të Mildredit, që i ishte vërsulur me ca damarë të kërcyer e ca njolla të trëndafilta në fytyrë. Kurse tani netve ai rrinte i shtrirë në shtrat, me fytyrën kthyer nga muri, duke mbajtur vesh shpërthimet e të qeshurave që vinin nga oborri dhe cukatjen e thonjve të minjve, që ngjasonte me lojën e kordave të një pianoje, violinën e drithëruar të piskamave të tyre dhe pastaj heshtjen që linte pas hija e madhe e Zagarit, që kërcente pa zhurmë nën dritën e qashtër, si ndonjë flutur nate, zbulonte viktimën, e kapte, i fuste agen dhe kthehej përsëri në koliben e

...ri u ngrit përgjysmë aty brenda në kabinë ...ndriçuar me një ndriçim neoni të gjelbër në të ...) vinte nga ato gjobat e syve, që befas ishin Hungarisë përsëri duke nxjerrë një kombinim ... të një alarme të ngjirur krisjeje elektri-fikimi, shungullime metalike, që sikur vinte ...rrotave të dhëmbëzuara, që do të thotë se ...yshkur e vjetruar nga mosbesimi i përhershëm ...kaje.

...Uhu i mbaruar, i mbaruar, mik, — foli Montagu, ...rën e [illegible] të tmerruar.

...një të katërtën e sekondës që megjithëse se ai doli, ...mpë brenda, përsëri doli, u fut prapë. Ungë-...ur u kredh më thellë në brendësi të kabinës, vështronte.

...agu u zmbraps. Zagari bëri edhe ai një hap ...tëhen më vete. Me njërën dorë Montagu u kap ...kës së bronztë. Shtylla, duke rrotulluar, u tërheq... lart, duke e ngritur edhe atë gjer pranë ...r, në platformën e kreditor në gjysmerrësirë të ...sipërm. ai e lëshoi shtyllën. Dridhej i tëri dhe ...rë në fytyrë. Përposh Zagari qe lëshuar i fle-...t ato portret e tij të habitshme prej teneqeje, ...mrrëfyer ende diçka, megjithëse sytë e hir-...më i kishte të qetë.

...pranë vrimës së daljes Montagu ndenji një ...ë, sa të mbledhte veten nga ajo frikë e madhe ...e provuar. Pas kurrizit të tij, hetër burra, që ...ulur te një tryezë loje, e ndriçuar më njërin ...një abazhur jeshil, i hodhën një sy vjedhurazi, ...asnjë gjë. Vetëm ai që mbante në dorë bretkën ...it me simbolin e fenikut mbi të, më së fundi ...reshtur disa, pa i lëshuar letrat nga ajo dora ...olli i therri në sam fundi i [illegible] së qetë:

— Montag....?

— Nuk i pëlqej, — tha Montagu.

— Kujt, Zagarit? — Kapiteni studioi një copë herë letrat që kishte në dorë. — Mjaft dhe ti! Këtu s'është puna i pëlqen apo nuk i pëlqen atij ky apo ai; ai thjesht «*funksionon*». Është njëlloj si në një mësim balistike. Ai ka një trajektore, të cilën ia zgjedhim ne. Dhe ai e ndjek atë gjer në fund, e mbërrin vetë shenjën, kthehet vetë prapë në bazë dhe aty po vetë shuhet. S'është gjë tjetër veç një grumbull telash bakri, baterish dhe elektriciteti.

Montagu mori frymë thellë.

— Mekanizmat e tij mund të regjistrohen në çfarëdo kombinimi, apo jo? Kaq aminoacide, kaq squfur, kaq yndyrna e substanca alkaline. Kështu është?

— Sigurisht.

— Të gjitha këto ekuilibrime kimike, këto përqindje e përpjesëtime organike të secilit prej nesh këtu në kazermë, ndodhen të regjistruara në zyrën e regjistrimit, që është poshtë. Cilido e ka të lehtë të vejë e të provokojë te «*kujtesa*» e Zagarit një kombinim kimik të pjesshëm, duke i vënë, bie fjala, vetëm pak nga aminoacidet. Me këtë shpjegohet pse pak më parë Zagari u soll ashtu: *ai reagoi kundër meje.*

— Djalli e mori! — tha kapiteni.

— Ishte i ngacmuar, por jo tamam i egërsuar. Ishte vetëm një «*kujtesë*» që dikush ia kishte futur Zagarit, aq sa të mjaftonte që ai të niste e të hungërinte kur unë ta përkëdhelja.

— E si mendon ti, kush mund ta ketë bërë një gjë të tillë? — e pyeti kapiteni. — Ti s'ke armiq këtu, Gaj.

— Me sa di unë, jo.

— Nesër dërgojmë teknikët tanë t'i bëjnë një kontroll Zagarit.

— Kjo s'është hera e parë që Zagari më kanoset, — vazhdoi Montagu. — Muajin që shkoi një gjë e tillë u përsërit dy herë.

— Do të kemi kujdes, mos ki merak. Mos u nxeh.

Por Montagu s'luajti nga vendi, mbeti aty dhe mendjen e çoi te grila e impiantit të ajrimit, aty në paradhomë të shtëpisë së tij, e tek ajo diçka që ishte fshehur pas kësaj rrjete. Sikur ndonjë nga kazerma të dinte gjësendi për grilën, e kush do ta ndalonte që t'ia thoshte këtë Zagarit?

Kapiteni iu avit vrimës së zbritjes dhe i hodhi Montagut një shikim hetues.

— Po mendoj me vete, — foli Montagu, — kushedi ç'i shkon ndër mend natën Zagarit, aty poshtë! Mos vallë marrëdhëniet që kemi ne në mes nesh e bëjnë edhe atë të gjallë e armiqësor? Më hyjnë të dridhura kur e mendoj.

— Zagari nuk mendon asgjë të tillë që të mos e duam ne.

— Pikërisht kjo më trishton, — ia ktheu qetësisht Montagu, — që ne s'i kemi mësuar ndonjëherë të mendojë gjë tjetër veçse të ndjekë, të zbulojë viktimën e ta vrasë. Sa turp që ne s'jemi në gjendje ta bëjmë të mendojë ndonjëherë, gjë tjetër veç kësaj!

Kapiten Biti psherëtiu lehtë dhe foli me një ton thuajse të përzemërt.

— Dreqi e mori, po Zagari përbën një fitore të teknikës, është si një pushkë e mirë që e arrin vetë kundërshtarin e që të garanton se ke për të goditur gjithnjë në shenjë.

— Pikërisht, për këtë dhe unë s'kam pikë qejfi të bëhem viktima e tij e ardhme.

— E përse? Mos të vret gjëkafshë ndërgjegja për ndonjë gjë?

Montagu ngriti me vrull shikimin dhe pa kapitenin.

Biti ia kishte ngulur sytë, ndërkohë që goja e tij u çel pak dhe ai zuri të qeshte me përzemërsi.

Një, dy, tri, katër, pesë, gjashtë, shtatë ditë. Dhe sa herë që ai dilte nga shtëpia, ja aty, ja këtu nëpër botë do të gjendej Klarisa. Njëherë e pa duke thyer një kokërr arrë, një herë tjetër të ulur në lëndinë duke punuar me shtiza një triko bojë qielli, nja tri a katër herë gjeti në verandën e vet një tufë me lule të vona, apo disa gjethe vjeshtake, të kapura tërë kujdes me një gjilpërë me kokë në një fije letër të bardhë, të ngulur me pineska te porta e tij. Çdo ditë Klarisa e shoqëronte gjer te qoshja e rrugës. Një ditë binte shi, ditën tjetër ishte mot i qetë, tjetrën frynte një erë e fortë, kurse një ditë më pas bëri përsëri mot i butë dhe i qetë, kurse pas kësaj dite të butë e të qetë bëri një vapë si prej furre, dhe, para se të binte nata, Klarisa e kishte fytyrën të nxirë lehtë nga dielli.

— Si e shpjegon,— i tha ai njëherë, aty pranë hyrjes së metrosë, — që mua më duket sikur kam gjithë ata vjet që të njoh?

— Sepse më pëlqeni, — i tha ajo, — dhe unë s'kërkoj asgjë prej jush. Veç kësaj, ne e kuptojmë mirë njëri-tjetrin.

— Me ju unë e ndiej veten shumë të plakur, sikur të jem babai juaj.

— Pa më shpjego, atëherë, — i tha ajo, — kur i dashke kaq shumë fëmijët, pse s'ke edhe ti një vajzë si unë.

— Nuk e di.

— E thua me të vërtetë, apo tallesh!

— Jo, doja të thosha... — E preu fjalën në mes dhe vari kokën.

— Po ja, e kupton, ime shoqe, po, ime shoqe s'ka dashur asnjëherë që të kemi fëmijë.

Tani vajza s'po buzëqeshte më.

— Oh, më falni. Unë kujtoja se doje të talleshe me mua. Sa budallaqe që jam!

— Jo, jo — tha ai, — kishe plotësisht të drejtë që bëre një pyetje të tillë. Sikur ta dije se sa kohë ka që askush s'interesohet më për mua që të më pyesë për gjëkafshë. Pyetja që më bëre është e mirë.

— Atëherë, flasim për ndonjë gjë tjetër. Ke ndier ndonjëherë se ç'aromë mbajnë gjethet e thara? Nuk të duket si erë kanellë? Ja, mbaju erë.

— Po vërtet, tamam si kanellë mbajnë.

Vajza e vështroi me ata sytë e saj të zinj, të kthjellët.

— Duket sikur gjithnjë diçka ju frikëson.

— Ndodh ngaqë gjer tani s'kam pasur kohë...

— Shkuat t'i shihnit ato tabelat gjigante të reklamave, për të cilat ju fola?

— Besoj se po. I pashë. — Dhe ai padashje qeshi.

— E di që qeshni shumë më mirë nga ç'e pandehja.

— Vërtet?

— Po, më lirshëm, më i shpenguar.

Montagu e ndjeu veten të qetë, të paqtuar.

— Po pse nuk je asnjëherë në shkollë? Të shoh përditë sa andej-këndej, gjithnjë bredhacake...

— Oh, s'i ka marrë shumë malli për mua, — ia ktheu ajo. — Atje thonë se jam e pashoqërueshme. Se nuk përzihem me të tjerët. Dhe është e çuditshme, sepse unë, përkundrazi, kam shumë qejf të shoqërohem me të tjerët. Por varet se ç'kupton me shoqëri, apo s'është ashtu? Për mua, do të thotë të flas me ty për gjëra të këtij lloji, — dhe ajo hodhi në pëllëmbë disa arra që kishin rënë nga një pemë e kopshtit që ishte para shtëpisë. — Apo të flasësh se sa e çuditshme është bota. Mua më pëlqen shumë të rri me njerëzit. Por veçse s'më duket se mund ta quash shoqëri kur mbledh një tufë njerëzish dhe s'i lë të flasin, apo nuk është ashtu? Një orë mësim para televizorit, një orë basketboll ose bejsboll, ose vrapime, një orë tjetër historie të përmbledhur ose me riprodhime tablosh të famshme e pastaj prapë sport, por e kupton se kështu s'ke mundësi të bësh pyetje, apo të paktën thuajse askush nuk bën pyetje, se përgjigjet i ke aty të gatshme, si të bëra me porosi, dhe me to të qëllojnë, njërën pas tjetrës me të shpejtë, bam-bam-bam, kurse ne rrimë të ulur për katër orë të tëra me mësime në televizor.

Qindra rrëke që derdhin ujin nëpër ullukët, veç që ky të dalë e të derdhet nga ana tjetër, por ama tani ata të sigurojnë se ai s'është më ujë, por është bërë verë. Dhe, kur vjen mbrëmja, je katandisur aq keq, saqë s'je në gjendje të bësh gjë tjetër veç të biesh të flesh ose të futesh në ndonjë park argëtimi, ku të ngacmosh njerëzit që shëtitin, ose të thyesh xhama në pavionin e xhamathyerjes, ose me një top të madh çeliku të vesh e të thyesh makina në poligonin e makinathyerjes. Ose s'të mbetet të bësh gjë tjetër veçse t'i hipësh makinës e ta ngasësh si i marrë nëpër rrugë, që të shohësh se sa pranë je i zoti t'u vesh përballë makinave të tjera, para se të kthesh timonin, ose të luash duke i prerë kthesat sa më shumë, makar edhe vetëm me dy rrotat anësore. Mbase jam vërtet ashtu siç thonë. Ata kanë të drejtë. Unë s'kam miq. Dhe kjo treguaka se unë s'duhet të jem normale. Por të gjithë ata njerëz që unë njoh, s'dinë veçse të ulërijnë e të kërcejnë si të çmendur e jo vetëm kaq, por edhe të zihen egërsisht me njëri-tjetrin. E ke vënë re se sa qejf kanë njerëzit sot t'i bëjnë keq njëri-tjetrit?

— Arsyeton si ndonjë plakushe.

— Ngandonjëherë e ndiej veten vërtet si ndonjë plakë. Kam frikë nga moshatarët e mi. Si mendon ti, gjithnjë kështu ka qenë? Xhaxhai thotë që s'ka qenë kështu. Vetëm gjatë këtij viti gjashtë miq të mi, që banojnë në këto anë, kanë vdekur nga armët e zjarrit. Dhjetë kanë vdekur në aksidente automobilistike. Unë kam frikë dhe ata nuk më duan, ngaqë kam frikë.

— Por më tepër nga të gjitha, — vazhdoi ajo të fliste, pasi heshti për një copë herë, — më pëlqen të rri e të studioj njerëzit. Ngandonjëherë rri gjithë ditën e ditës në metro që të dëgjoj njerëzit se si flasin, që t'i vështroj. Më pëlqen që të rri e të përfytyroj se kush është filani, ç'dëshira ka ky tjetri, nga shkojnë këta njerëz. Herë-herë shkoj, madje edhe në parkun e argëtimit ose dal me makinën reaktive në rrethinat e qytetit, në mesnatë, atëherë kur policia s'para ua vë veshin shumë

makinave që kalojnë me shpejtësi, mjaft që ata që i ngasin të jenë të siguruar. Po pate në xhep një dëftesë sigurimi për dhjetë mijë dollarë, gjithçka është në rregull e të gjithë janë të lumtur e të kënaqur. Më ka ndodhur të shkas si ndonjë gjarpër në ndonjë nga vagonët e metrosë, që të dëgjoj se ç'thonë njerëzit. Ose shikoj nëpër dyqanet ku shiten pije freskuese dhe e gjen dot se ç'kam zbuluar?

— Çfarë?

— Që njerëzit nuk thonë asgjë prej gjëje.

— Oh, po pa folur s'rrinë njerëzit!

— Jo, por të siguroj unë që s'thonë asgjë prej gjëje. Flasin shumë për makinat, flasin për rroba e për pishina, që na qenkan mrekullia vetë! Por që të gjithë përsëritin po të njëjtën gjë e s'kanë asnjë që të thotë diçka të ndryshme nga të tjerët. Kurse nëpër kafene gjen gjithnjë ato makinat që të provojnë fatin, rrëfehen po ato barceleta ose gjen të ndezur paretin muzikor, ku venë e vijnë vizatime e ngjyra që s'janë gjë tjetër veçse ngjyra, kurse vizatimet janë krejt abstrakte. Po në muze a ke shkuar ndonjëherë? Vetëm abstraksione. Vetëm ato gjen sot në muze. Xhaxhai thotë që njëherë e një kohë ka qënë ndryshe. Shumë kohë më parë, nuk e di mirë se kur, po pikturat dhe skulpturat flisnin për gjëra konkrete, bile paraqisnin edhe njerëz!

— Jo po xhaxhai thotë kështu, jo po xhaxhai thotë ashtu, ky xhaxhai juaj duhet të jetë një njeri shumë i shquar.

— Oh, ashtu është. Pa dyshim që është! E po, tani unë duhet të shkoj. Mirupafshim, zoti Montag!

— Mirupafshim!

Një, dy, tri, katër, pesë, gjashtë, shtatë ditë: në kazermën e zjarrit.

— Montag, ngjitesh në atë shtyllë si harabeli në pemë.

Ditën e tretë.

— Montag, të pashë që hyre nga porta e mbrapme. Hallin e Zagarit ke?

— Jo, jo.

Ditën e katërt.

— Montag do të dëgjosh një gjë për të qeshur. Sapo ma treguan. Një zjarrtar nga Sitlli vajti dhe e sintonizoi me qëllim Zagarin Mekanik sipas përbërjes kimike të vetes së vet dhe pastaj vajti dhe e cyti. Ke dëgjuar ndonjëherë vetëvrasje më të çuditshme?

Pesë, gjashtë, shtatë ditë.

Dhe pastaj Klarisa nuk qe më. Ai s'po e merrte vesh se ç'po ndodhte atë mbasdite, por mbase ndihej ashtu ngaqë s'po e shihte atë t'i dilte përpara. Lëndina ishte e shkretë, drurët të shkretë, rruga e shkretë dhe megjithëse në fillim s'po e kuptonte as vetë se sa ia ndiente asaj mungesën e se qe duke e kërkuar, kur mbërriti te metroja, e kapi një shqetësim i vërtetë dhe nisi ta ndiente veten keq. Kishte ndodhur diçka që ia kishte turbulluar vazhdën e paracaktuar të jetës. Është e vërtetë që s'kishte qenë veçse një vazhdë e thjeshtë, e paracaktuar, që s'kishte vetëm pak ditë që kishte nisur, po prapëseprapë...? U rrotullua mbi thembra dhe u kthye prapë po në të njëjtën rrugë, që t'i linte asaj kohë që të vinte. Ishte i sigurt se, po ta përshkonte sërishmi po atë rrugë, do ta takonte Klarisën dhe gjithçka do të shkonte më së miri. Por ishte bërë vonë dhe treni që mbërriti u dha fund planeve të tij.

Fëshfëritja e letrave të bixhozit, lëvizja e duarve, murmurima monotone e kronofonit që nga tavani i kazermës së zjarrit «... një e tridhjetë e pesë, mëngjes, e martë, 4 nëntor... një e tridhjetë e gjashtë... një e tridhjetë e shtatë, mëngjes...» Përplasja e lehtë e letrave pas sipërfaqes së ndotur të tryezës, të gjitha zhurmat mbërrinin gjer te Montagu, që pas qepallave që i mbante të mbyllura, që pas kësaj pengese që ai kishte ngritur përkohësisht. E ndiente kazermën e zjarrit të mbushur plot me shkëndija, gjithë ndriçim e heshtje, me ngjyra të broncta, me ngjyrat e monedhave, të arta, të argjendta.

Njerzit e padukshëm që rrinin në anën tjetër të tryezës, merrnin frymë thellë mbi letrat që mbanin në dorë, në pritje të «... një edyzetepesës...», dhe zëri i kronofonit tingëllonte i trishtë në atë orë të ftohtë të një mëngjesi të ftohtë të një viti edhe më të acartë.

— Çfarë ke, Montag?

Montagu hapi sytë.

Diku, në një anë, një radio po murmuriste «... lufta mund të shpallet nga çasti në çast. Vendi ynë është gati të luftojë në mbrojtje të...»

Kazerma e zjarrit u drodh e tëra, ndërkohë që një mori avionësh reaktivë lëshuan një fërshëllimë të vetme, duke çarë qiellin e errët të mëngjesit.

Montagut i fërgëlluan sytë. Biti po e vështronte si të qe një statujë e vendosur në një muze. Nga çasti në çast kishte mundësi që Biti të çohej, t'i vinte rrotull, ta çikte, duke zbuluar fajin që ai kishte bërë e atë ndjenjë turpi që provonte. Faj? E ç'dreq faji ishte ky?

— E ke radhën ti të luash, Montag.

Montagu vështroi ata burra me fytyrë të bronctë nga ato mijëra zjarre reale e nga dhjetëra mijëra zjarre të përfytyruara, ata burra të cilëve puna që bënin ua skuqte mollëzat e faqeve e u fuste ethet në sy, ata burra që ia ngulnin shikimin flakëzave të çakmakëve të tyre të platintë, kur ndiznin llullat, që s'shuheshin kurrë.

Montagu brofi në këmbë me gojën hapur. Një mendim i çuditshëm i erdhi në kokë. A kishte parë ndonjëherë ai ndonjë zjarrtar që të mos i kishte flokët të zez, ballin ngjyrë bloze, fytyrën të rreptë, krenare, të rruar aq shumë, saqë merrte një hije të kaltërreme në të hirtë si prej çeliku, por që, megjithatë, prapë ngjante si e parruar? Të gjithë këta njerëz mos ishin marrë në atë punë edhe në bazë të pamjes së jashtme dhe jo vetëm të cilësive që kishin? Ai ngjyrim hiri dhe bloze i afyre njerëzve, ajo erë e përjetshme prej gjëje të djegur që vinte nga llullat, ai kapiten Biti, që çohej në këmbë mes shtëllungave të stuhisë së tymit të duhanit, Biti, që hapte një paketë të re duhani, duke ia zhubravitur celefonin, që nxirrte një tingull si cërcëritja e flakës.

Montagu u hodhi një sy letrave që kishte në dorë.

— Po... po mendohesha. Për zjarrin që vumë javën që shkoi. Për atë burrin të cilit i dogjëm bibliotekën. Ç'fund pati ai?

— Ashtu, duke ulëritur, e çuan në çmendinë.

— Po ai s'ishte i çmendur.

Biti lëshoi në heshtje letrat mbi tryezë.

— Kushdo që kujton se mund t'ia hedhë qeverisë ose neve, është i çmendur, — foli ai më në fund.

— Po përpiqesha të përfytyroja, — vazhdoi Montagu, — çdo të ndiente njeriu sikur të shihte zjarrtarët, dua të them, sikur t'i shihte t'i vinin zjarrin shtëpisë së tij, librave të tij.

— Ne s'mbajmë libra.

— Po, ja, sikur t'i kishim?

— Mos ke ti ndonjë? — Dhe Bitit i fërgëlluan ngadalë sytë.

— Jo. — Montagu i hodhi sytë mbas kurrizit të tij, mbi murin ku ishin vendosur listat e daktilografuara të një milion librave të ndaluar. Titujt e tyre kërcenin përpjetë si gjuhë flake, duke u djegur gjatë viteve nën sëpatën e tij e pompën e tij, që nuk lëshonte ujë, por vajguri.

— Jo, — por ama, në mendjen e tij po ngrihej një erë e acartë, që kishte zënë të frynte që nga grila e ajrimit në shtëpinë e tij e që dalëngadalë po i ngrinte fytyrën. Dhe atëherë e pa veten përsëri në mes të një parku të gjelbëruar, duke i folur një plaku, një burri shumë të moshuar, por edhe era që frynte nga parku ishte e acartë.

Montagu ngurroi.

— Po... gjithnjë kështu ka qenë? Kazerma e zjarrit, shërbimi ynë prej zjarrtarësh kanë qenë gjithnjë? Apo, mbase, njëherë e një kohë, shumë, shumë kohë më parë...

— Njëherë e një kohë, shumë kohë më parë... — ia preu fjalën në mes Biti. — Ç'janë këto që thua?

«Idiot, — i tha vetes Montagu, — do të bësh që të të zbulojnë». Gjatë zjarrit të fundit ai i kishte hedhur një sy një rreshti të një libri me përralla.

— Doja të thosha. — vazhdoi ai, që kohë më parë. para se shtëpitë të ishin të gjitha të mbrojtura nga zjarri...

Befas iu bë sikur një zë më i ri e më i freskët nga ai i tij po fliste për të. Ai hapte gojën, por për të folur fliste Klarisa Maklellëni, që thoshte: «Asokohe zjarrtarët a nuk i shuanin zjarret, në vend që t'i ndiznin?»

— Kjo na qenka e bukur!

Stoumeni dhe Blleku nxorën secili nga një libërth rregulloreje. dhe ia vunë atij mu në hundë. në mënyrë që Montagu. të mund t'i lexonte megjithëse i kishte lexuar.

Rregulla Nr. 1: T'i përgjigjet menjëherë alarmit.

Nr. 2: Të vihet menjëherë zjarri.

Nr. 3: Të digjet gjithçka gjer në fund.

Nr. 4: Të kthehet pa asnjë vonesë në kazermë.

Nr. 5 Të qëndrohet në gatishmëri për mundësinë e alarmeve të tjera.

Të gjithë panë nga Montagu. Ai s'luajti nga vendi.

Ra alarmi.

Këmbana që ishte në tavan, e zuri me shkelma veten e vet të paktën nja dyqind herë. Dhe ja, papritur, aty mbetën katër karrige bosh. Letrat ranë përtokë me një frushfullimë si prej flokësh dëbore. Shtylla e bronctë ende dridhej. Njerëzit kishin ikur.

Montagu vazhdonte të rrinte ulur në karrigen e vet. Përposh dragoi ngjyrë portokalli u çua prapë nga gjumi me ca të kollitura metalike.

Montagu u lëshua poshtë, duke rrëshqitur në shtyllën e bronctë, si një njeri që ende është në ëndërr.

Zagari Mekanik në koliben e vet bëri një kërcim; sytë e tij ngjanin me dy grumbuj flake të gjelbër.

«Montag, ke harruar helmetën!»

E rrëmbeu atë që nga muri që kishte prapa kurrizit dhe u nis me vrap, kërceu në salamandër dhe ja ku u nisën, me erën e natës, që përplasej me piskamën e sirenës së tyre e me atë gumëzhimë të fuqishme metalike.

Ishte një shtëpi e vogël, me tri kate, në pjesën e vietër të qytetit, e cila duhej të kishte gati një shekull që ishte ngritur, por edhe asaj, ashtu si gjithçkaje tjetër, i ishte dhënë një dorë suvaje plastike kundër zjarrit shumë vjet më parë dhe tanimë dukej sikur vetëm kjo shtresë mbrojtëse suvaje e mbante atë ende në këmbë përkundrejt sfondit të qiellit.

— Ja ku mbërritëm!

Motori heshti pasi lëshoi edhe një krismë tjetër të fundit; Biti, Stounmeni, Blleku zbritën me vrap në trotuar, dhe befas atij iu dukën si ca qenie të dhjamura e të urryera, ashtu të veshur, siç ishin, me bluzat e gufuara që i mbronin ngo zjarri. Montagu u vajti pas.

Shpërthyen një portë dhe zunë me forcë një pla-

kë, megjithëse ajo as po rendte, as po përpiqej të ikte. Thjesht rrinte ashtu në këmbë, duke u përkundur një çikë sa në një anë në tjetrën, me ata sytë e ngulur në një zbrazëti të madhe, diku përmbi mur, njëlloj si të kishte ngrënë ndonjë grusht të fortë mbas zverkut. Gjuha i luante nëpër gojë, sytë dukej sikur rrekeshin diç të kujtonin, gjersa, më në fund, e kujtoi e atëherë gjuha e saj lëvizi përsëri:

— Mbahu burrë, Mjeshtër Ridël. Sot ne do të ndezim në Angli, për hir të zotit, një qiri të tillë, që unë besoj se askush s'do të mund ta shuajë më!

— Mjaft! — foli Biti. — Ku janë të tjerët?

I dha një shpullë, duke qenë për vete fare gjakftohtë, dhe ia përsëriti pyetjen. Sytë e plakës arritën të shihnin Bitin drejt e në fytyrë.

— E dini fare mirë se ku janë; përndryshe nuk do të ishit këtu, — foli plaka.

Stounmeni i zgjati kartën e thirrjes telefonike me denoncimin e shkruar me dorë nga pas, bashkë me numrin telefonik.

«Kam arsye të dyshoj për në tavan, 11 Nord Elm, Siti. E B.»

— Duhet të jetë zonja Blejk, komshia, — foli gruaja kur lexoi inicialet.

— Përpara, djema, t'i kapim shpejt.

Pak çaste më pas që të tërë ishin sipër, në terrin e amët, duke u dhënë ca goditje vetëtime me latoret ca portave, që as që ishin të mbyllura me çelës, gjersa, më së fundi, vërshuan brënda duke ulërirë si ca djem që janë në kulmin e qejfit.

— Eh!

Mbi Montagun, që po ngjiste shkallët e përpjeta që dridheshin nën të, befas u derdh që lart një zurkajë e tërë me libra. Ç'bezdi! Më parë kishte qenë punë e lehtë, njëlloj si t'i vije flakën një qiriri. Para tyre vinte njëherë policia, që, si ia mbyllte gojën viktimës, e merrte dhe e fuste në ato makinat e saj të zeza e të shndritshme si brumbuj, kështu që, kur mbërrinin zjarrtarët, e gjenin shtëpinë të boshatisur. S'i

bënin keq askujt, por veç sendeve! E, meqë sendet s'e ndiejnë dot të keqen që u bëhet e s'janë në gjendje as të ulërijnë e as të vajtojnë, siç mund të niste të ulërinte e të vajtonte kjo plakë nga çasti në çast, s'kishte ç'tua vriste ndërgjegjen më pas. Vinin thjesht për të bërë një dezinfektim. Një punë prej portieri ose kujdestari, asgjë më tepër. Gjithçka kishte vendin e vet, të gjitha bëheshin në rregull. Shpejt vajgurin! Kush ka një shkrepëse?

Por tani, këtë natë, dikush kishte bërë një hap të gabuar. Kjo plakë e kishte prishur tërë ritin. Zjarrtarët po bënin gjithë atë zhurmë, qeshnin, flisnin me zë të lartë, mjaft që të mos dëgjonin atë heshtjen e saj të tmerrshme në katin e poshtëm. Ishte ajo heshtje që i bënte dhomat e zbrazëta të gjëmonin nga akuzat e saj, asaj plake, ishte ajo që shkundte pëlhurën e imët të fajit, që ata e thëthinin me hojëzat e hundës, ndërkohë që vraponin sa andej këndej. Kjo që bënin, s'ishte as e ndershme, as fisnike. Montagu ndiente një acarim të madh, diçka që po i gufonte në gjoks. Para së gjithash, kjo plakë nuk duhej të ndodhej aty!

Librat e bombardonin në supe, në krah, në fytyrën e ngritur lart. Një libër zbriti mbi duart e tij, thuajse ëmbëlsisht, si një pëllumb i bardhë, me krahë që regëtinin. Në ndriçimin e zbehtë të drithëruar, njëra nga faqet u ndal e hapur dhe ishte si një pendë e bardhë bore, me fjalët e shkruara mbi të me aq kujdes. Mes gjithë atij pështjellimi, gjithë atij nguti, Montagu pati kohë të lexonte vetëm një rresht, por një minutë më pas ai rresht i flakëriu në tru, si t'i qe shenjuar aty me hekur të nxehtë.

«Koha ishte përgjumur nën diellin e fortë të mesditës.»

E lëshoi librin. Menjëherë një libër tjetër i ra mes duarve.

— Montag! Eja këtu.

Dora e Montagut u mbyll si një gojë, e rrasi librin fort pas gjoksit. Njerëzit që ishin sipër, flaknin

tufa me revista në ajrin e pluhurosur. Revistat rrëzoheshin si zogj të vrarë, kurse më poshtë gruaja rrinte në këmbë, si ndonjë çupëzë, mes kufomave të tyre.

Vetë Montagu s'kishte bërë asgjë. Dora e tij i kishte bërë të gjitha, dora e tij e pajisur me një tru të vetin, me një kureshtje e me nga një vetëdije për secilin nga gishtat që e përbënin; ashtu duke fërgëlluar, kishte qënë dora e tij që ishte bërë hajdute. Ja, tani ajo e shtyu librin lehtë-lehtë nën krah me fare pak lëvizje, e futi mirë nën sqetullën e djersitur, me një lëvizje tërë elegancë prej prestidigjitatori. Ja! I pafajshëm! Shiheni edhe vetë!

Ia nguli sytë, i mahnitur, asaj dore të bardhë. E mbante larg, si të vuante nga presbiopia. E sillte ngjitur me sytë, si të ishte miop, thuajse gati i verbër.

— Montag!

Ai u kthye menjëherë.

— Ç'më rri aty si ndonjë hu, idiot!

Librat ishin si ca tufa të mëdha me peshq të lëshuar në një cektinë. Njerëzit kërcenin e rrëshqitnin, rrëzoheshin mbi ta. Titujt llamburitnin, duke u rrëzuar, me ata sytë e tyre të praruar, gjersa, më së fundi, zhdukeshin në vdekje, të shuar...

— Vajguri!

Pompuan lëngun e ftohtë që nga serbatorët e shënuar me numrin 451°, që i mbanin të lidhur me rripa nga prapa, si t'i kishin çanta shpine. Përmbytën çdo libër, duke e mbuluar me lëngun ogurzi, si me një kopertinë, pompuan sasi të stërmëdha lëngu që nga serbatorët e tyre.

Pastaj zbritën me ngut të madh shkallët, i fu-

idit Montagu, që ecte duke u përkundur mes avujve ë vajgurit.

— Eja, shkojmë, plakë!

Gruaja rrinte në gjunjë mes librave, çikte lëkurën ose kartonin e njomur, lexonte me gishtërinj titujt e praruar, dhe ndërkohë shihte nga Montagu, si të qe ai fajtori.

— S'keni për të m'i marrë kurrë librat e mi, — foli ajo.

— Ju e njihni mirë ligjin, — i foli Biti. — Pse nuk arsyetoni ca? Mes tërë këtyre librave, s'gjen dot dy bashkë që të jenë në një mendje. Keni ndenjur këtu e mbyllur, për vite me radhë, bashkë me këtë kullë të Babelit. Dilni që këtej njëherë e mirë! Njerëzit që janë brenda këtyre librave, s'kanë jetuar kurrë ndonjëherë. Hajde dalim përjashta, tani!

Ajo tundi kokën.

— E gjithë kjo shtëpi do të bëhet shkrumb e hi, — i foli Biti.

Zjarrtarët u drejtuan me hap të rëndë për nga porta. U kthyen vetëm për të parë Montagun, që kishte qëndruar pranë gruas.

— Mos keni gjë ndër mend ta lini këtu? — protestoi ai.

— Gjersa s'do të vijë!

— Ta marrim me zor, atëherë!

Biti ngriti dorën, ku mbante shtrënguar fort zjarrvënësin:

— Na duhet të kthehemi sa më shpejt në kazermë, le që pastaj fanatikë të këtij lloji e kanë mendjen gjithnjë te vetëvrasja; gjithnjë po ky havaz është.

Montagu e kapi plakën për bërryli.

— Ka mundësi të vini me mua? — i tha.

— Jo, — iu përgjigj gruaja. — Por, sidoqoftë, falemnderit.

— Po numëroj gjer në dhjetë, — kumtoi Biti. — Një, dy.

— Të lutem, — i tha Montagu.

— Vazhdo të numërosh, — foli plaka.

— Tre, katër.

— Eja, shpejt. — Montagu bëri të tërhiqte plakën, e cila, fare e qetë, foli me vendosmëri:

— Unë dua të qëndroj këtu.

— Pesë, gjashtë.

— S'është nevoja të numëroni më, — tha ajo.

Hapi paksa gishtat e njërës dorë dhe në pëllëmbë iu duk një send i vogël, i hollë.

Një shkrepse e zakonshme kuzhine.

Sapo panë shkrepësen, të gjithë dolën me ngut të madh përjashta, duke iu larguar me vrap shtëpisë. Kapiten Biti, duke e ruajtur dinjitetin, u zmbraps ngadalë, gjersa kapërceu pragun e portës, me atë fytyrën e tij të skuqur e të përzhitur, që i shndriste nga ato mijëra zjarrvënie e ngazëllime nate që kishte provuar.

«O zot, — mendoi me vete Montagu. — Sa e vërtetë që është! Gjithmonë alarmet bëhen natën. Asnjëherë ditën! Mbase ngaqë një zjarr natën është më i bukur? Atëherë ka më shumë dukje, më shumë madhështi.»

Fytyra e kuqe e Bitit tani, aty, te pragu i derës, rrëfente një hije të lehtë frike. Dora e gruas u mbështoll rreth shkopthit të brishtë të shkrepëses. Përreth saj lumenjtë e vajgurit sa vinin e zgjeroheshin. Montagu ndjeu se si libri që kishte fshehur po i rrihte pas gjoksit si ndonjë zemër.

— Shkoni, — foli gruaja, dhe Montagu vërejti se si edhe vetë ai po zbythej gjithnjë e më tepër, gjithnjë e më tepër drejt portës e pastaj matanë saj, tatëpjetë shkallëve, pas gjurmëve të Bitit, nëpërmes lëndinëzës që kishte shtëpia nga përpara, ku një vijëzë vajguri zgjatej si ajo vraga e kushedi ç'lloj kërmilli të çuditshëm. Plaka qëndronte pa lëvizur lart, në verandë, dhe po i peshonte qetë-qetë me sy, duke shprehur në heshtje dënimin e saj.

Biti bëri t'i vinte zjarrin vajgurit, por nuk pati kohë. Montagu mezi u përmbajt që të mos lëshonte një klithmë.

Lart, në verandë, gruaja zgjati krahun, me një shprehje përçmimi të madh për të gjithë ata, dhe fërkoi shkrepësen pas parmakut të drunjtë.

Përgjatë gjithë rrugës njerëzit dolën me vrap që nga shtëpitë të bënin sehir.

Askush s'nxori fjalë nga goja gjatë rrugës së kthimit për në kazermë. Askush s'e pa tjetrin në sy. Montagu rrinte i ulur përpara bashkë me Bitin dhe Bllekun. As llullat nuk i vunë në gojë. Rrinin ulur duke vështruar përjashta që nga feçka e salamandrës së madhe, ndërkohë që merrnin një kthesë dhe vazhdonin prapë rrugën në heshtje.

— Mjeshtër Ridël, — foli befas Montagu.

— Çfarë? — pyeti Biti.

— Ajo gruaja tha: «Mjeshtër Ridël». S'e mora vesh se ç'marrëzira po murmuriste kur hymë ne. «Mbahu burrë, — tha, — Mjeshtër Ridël». E pastaj s'e mora vesh se çfarë tjetër.

— «Do të ndezim sot, për hir të zotit, këtu në Angli një qiri të tillë, që besoj se askush s'do të mundë ta shuajë më,» — foli Biti.

Stounmeni u kthye të shihte kapitenin, po ashtu bëri edhe Montagu, i habitur.

Biti fërkoi me dorë mjekrën.

— Një njeri me emrin Latimor ia tha këto fjalë një të quajturi Nikolas Ridël, kur ishin duke u djegur të gjallë si heretikë në Oksford, më 16 tetor 1555.

Montagu dhe Stounmeni e kthyen prapë shikimin nga rruga. e cila dukej sikur vraponte poshtë rrotave të makinës.

— E kam kokën të mbushur plot me gjëra të këtij lloji, — ia nisi prapë Biti. — Thuajse të gjithë shefat e zjarrvënësve janë të detyruar të dinë një mal të

tërë me gjëra të tilla që s'të hyjnë kurrë në punë. Ngandonjëherë habitem edhe vetë. Kujdes, Stounmen!

Stounmeni frenoi në vend.

— Dreqi e mori! — shfryu Biti. — E kalove qoshen ku kthehesh për në kazermë dhe as që e vura re fare.

— Kush është?

— E kush do të jetë tjetër veç meje? — tha Montagu duke u mbështetur me shpatullat pas portës, që sapo e kishte mbyllur, ashtu mes errësirës.

Më së fundi, e shoqja i tha:

— E po, ç'pret që nuk e ndez dritën?

— S'kam nevojë për dritë.

— Hajde në krevat atëherë.

E dëgjoi se si ajo u vërtit me padurim nën mbulesën e shtratit, susta e krevatit kërciti.

— Mos ke pirë gjë? — e pyeti e shoqja.

E kështu, kishte qënë dora që e kishte nisur tërë këtë punë. Ndjeu në fillim njërën dorë, pastaj dhe tjetrën t'i zbërthenin xhupin dhe ta lëshonin të binte mbi dysheme. Me krahun e nderur, i mbajti pantallonat të varura mbi një humnerë dhe pastaj i lëshoi të kridheshin në errësirë. Duart tashmë i ishin molepsur dhe pas pak do t'i molepseshin edhe krahët. Ndjeu helmin se si iu ngjit në pulset, nëpër bërryla e në shpatulla, nga ku pastaj kërceu si nga një trampolinë, si një shkëndijëzë fluturuese mbi një humnerë. Duart e tij s'kishin të ngopur. Dhe sytë e tij kishin nisur të ndienin uri për të parë diçka, çfarëdo gjëje, çdo gjë.

— Po, ç'po bën ashtu? — e pyeti e shoqja.

Ai qëndronte në hapësirë në baraspeshim, varej në zbrazëtirë me librin mes gishtave të lagur nga një djersë e ftohtë.

Një minutë më pas ajo i tha:

— Të paktën, më bëj një nder, mos rri ashtu më këmbë në mes të dhomës.

Ai seç belbëzoi diçka që s'merrej vesh.

— Çfarë? — pyeti ajo.

Montagu u përpoq të bënte sa më pak zhurmë me lëvizjet e tij. U drejtua qorrazi për nga krevati dhe me një lëvizje të ngathët e futi librin nën jastëkun e ftohtë. Më në fund, u lëshua mbi shtrat, dhe gruaja lëshoi një klithmë të mbytur, e trembur. Ai qëndroi i shtirë larg nga ajo, në cepin tjetër të krevatit, një ishull dimëror i ndarë nga një det i shkretë. E shoqja nisi t'i fliste dhe atij iu duk sikur i foli për një copë herë të gjatë, i foli për këtë e i foli për atë, dhe s'ishin veçse fjalë si ato fjalët që ai kishte dëgjuar njëherë në shtëpinë e një miku, në dhomën e fëmijëve, ku një kalama dy vjeç sajonte modele fjalësh, në atë zhargonin e më të vegjëlve, duke lëshuar në ajër ca tinguj të lezetshëm, të pakuptimtë. Montagu s'i thoshte asgjë si përgjigje dhe, si shkoi një copë herë, pasi ai nxori veç ca belbëzime, ndjeu se si e shoqja zuri t'i avitej jastëkut të tij e të zgjaste dorën nga ai, që t'i çikte faqen. Kur ia preku fytyrën, atëherë ajo e mori vesh se ai e kishte atë të lagur.

Më vonë, po asaj natë, ai u kthye që të vështronte Mildredin. Ajo ishte zgjuar. Në ajër ndihej një vallëzim i lehtë melodish; ajo i kishte ende në vesh kapsulat, ashtu e kredhur, siç ishte, tek dëgjonte njerëz të largët që i flisnin nga vende të largëta, me sytë të zgurdulluar, të ngulur në humnerën e territ që kishte nën tavan, përmbi vete.

Iu kujtua ajo historia e vjetër që rrëfente për atë gruan që fliste aq shumë në telefon, saqë i shoqi, i dëshpëruar sa më s'bëhej, kishte bërë një vrap gjer tek telefoni më i afërt publik, që ta pyeste të shoqen se ç'kishin për të ngrënë për drekë? E kështu pra, pse s'vinte edhe ai të blinte ndonjë stacion radiotransmetues për mikrokufje kapsulë, që në mes të natës të mund të fliste me të, me të shoqen, t'i murmuriste, ta përshëndeste, t'i thërriste, të ulërinte, të bërtiste? Por çfarë do t'i belbëzonte, për çfarë do t'i ulërinte? Çfarë mund t'i thoshte ai?

Befas ajo iu duk aq e huaj dhe e panjohur, saqë s'qe i zoti t'ia mbushte dot mendjen vetes se e kishte njohur ndonjëherë këtë njeri. I bëhej sikur të kishte

hyrë në shtëpinë e ndonjë tjetri, si tek ajo barcaleta për atë zotërinë që, tek kthehet në shtëpi pas mesnate, i dehur, ngatërron portën e vet e vete e futet në një apartament tjetër, hyn në krevat të një të panjohure dhe në mëngjes herët çohet që të shkojë në punë, e kështu as njëri e as tjetra s'marrin vesh se ç'ka ndodhur.

— Mili....? — belbëzoi.

— Ëh?

— Nuk doja të të shqetësoja. Po doja të dija.

— Çfarë?

— Kur jemi takuar bashkë? E ku?

— Kur jemi takuar... për çfarë të takoheshim?

— Jo. Doja të thosha kur jemi njohur për herë të parë.

E mori me mend se atë çast e shoqja në errësirë kishte vrenjtur ballin.

E përsëriti pyetjen që t'ia bënte më të qartë:

— Hera e parë që jemi takuar bashkë, ku ka qenë? E kur ka ndodhur?

— Dreqi e mori, po, ishte...

Mildredi e preu fjalën në mes.

— Nuk e di, — tha.

Burri ndjeu t'i hynte një e ftohtë e madhe.

— Nuk e mban mend?

— Ka kaluar gjithë ajo kohë.

— Vetëm dhjetë vjet bëhen, vetëm dhjetë vjet!

— E po, tani, mos u bëj nevrik, po mundohem ta kujtoj.

Dhe ia plasi një të qeshure që u shpërnda përreth valë-valë.

— Sa për të qeshur që është, o zot, sa për të qeshur, të mos mbash dot mend se ku e qysh je njohur me tët shoq apo me tët shoqe!

Ai po rrinte i shtirë duke fërkuar ngadalë syte, ballin, pastaj qafën nga mbrapa. Pastaj i vuri duart mbi sy dhe nisi t'i shtypte vazhdimisht, si të donte ashtu të ngulitste aty fort atë çka kërkonte të sillte ndër mend. Befas, kjo u bë për të gjëja më e rëndësishme

e jetës së tij, të kujtonte ku e kishte parë për herë të parë Mildredin.

— E po, ç'rëndësi ka, fundja! — Ajo ishte çuar e kishte hyrë në banjë, nga ku dëgjohej zhurma e ujit që rridhte nga rubineti, si dhe zhurma që bënte ajo me grykë, tek pinte ujë për të gëlltitur hapet.

— Mbase vërtet nuk ka rëndësi, — tha ai.

U rrek të numëronte sa hape kishte gëlltitur ajo dhe solli në mendje vizitën e atyre dy infermierëve me fytyrë si prej oksid zinku, me ato cigaret e futura në atë të çarë horizontale, që kishin në vend të gojës, pa sërish Gjarprin me sy Elektronik, që po futej pak e nga pak e duke gjarpëruar në atë errësirë, në ato shtresa guri dhe uji të amullt pranveror, dhe atëherë i lindi dëshira t'i thërriste së shoqes, ta pyeste atë, duke i ulërirë: «Sa hape ke pirë sonte? Sa do të pish më vonë, ashtu pa e pasur mendjen e duke vijuar përjetësisht kështu? Çdo orë nga një dozë të re? Sonte mbase jo, por nesër mbrëma po! E ndërkohë unë sonte s'fle, s'do të fle as nesër mbrëma, as shumë e shumë net të tjera, tanimë që nisi kjo histori». Dhe e përfytyroi atë ashtu të shtrirë në krevat, me ata dy teknikët që i rrinin më këmbë te koka, jo të përkulur mbi të e tërë merak, por thjesht rrinin të ngulur si dy hunj pranë jastëkut, me krahët të kryqëzuar mbi gjoks. Dhe iu kujtua se si atë çast me vete kishte menduar se, sikur të vdiste Mildredi, ai me siguri që nuk kishte për të qarë. Sepse do të qe vdekja e një njeriu të panjohur, fytyra e një kalimtari, një shëmbëlltyrë që e ke parë diku në gazetë, dhe papritur iu duk kjo një gjë aq e padrejtë, saqë zuri të qante, jo për vdekjen, por për mendimin se, po qe se vdiste ajo, ai nuk do të mundte të qante dot, ai një burrë mendjelehtë e bosh, për një grua mendjelehtë e boshe, e kjo ndërkohë që ai gjarpri i uritur vazhdonte ta zbrazte atë pa pushim...

«Po pse vallë gjithë ky boshllëk? — mendoi me vete. — Kush të ka zbrazur nga të gjitha? Ç'lule e tmerrshme që ishte ajo lule radhiqja që kishte parë

atje! Ajo lule i kishte përmbledhur të gjitha, i kishte rrëfyer për të gjitha, apo nuk është ashtu?»

«Sa keq! Ti nuk dashke asnjerî!»

Pse, a nuk ishte ashtu vërtet?

Pse, ta mendoje mirë, a nuk ishte i ndarë ai me Mildredin me një si mur? Madje, jo vetëm me një, po gjer tani me tre! E, bile, edhe të kushtueshëm. Dhe ata xhaxhallarët, tezet, nipërit, meshkuj e femra, që jetonin brenda atyre pareteve, ajo tufë majmunësh dërdëllitës që nuk thoshin asgjë prej gjëje, asgjë, asgjë, por që ama këlthisnin aq fort, fort, fort! Ishte mësuar që në fillim t'i quante kushërinj.

— Si ia çon xha Luisi sot?

— Kush?

— Po teze Modi?

Në të vërtetë, kujtimi më domethënës që ai ruante në mendje nga Mildredi ishte ai i një çupe mes një pylli pa drurë (ç'absurditet?) apo, më mirë të thuash, ai i një çupe të humbur në një rrafshnaltë, ku njëherë e një kohë kishte pasur drurë (e ndiente ende gjithë përreth kujtimin e formave të tyre), që rrinte e ulur mu në mes të «dhomës së ndenjjes», në *livingroom:* ama, ç'emër i bukur, për një dhomë që veç ta shihje tani se si ishte katandisur!

Në çfarëdo ore që të kthehej ai në shtëpi, paretet ishin gjithnjë në punë, shtruar në muhabet me Mildredin.

— I duhet gjetur ilaçi kësaj pune, duhet bërë diçka!

— Po, diçka duhet bërë!

— E po, atëherë, mos e humbim kohën kot me llafe!

— E pse jo?

— Jam aq i nxehur, sa gati sa s'po nxjerr shkumë nga tërbimi!

E përse të gjitha këto? Mildredi vetë s'e dinte kush ishte aq i nxehur e për faj të kujt? Mildredi as që e dinte. E ç'u mbetej atyre të bënin? Të rrinin e të bënin sehir, thoshte Mildredi, se si do të shkonin punët.

Dhe ai kishte ndenjur të shihte se si do të venin punët.

Një breshëri bubullimash të stuhishme qenë shembur përmbi paretet. Muzika kishte nisur ta bombardonte me një intensitet aq të fuqishëm, saqë atij thuajse i qenë shkulur eshtrat nga penjëzat; e ai kishte ndier se si i dridhej çaguli i nofullës, se si sytë i kishin kërcyer përtej gogullave. Tashmë ai ishte bërë një viktimë e përhershme e zhvendosjes së ajrit. Gjersa, më në fund, e ndjeu veten si një njeri që e kanë gremisur në një greminë, që po vërtitet në një centrifugë që e kanë vërtitur në një ujëvarë që kokëngulthonte në pafundësi drejt një zbrazëtie gjithnjë e më tepër të avushtë, pa arritur asnjëherë të çikë fundin e së TËRËS, pa çikur kurrë ndonjëherë në fund... e po binte kaq rrëmbimthi, saqë nuk arrinte të takonte asnjëherë, qoftë makar edhe anët, s'arrinte të takonte dot asgjë, asnjëgjë.

Pastaj bubullimat qenë mehur. Muzika qe fikur.

«Ja, pra, — i kishte thënë Mildredi. — A s'është tronditëse?»

Dhe ashtu vërtet: kishte ndodhur diçka tronditëse. Diçka po ndodhte. Megjithëse njerëzit që dilnin në paretet e dhomës as që kishin luajtur nga vendi, e në të vërtetë atyre asgjë s'u kishte ngjarë, prapë të bëhej të mendoje se dikush kishte vënë në lëvizje një makinë rrobalarëse ose të kishte përthithur nën një enë të qelqtë, nga ato që përdoren për të krijuar një boshllëk absolut. Ndiheshe i zhytur në një muzikë të kulluar dhe në një kakafoni të kulluar. Ai doli nga salloni, i mbuluar me djersë, si i përçartur. Pas kurrizit të tij, Mildredi vazhdonte të rrinte e ulur në kolltukun ku rrinte zakonisht, dhe zërat vazhdonin avazin e tyre.

«E po mirë atëherë, tani e tutje gjithçka ka për të shkuar fjollë», — thoshte njëra teze.

«Oh, mos ji kaq e sigurt», — thoshte një kushërirë.

«Nuk ke përse të nxehesh!»

«Kush po nxehet?»

«Po ti!»

«Unë?!»

«Bile, s'je fare në vete!»

«E pse s'qenkam në vete?»

«Sepse... sepse!»

— Të gjitha këto mbase janë edhe shumë të bukura, — thirri një ditë prej ditësh Montagu. — Por, ama, ç'dreqin kanë që nxehen kaq shumë? Pastaj i di ti kush janë vallë gjithë këta njerëz? Cili është ky burri? Po kjo gruaja? A janë gjë burrë e grua, apo janë të ndarë, të fejuar, apo çfarë? O zot i madh, këtu gjithçka është e shthurur, është një kaos i tërë!

— Ata aty, e kupton... — i thoshte Mildredi — po, po, ata e dinë se ç'do gjë do të thotë luftë. S'e ke idenë se sa zihen me njëri-tjetrin. Veç të rrish e t'i dëgjosh. Besoj se duhet të jenë të martuar. Po, po, janë burrë e grua. Po ti pse pyet?

Po dhe ja, ta zemë, se s'ishin ato tri parete TV, që së shpejti kishin për t'u bërë katër, duke e kthyer kështu ëndrrën në realitet, prapë mbeste makina e Mildredit, të cilën ajo e ngiste edhe nëpër qytet me njëqind milje në orë, ndërkohë që ai i jepte këshilla e ajo i kthente përgjigje gjithë duke ulërirë, që të dy duke u munduar të kuptonin se ç'thoshte tjetri, por që s'dëgjonin dot veçse uturimën e makinës.

«Ule në minimum shpejtësinë!» — i thërriste ai.

«Çfarë?» — ajo.

«Mbaje me pesëdhjetë e pesë, në minimum!»

«Po kë të mbaj?» — këlthiste Mildredi.

«Shpejtësinë, kë tjetër!» — çirrej Montagu.

Pas kësaj, Mildredi e çonte shpejtësinë në njëqind e pesë në orë, duke e lënë atë gojëhapët, ngaqë s'merrte dot frymë. Dhe, kur zbriste nga makina, Mildredi i kishte prapë veshët të tamponuar me kapsulën e radios.

Heshtje. Tani ndihej fryma e lehtë e erës.

— Mildred. — Dhe ai u vërtit në krevat.

Me zor zgjati krahun dhe, më së fundi, arriti t'ia hiqte nga veshi atë insekt muzikor të imët.

— Mildred, Mildred.

— Hë, — zëri i saj ishte i dobët.

Iu bë sikur edhe ai vetë ishte një krijesë elektronike e futur në ato parete me fonokolor, që po fliste, por veç fjalët që nxirrte s'arrinin dot të shponin barrierën e kristaltë. S'i mbetej veç të përdorte pantomimën, me shpresë se mos ajo do të kthehej nga ai dhe do ta shikonte. Kur je i ndarë nga një xham, s'e prek dot tjetrin.

— Mildred, ti e njeh atë vajzën për të cilën të kam folur, apo jo?

— Cilën vajzë?— Mildredi i foli si nëpër gjumë.

— Atë vajzën e shtëpisë ngjitur me tonën.

— Cilës shtëpi ngjitur me tonën?

— E po, ajo vajza që është në shkollën e mesme. Klarisa e quajnë.

— Ah, po, — tha Mildredi.

— Ka ca ditë që s'e kam parë.... Katër ditë, që të jem i saktë.. Ti e ke parë gjë?

— Jo.

— Kisha ndër mend të të flisja për të. Ç'gjë e çuditshme!

— Ah, tani e kuptova se për cilën vajzë e ke fjalën.

— Ashtu!

— Po, po, ajo vajza, — foli Mildredi në terrin e dhomës.

— Ç'do të thuash?

— Kisha ndër mend të të flisja. Por ja që më doli nga mendja. Më doli nga mendja.

— E po mirë, ke akoma kohë të ma thuash tani. Pa të dëgjojmë.

— Besoj se ka ikur.

— Ka ikur?

— E gjithë familja e saj është shpërngulur gjetiu. Por ajo ka ikur përgjithmonë. Besoj se duhet të ketë vdekur.

— Me sa duket, po flasim për njerëz të ndryshëm.

— Jo, jo, për atë po flas, për Maklellënin, apo s'quhej kështu? Maklellën. E shtypi një makinë. Ka nja katër ditë. Fare e sigurt s'jam, por, për mendimin tim,

ajo duhet të ketë vdekur. Sidoqoftë familja e saj u shpërngul në një vend tjetër. Me siguri s'e di, por më duket se ajo ka vdekur.

— Por ama e sigurt nuk je.

— Jo, s'jam e sigurt. E ç'them, po, po, e sigurt jam.

— Por, pse s'ma the që më parë?

— Sepse harrova.

— Që prej katër ditësh!

— Mua më doli fare nga mendja.

— Që prej katër ditësh, — përsëriti ai me zë të ulët, i shtrirë në krevat.

Po qëndronin që të dy shtrirë në atë dhomë të errët, të palëvizur, që të dy të ngrirë.

— Natën e mirë! — tha Mildredi.

Montagu dëgjoi një fëshfëritje fare të lehtë. Dora e saj kishte lëvizur. I prekur nga dora e saj, cilindri i vogël elektrik po lëvizte përmbi jastëk si një insekt. Dhe tani ishte futur përsëri brenda veshit të Mildredit.

Ai mbajti vesh: e shoqja se ç'po këngëzonte me zë të ulët.

Matanë dritares luajti një hije, një erë vjeshtake ishte çuar dhe tani po zhdukej diku tutje. Por në atë heshtje ai dëgjoi edhe diçka tjetër. Ishte si një frymë që lëshohej kundër dritares, thuajse të qe endja e lehtë e një avulli të shndritshëm gjelbërosh të formuar nga lëvizja e një gjetheje të vetme tepër të madhe vjeshtake, që po e përshkonte livadhin. Pastaj ajo humbi tutje në largësi.

«Zagari, — tha ai me vete, — po u vërtitka në këto anë sonte. Me sa duket, po u sillka këtej rrotull. Sikur të hapja dritaren...»

Por dritaren nuk e hapi.

Të nesërmen në mengjes, kishte të dridhura dhe ethe.

— S'ka mundësi të jesh i sëmurë, — tha Mildredi.

Ai mbylli sytë nga nxehtësia shumë e madhe që i jepnin ethet.

— E megjithatë, jam.

— Po mbrëmë ti ishe fare mirë.

— Jo, nuk isha mirë. — Dëgjoi «kushërinjtë» që po bënin gjithë atë zhurmë në sallon.

E shoqja po i rrinte në këmbë te koka e krevatit, duke e parë me kureshtje. Ai e ndiente që ishte aty, e shihte edhe pa i hapur sytë, ashtu me flokët të përzhitur nga substancat kimike që përdorte, aq sa tani i ishin bërë si një krifë kashte të thatë, me sytë të veshur me një si perde të padukshme, por që prapë të ngjallte dyshimin, se ishte diçka e panatyrshme kur e shihje ashtu të futur mjaft thellë prapa bebëzave, me buzët të skuqura, që sikur theksonin një pakënaqësi të lehtë si prej fëmije, me trupin të hajthëm si ai i një karkaleci, pas dietës për t'u dobësuar që kishte mbajtur, me mishin të kuqërremë në të bardhë, si sallo.

S'e mbante mend veçse kështu të shoqen.

— Më jep një aspirinë dhe pak ujë, po deshe?

— Tani duhet të çohesh, — i tha ajo, — vajti gati mesi i ditës. Ke fjetur pesë orë më shumë nga ç'fle zakonisht.

— A nuk i mbyll dot ato paretet e sallonit?

— Po aty tani janë «kushërinjtë»

— Nuk e bën as për një të sëmurë të shkretë?

— Do të thuash të vete të ul volumin.

Ajo doli nga dhoma dhe u kthye prapë, pa ndryshuar asgjë në sallon.

— Mirë e ke kështu?

— Falemnderit!

— Është programi që më pëlqen më shumë, — foli ajo.

— Po aspirina?

— Hera e parë që po sëmuresh, — dhe ajo doli përsëri nga dhoma.

— E pra, kjo është hera e parë. Sot s'do të shkoj në punë. Lajmëroje Bitin nga ana ime.

— Sonte ishe i çuditshëm. Çfarë kishe? — tha ajo, që ishte kthyer ndërkohë në dhomë, duke këngëzuar nën buzë.

— Po aspirina ku është? — Ai ia kishte ngulur sytë gotës me ujë që po i zgjaste ajo.

— Oh! — Dhe ajo u kthye sërishmi në banjë. — Mos të ndodhi gjësendi mbrëmë?

— Asgjë e veçantë, një zjarr.

— Dje kalova një mbrëmje të këndshme, — foli ajo që nga banjoja.

— Ç'bëre ndonjë gjë të bukur?

— Ndenja në sallon.

— Çfarë kishte?

— Programe.

— Por çfarë programesh?

— Më të mirat që kanë dhënë ndonjëherë.

— Me kë ishin?

— Oh, ti e di, me ekipin e zakonshëm.

— Po, po, ekipi, ekipi. — Shtypi sytë, që i dhimbnin, me mollëzat e gishtërinjve dhe befas era e vajgurit, që s'dihet se nga i erdhi, e bëri të villte.

Mildredi, që hyri në dhomë duke këngëzuar, mbeti e habitur.

— Ç'ke bërë kështu? — i tha e habitur.

Ai pa i trembur dyshemenë.

— Dogjëm të gjallë një plakë bashkë me librat e saj.

— Thuaj mirë që lahet qilimi. — Ajo shkoi të merrte një leckë dhe për një copë herë fshiu me të qilimin.

— Dje mbrëma vajta nga shtëpia e Helenës.

— Pse, s'e shihje dot programin në sallonin tënd?

— Sigurisht që e shihja, por është më qejf kur shkon për vizitë te mikeshat.

Ajo shkoi në sallon. Montagu e dëgjoi që po këngëzonte.

— Mildred? — e thirri ai.

U kthye duke kënduar e duke kërcitur lehtë gishtërinjtë.

— Nuk do ta dish se ç'na ndodhi sonte? — i tha ai.

— Çfarë?

— Dogjëm nja një mijë libra. E bashkë me ta edhe një grua.

— E pastaj?

Salloni gati sa s'po shpërthente nga një orgji e ërë tingujsh.

— Dogjëm libra të Dantes, Suiftit e Mark Aurelit.

— Po ky Mark Aureli mos ka qenë gjë evropian?

— Diçka i atij lloji.

— Mos ka qenë tip turbullues?

— S'kam lexuar ndonjë libër të tij.

— Po me siguri ka qenë njeri turbullues. — Mildredi nisi t'i vinte rrotull telefonit. — Tani, a mos do që ta marr unë në telefon Bitin? Po pse s'e merr vetë?

— Të thashë merre ti!

— Mos fillo të më çirresh tani.

— Unë s'po çirrem. — Befas ai ishte ngritur ndenjur mbi shtrat, ishte i skuqur në fytyrë nga inati dhe dridhej i tëri. Salloni gumëzhinte.

— S'kam si e marr unë në telefon. S'kam si i them që jam i sëmurë.

— E përse?

«Sepse ke frikë, — i tha ai vetes. — Sepse je një çilimi që shtiresh si i sëmurë, që ke frikë të marrësh në telefon, sepse e di që, ca çaste pasi të ketë nisur kjo bisedë, ka për të marrë fund kështu:

«Si urdhëron, kapiten, tani po ndihem më mirë. Në orën dhjetë fiks më ke në kazermë».

— Ti nuk je i sëmurë, — foli Mildredi.

Montagu u shemb mbi krevat. Futi dorën poshtë jastëkut. Libri që kishte fshehur ishte aty.

— Mildred, ç'thua ti sikur... me një fjalë, ta zëmë që unë për ca kohë ta lë punën?

— Do që të heqësh dorë nga të gjitha? Pas gjithë këtyre viteve punë. do t'i lësh të gjitha, vetëm e vetëm ngaqë të ndodhi që një grua me gjithë librat e saj...

— Mili, të kishe qenë aty, ta shihje!

— E ç'kujton ti, se do të më bëhej vonë, gjersa as që e njihja fare! Pastaj, ajo s'ka bërë mirë që mbante libra në shtëpi. Fajin vetë e ka pasur. T'i kishte vënë gishtin kokës që më parë. Të vjen të pëlcasësh, për shkak të saj të lësh punën, që të mbetemi, ti e di fare mirë, në mos të rrugëve, pa shtëpi, pa katandi, pa gjë prej gjëje!

— Ti s'ishe aty, ti s'e pe, — ia nisi prapë ai. — Duhet të ketë diçka të veçantë në librat, diçka që ne as që e marrim dot me mend, gjersa ata e bëjnë një grua të qëndrojë brenda një shtëpie që është duke u djegur. Kjo merret vesh vetiu.

— Ajo grua do të ketë qenë ndonjë mendjefyçkë.

— Ajo arsyetonte më mirë, ndoshta, edhe se ti, edhe se unë, e megjithatë ne e dogjëm të gjallë.

— E po tani, të shkuara të harruara.

— Ke parë ndonjëherë ndonjë shtëpi të përfshirë nga flakët? Vazhdon të digjet për ditë e ditë me radhë, edhe atëherë kur duket sikur gjithçka ka marrë fund. Kështu pra, dhe ai zjarr do të vazhdojë të digjet për mua gjersa të jem i gjallë. Oh, zot, tërë natën u përpoqa ta shuaja në mendjen time. Aq shumë u rreka, sa tani jam gati gjysmë i marrosur.

— Të gjitha këto duhet t'i kishe menduar para se të ishe bërë zjarrtar.

— Të kisha menduar! Se mos kisha gjë unë në dorë? Edhe im gjysh, edhe im atë zjarrtarë kanë qenë. Unë edhe në ëndërr veten zjarrtar e kam parë.

Salloni i gjithë kumbonte nga një muzikë balloje.

— Sot ti duhej të merrje shërbimin me skuadrën e ditës, — tha Mildredi. — Duhet të kishe shkuar të paktën dy orë më parë. Kjo tani sa m'u kujtua.

— Nuk është fjala vetëm për atë grua që u dogj, — ia nisi prapë Montagu. — Sonte mendova për gjithë atë vajguri që kam përdorur tërë këta dhjetë vjet. Mendova edhe për librat.. Dhe për herë të parë e kuptova se pas secilit libër është një njeri. Një njeri që ka vrarë mendjen. Një njeri të cilit i është dashur gjithë ajo kohë për t'i shkruar, për të hedhur mbi kartë tërë ato fjalë. Është një mendim që s'më kishte shkuar kurrë ndër mend para kësaj nate.

Ai u ngrit nga krevati.

— Dikujt i është dashur një jetë e tërë për të hedhur në letër një pjesë të mendimeve të tij, për të parë përreth, që pastaj ta përshkruante jetën dhe botën ashtu siç i shihte ai, kurse ja ku dal unë e

brenda dy minutash... bum! Gjithçka merr fund.

— Pa më ler të qetë! — tha Mildredi. — Unë s'kam bërë asgjë të keqe.

— Të të lë të qetë. Gjë që bëhet lehtë, por si t'ia bëj unë që të lë të qetë veten time? Neve s'na nevojitet qetësia! Kemi nevojë që hërë pas here diçka të na mundojë vërtet! Sa kohë ka shkuar që kur ty s'të ka munduar më asgjë, asgjë serioze, asgjë që të ketë vërtet rëndësi?

Por s'vazhdoi dot më tej, se befas iu kujtua ajo që kishte ndodhur javën që shkoi, gjarpri i pompës e syri hetues e ata dy burrat me fytyra hermetike si prej farmacie, me cigaret që nisnin e u kërcenin ashtu të ngjitura pas buzëve, sa herë që hapnin gojën të flisnin. Po atë herë diçka e mundonte, veç ajo kishte qenë një Mildred tjetër, një Mildred e kredhur kaq thellë brenda kësaj që ai shihte dhe aq e munduar, e munduar seriozisht, për diçka vërtet të rëndësishme, por veç asnjëherë të dy këto gra s'e kishin njohur njëra-tjetrën...

U kthye që të ikte.

Mildredi i tha:

— Dhe ja tani ç'na bëre? Pa shih njëherë përjashta, para shtëpisë se kush ka ardhur?

— E ç'më hyn në punë?

— Një makinë me shenjën e Feniksit sapo u ndal para portës sonë dhe një burrë i veshur me këmishë të zezë e me një gjarpër ngjyrë portokalli të vizatuar në krah po vjen nëpër rruginën e kopshtit.

— Mos është kapiten Biti?

— Pikërisht kapiten Biti.

Montagu s'luajti nga vendi, por ndenji ashtu, me shikimin të ngulur mbi bardhësinë e ftohtë të murit që kishte përballë.

— Shko vrap e hape, të lutem! Thuaji që jam i sëmurë.

— Thuaji vetë! — Mildredi kishte nisur ecejakun nëpër dhomë, ca hapa majtas, ca hapa djathtas, pastaj befas u ndal, me sytë e zgurdulluar, kur altoparlanti i

hyrjes ëmbëlsisht e me zë të ulët shqiptoi emrin e saj: «Zonja Montag, zonja Montag, keni vizitë, vizitë, zonja Montag, zonja Montag, zonja Montag, keni vizitë, keni vizitë.» Përfundoi duke u shuar krejtësisht.

Montagu, si u sigurua që e kishte fshehur mirë librin nën jastëk, u kthye përsëri me mundim në anën tjetër dhe, ashtu gjysmë i shtirë, mbuloi me kuvertë gjunjët e gjoksin dhe ca çaste më pas edhe Mildredit iu mbush mendja që të dilte nga dhoma dhe, më në fund, në dhomë hyri kapiten Biti, me hap të shkujdesur e me duart në xhepa.

— T'i heshtim ca «muret», — tha Biti duke vështruar gjithçka që ishte përreth e më pak se ato Montagun me të shoqen.

Kësaj here Mildredi shkoi me vrap. Zërat dërdëllitës reshtën së bërtituri në sallon.

Kapiten Biti u ul në poltronin më të rehatshëm, me një shprehje të qetë në fytyrën e skuqur. U vonua ca derisa bëri gati e ndezi llullën e, më së fundi, çoi lart një shtëllungë të madhe tymi.

— Mendova të vija e të shihja njëherë se si është i sëmuri.

— Nga e more vesh?

Biti vuri buzën në gaz me atë buzëqeshjen e tij që nxirrte në pah ngjyrën rozë në të karameltë të mishrave të dhëmbëve dhe bardhësinë ngjyrë menteje të vetë dhëmbëve.

— E kisha vënë re se në ç'gjendje shpirtërore ishe. Doje të më kërkoje leje për një natë, apo s'është kështu?

Montagu u ngrit ndenjur mbi shtrat.

— E po, — vijoi Biti, — po qe kështu, merre një natë leje!

Vëreiti atë kutinë e tij të shkrepëseve, që s'e ndante kurrë nga vetja, mbi kapakun e së cilës ishte shkruar me shkronja të mëdha: «*E garantuar për një milion ndezje*», dhe, i shkujdesur nisi të ndizte shkrepëset kimike, një e shkrenur, një e thithur llulle, një e shkrepur, nja dy a tri fjalë, një e thithur llulle.

Vështroi flakën. Çoi lart tymin, ndoqi me sy shtëllungën e tij.

— Kur mendon se do të bëhesh mirë?

— Nesër. Apo pasnesër. Mbase të hënën.

Biti vazhdoi të tymoste llullën me ca të thithura të mëdha.

— S'ka zjarrtar që shpejt a vonë të mos e kalojë një krizë të tillë. Kanë nevojë vetëm që të kuptojnë, të dinë se si funksionon ky mekanizëm. Duhet të njohin historikun e profesionit tonë. Por tani këto janë gjëra që s'u mësohen më rekrutëve tanë, siç bëhej njëherë e një kohë. Për faqe të zezë! — Edhe një të thithur tjetër.— Tanimë ca gjëra të tilla vetëm shefat e milicisë i mbajnë mend. — Një e thithur llulle. — Po ta rrëfej unë.

Mildredi zuri të rregullonte dhomën me njëfarë nervozizmi.

Bitit iu desh një minutë e tërë sa të zinte vend më mirë në kolltuk e të kapte prapë me mendje fillin e asaj që donte të tregonte.

— Do të dish, apo jo, se kur e ka zanafillën ky zanati ynë? Se si nisi, ku e qysh. Me sa di unë, afërsisht në kohën e Luftës Civile, ndonëse në rregulloret tona thuhet se milicia e zjarrtarëve ishte themeluar më parë. E vërteta është se shoqëria filloi të jetonte mirë vetëm pasi fotografia nisi të kishte një jetë të vetën. Pastaj... kinematografia në gjysmën e parë të shekullit të njëzetë. Radioja, televizioni... atëherë filluan gjërat të bëheshin masive.

Montagu nuk luajti nga vendi, por vazhdoi të rrinte ndenjur mbi shtrat.

— E, meqenëse janë masive, vetëkuptohet se u bënë edhe më të thjeshta, — vazhdoi kapiteni. — Njëherë e një kohë librat u drejtoheshin një numri të kufizuar njerëzish, të shpërndarë në hapësira të stërmëdha. Dhe prandaj ata mund të ishin të ndryshëm. Asokohe në botë kishte plot hapësirë të lirë. Por më pas bota erdhi e u mbush gjithnjë e më shumë me sy, me bërryla, me gojëra. Populllsia u dyfishua, u trefishua, u

Pjesë të zgjedhura nga përmbledhjet e lëngut të lëngut. Fakte e probleme shoqërore? Një kolonë, dy fraza, një titull. Pas pak asgjë s'të mbetet në tru. Truri i njeriut nis e vërtitet me aq shpejtësi, nën këtë shtytje të botuesve, shfrytëzuesve, radiospekulatorëve, saqë forca centrifuge zhvendoset tutje, duke i shpërndarë të gjitha mendimet e kota, që s'vlejnë për gjë tjetër veçse për të humbur kohën!

Mildredi kishte nisur të rregullonte shtrojat e krevatit. Montagut i ngriu gjaku kur pa të shoqen që po i rregullonte jastëkun. Pikërisht atë çast ajo po e ngrinte pak në njërën shpatull, për t'i hequr jastëkun, që, pasi ta shpuploste ca, t'ia vinte prapë pas shpine. E pas pak, mbase, do të nxirrte ndonjë klithmë habie, do të zgurdullonte sytë, apo, akoma më thjesht, do të ngrinte dorën e do të thoshte: «Eh, po kjo ç'është?» e do të tregonte librin e fshehur me një shprehje padjallëzie prekëse.

— Koha e zgjatjes së studimeve sa vente e bëhej më e shkurtër, lëndët pakësoheshin, filozofia, historia, filologjia u braktisën, gjuha dhe ortografia liheshin gjithnjë e më tepër pas dore, gjersa erdhi një ditë që u braktisën fare. Jeta sa vente e po bëhej më e menjëhershme, e drejtpërdrejtë, ajo që kishte rëndësi ishte vendi ku punoje, në zyrë apo në fabrikë, se pas orëve të punës argëtimin e gjeje kudo. E ç'të duhej të mësoje gjëra të tjera, po qe se dije të shtypje butone, të rrotullloje doreza, të ulje leva, të futje dado e vidha?

— Lëshoje pak jastëkun, — i foli Mildredi.

— Jo, — ulëriti Montagu.

— Zinxhiri automatik i nxori kopsat jashtë përdorimit, kështu që njeriu e humbi edhe atë pak kohë që kishte në mëngjes, kur vishej e bëhej gati për të shkuar në punë, për të menduar, humbi një orë meditimi, filozofimi, domethënë një orë të trishtuar.

— Lëshoje, pra, — i foli Mildredi.

— Ik! — i tha Montagu.

— Në këtë mënyrë vetë jeta u bë një dërdëllitje e zgjatur, pa pikën e thelbit, Montag, gjithçka u kthye

në një pasthirrmë kumbuese të zbrazët.

— Ahaah! — ia bëri Mildredi, që i dha një të goditur jastëkut.

— Për hir të zotit, pa më lër rehat! — thirri Montagu tërë duf.

Biti po i vështronte që të dy me habi.

Dora e Mildredit u duk sikur ngriu nën jastëk. Gishtërinjtë ndoqën sipërfaqen e librit dhe, pak nga pak, tek forma, po i tregonte atë që kishte në dorë, në fytyrën e saj u duk më parë një shprehje habie e madhe e pastaj befas sikur u shtang. Hapi gojën, si të donte të bënte një pyetje...

— Mundet, Montag, që t'i boshatisësh teatrot nga gjithçka tjetër me përjashtim të palaçove, ta bësh çdo dhomë me parete të qelqta, me ca vizatime shumëngjyrëshe, që të hipin e të zdrypin nëpër këto parete, si të qenë gjak, apo sheribrendi, apo verë burgonje. Ty të pëlqen bejsbolli, apo jo, Montag?

— Është lojë mjaft e bukur.

Tashmë Biti ishte bërë thuajse i padukshëm, një zë i fshehur në një pikë të papërcaktuar, pas një perdeje tymi.

— Po kjo ç'është? — pyeti Mildredi thuajse me gëzim. Montagu u lëshua mbi krahun e së shoqes me tërë peshën e trupit. — Ç'është kjo këtu?

— Ulu dhe hesht, — i ulëriti Montagu. Mildredi u largua me duart bosh. — S'e sheh që po flasim?

Biti vazhdoi me tonin e mëparshëm.

— Po me boçe të pëlqen të luash, Montag?

— Oh, me boçe, shumë.

— Po golfi?

— Edhe ai.

— Basketbolli?

— Lojë shumë e bukur.

— Po bilardoja! Futbolli? Regbija?

— Të gjitha janë lojëra të mrekullueshme!

— Sa më tepër sporte, argëtim e zbavitje, humbje e mendjes, gjithnjë i rrethuar nga njerëz, e kështu ti nuk mendon më, apo jo? Të organizosh, riorganizosh,

stërorganizosh super-super-sporte! Sa më shumë pjesë humoristike, sa më shumë ilustrime nëpër libra! Ushqim për mendjen sa më pak. Rezultati, të gjithë janë gjithnjë e më të paduruar, të trazuar, e të shqetësuar. Autostradat dhe rrugët e tjera të çdo lloji janë të mbushura me njerëz që shkojnë nga të gjitha anët, ngado qoftë, që është njëlloj si të mos shkosh asgjëkundi. Refugjatët e benzinës, endacakët e makinave. Qytetet po shndërrohen në autohotele ambulante, njerëzit, që gjithnjë e më tepër po jepen pas nomadizmit, shkojnë nga një vend te tjetri, duke ndjekur baticat hënore, duke e kaluar natën në atë dhomë ku sot ishe ti, kurse natën që shkoi isha unë.

Mildredi doli nga dhoma duke e përplasur derën. «Tezet» e sallonit zunë ta ngacmonin «dajkot» e sallonit.

— Të shohim tani çështjen e pakicave që ekzistojnë në gjirin e qytetërimit tonë. Sa më e madhe është popullsia, aq më të shumta pakicat.

Dhe hap sytë se mos fyesh kinofilët,[1]) apo maniakët pas maceve, apo mjekët, avokatët, tregtarët, shefat e mëdhenj, mormonët, baptistët, unitët, pinjojtë e kinezëve, pasardhësit e suedezëve, italianëve, gjermanëve, teksianët, bruklinianët, irlandezët, banorët e Oregonit apo të Meksikos. Heronjtë e këtij libri, kësaj komedie, apo këtij programi që jep televizioni s'duhet ta hedhin fjalën, qoftë edhe nga larg, për piktorë, kartografë, mekanikë realë, të cilitdo vendi a qyteti. Mbaje mend, Montag, sa më i gjërë të jetë tregu, aq më shumë duhet të kesh kujdes që t'i shmangësh mosmarrëveshjet. Mos e dhëntë zoti që të fyesh ndonjë prej tyre! Shkrimtarët, të cilëve u zien mendja nga mendimet e liga, le t'u vënë çelësin makinave të tyre të shkrimit. Dhe ashtu kanë bërë vërtet! Revistat u shndërruan në një përzierje të lezetshme shurupi me vanile. Librat, siç shpallën kritikët, ata snobë të mall-

1) Kështu quhen ata që duan qentë dhe kujdesen për mbrojtjen e tyre.

kuar, s'ishin veçse një lëtyrë. S'është për t'u çuditur që librat s'shiten më, thoshin kritikët. Por publiku, që e dinte mirë se ç'donte, i braktisi librat, por, fatlumtërisht, i la librat e revistat me komikse.

Përveç tyre, natyrisht, edhe revistat erotike me tri dimensione. Ja tek jemi, Montag, e merr vesh? Në zanafillë të kësaj historie është teknologjia, shfrytëzimi i masave dhe presioni që ushtronin makinat, që, më në fund, ia mbërritën qëllimit! Sot, falë tyre, ti i ke të gjitha mundësitë të rrosh në paqe e i kënaqur për njëzet e katër orë që ka dita, duke lexuar komikset, gjithfarë lloj predikimesh e botimesh reklame.

— Mirë, po puna e zjarrtarëve? — tha Montagu.

— Ah! — Biti u zgjat përpara, mes resë së tymit që lëshonte llulla. — Kjo merret vesh vetvetiu, dreqi e mori! Kur shkollat zunë të nxirrnin sa vente e më tepër vrapues, kërcyes, kaldaistë, riparues motorësh, pilotë dhe shoferë garash, në vend të profesorëve, kritikëve, dijetarëve e artistëve, natyrisht që edhe vetë termi «intelektual» u bë një sharje, ashtu siç e meriton në jetë. Njeriu s'para i ka qejf gjërat që s'janë të zakonshme. E kush nga ne, kur ishim fëmijë, s'ka pasur në shkollë nga ata të parët e klasës, djalkën më të mençur nga të tjerët, që di gjithnjë si t'u japë përgjigje makar edhe pyetjeve më të zorshme, ndërkohë që të tjerët rrinë të ulur si ca kukulla druri dhe e urrejnë atë me tërë shpirt? Pse, kur mbaronte shkolla, a nuk zgjidhje gjithnjë këtë djalkë më të mençur nga të tjerët për ta rrahur e për ta sfilitur? S'ka si të jetë ndryshe! Ne duhet të jemi të gjithë njëlloj. Jo se me të vërtetë gjithsecili lind i lirë e i barabartë, siç thotë Kushtetuta, por gjithkush bëhet i barabartë. Le të bëhen njerëzit të ngjashëm me njëri-tjetrin si dy pika uji; paskëtaj të gjithë do të jenë të lumtur, sepse s'ke më male përpara, që, mjaft t'i shohësh, që të të lërë zemra; s'ke më male, me të cilat je i detyruar të vesh e të matësh shtatin tënd! Ja pse një libër në shtëpinë e komshiut është njëlloj si një pushkë e ngrehur kundër teje. Atëherë, t'i hedhim në zjarr!

Ta bëjmë këtë armë të padëmshme. T'ia tredhim mendjen njeriut. E kush e merr dot vesh se ç'synime ka një njeri i mësuar? Kështu që, kur nisën të ngriheshin shtëpi të mbrojtura nga zjarri, as që qe më nevoja për zjarrfikës, për pompierë, që të vinin e të shuanin zjarret duke u hedhur ujë. Atyre u ngarkuan detyra të reja, ata u caktuan si mbrojtës të paqes sonë shpirtërore, u bënë boshti i asaj frike të kuptueshme e që me plot të drejtë ne kemi se mos dukemi më poshtë se të tjerët; ata u bënë censorë gjykues, ekzekutues. I tillë je ti, Montag, i tillë jam edhe unë.

U hap dera e sallonit dhe në prag të saj u duk Mildredi, që qëndroi aty e palëvizur, duke vështruar në fillim Bitin e pastaj Montagun. Prapa saj paretet ishin përmbytur me fishekzjarre të gjelbra, të verdha e ngjyrë portokalli, që shpërthenin e plasnin mes një muzike të përbërë thuajse tërësisht nga tambure, tam-tame dhe përplasje pjatash. Buzët e saj lëviznin, ajo po thoshte diçka, që muzika nuk e linte të dëgjohej.

Biti shkundi llullën mbi pëllëmbën e skuqur të dorës, pastaj nisi të këqyrte hirin, si të qe ai një simbol që i duhej ta studionte, që të mund të diagnostikonte aty një domethënie të fshehtë.

— Mos harro se qytetërimi ynë është aq i gjërë, saqë ne s'ia dalim dot që të lejojmë pakicat tona të jenë në një gjendje trazire dhe shqetësimi. Ja, bëje edhe vetë pyetjen: cila është ajo gjë që na rëndon më shumë se gjithçka tjetër në këtë vend? Njerëzit duan të jenë të lumtur, apo jo? A nuk dëgjojmë të na thuhet kjo që kur kemi dalë në botë? Dua pak lumturi, thonë njerëzit. E pra, a nuk e kanë atë tani? Ne i mbajmë vazhdimisht në lëvizje, u japim atyre pareshtur mundësinë të zbaviten? Pse, a s'jetojmë për këtë, në fund të fundit? A s'jetojmë që të jemi të kënaqur, të provojmë ca gudulira. As ti vetë nuk ke si e mohon që ky lloj qytetërimi që kemi ne, gudulirat i ka me bollëk...

— Nuk e mohoj.

Montagu arriti të lexonte nga lëvizja e buzëve atë ç'ka po thoshte Mildredi që nga pragu i derës, por e detyroi veten që të mos shihte andej, nga frika se mos edhe Biti kthehej dhe lexonte atë ç'ka thoshin buzët e gruas.

— Njerëzve me ngjyrë nuk u pëlqen libri «*Zezaku i vogël Sambo.*» Ta djegim, atëherë. Të bardhët janë të pakënaqur nga «*Kasollja e xha Tomit.*» E djegim edhe atë. Ka shkruar dikush një libër për duhanin dhe kancerin e mushkërive? Fabrikantëve të duhanit dhe atyre që e pinë u vjen për të qarë. Në zjarr vaftë edhe ky libër! Qetësia, Montag. Paqja, Montag. Betejat e tua duhet të dish t'i bësh me dhelpëri. A janë të dhimbshme e pagane funeralet? Atëherë t'i heqim edhe ritet mortare. Pesë minuta pasi ka vdekur njeriu, kufoma ndodhet në një helikopter nga ata të shërbimeve të shpejta, që e shpie në krematoriumin e gjithë kombit. Dhjetë minuta më pas nga ky individ s'mbetet më gjë tjetër veç një grimcë, pluhuri të zi, një copëz bloze. S'kemi nge ne të merremi me dërdëllitje, për ca njerëz të cilëve u dashka përjetësuar emri në shërbimet mortore. As që e vlen ta vrasim mendjen për këtë! Të gjitha i djegim, e djegim çdo gjë! Zjarri është dritë, por së pari është spastrim.

Prapa shpinës së Mildredit, në sallon, fishekzjarret u shuan. Bashkë me to edhe ajo pushoi së foluri: një koincidencë e mrekullueshme. Montagu mori frymë, i lehtësuar.

— Në familjen e komshinjve tanë ishte një vajzë, — foli ai ngadalë. — Tani s'është më, besoj ka vdekur. S'ia mbaj dot mend as fytyrën. Por ajo ishte ndryshe nga gjithë të tjerët. Si... si është e mundur kjo?

Biti vuri buzën në gaz.

— Është diçka që ndodh akoma herë këtu e herë atje. — Klarisa Maklellën, ëh? Në arkivin tonë ekziston një praktikë e tërë për familjen e saj. I kemi në mbikqyrje me kujdesin më të madh. Trashëgimia e ambienti janë gjëra të çuditshme. Nuk ke si shpëton trenda disa vjetësh nga të tërë ata që devijojnë.

Ambienti i shtëpisë është në gjendje të shkatërrojë një pjesë të madhe të asaj që t'i përpiqesh të ndërtosh në shkollë. Prandaj edhe ne gjithnjë e më tepër e kemi ulur moshën në të cilën prindi është i detyruar ta lërë fëmijën në çerdhe, aq sa sot praktikisht ne ia rrëmbejmë fëmijën ambientit shtëpiak që kur është ende në pelena. Për Maklellanët kemi pasur sinjalizime që kur ata banonin në Çikago, por veçse qenë të rreme. Asnjëherë s'arritëm t'u gjejmë qoftë edhe një libër të vetëm në shtëpi. Xhaxhai i saj kishte një dosje pak a shumë kontradiktore: shkurt fjala ishte një tip antishoqëror. Po vajza? Ishte një bombë me sahat. Subkoshienca e saj ishte formuar nga familja, për këtë jam i bindur, mjafton të shikosh skedën që ka ajo në shkollë. Për shembull, ajo interesohej të dinte jo *se si* ishte bërë diçka, por *përse* ishte bërë. E kjo mund të bëhej shqetësuese. Pyet përsenë e shumë gjërave, por i ziu ti po vazhdove kështu: ke rrezik të dënohesh, që të mbetesh fatkeq përjetë. Për atë vajzë të shkretë u bë shumë mirë që vdiq.

— Ashtu është, për të është më mirë që vdiq.

— Për fat, njerëz si ajo takohen rrallë. Dimë tani si t'i ndreqim që kur janë ende të vegjël. Një shtëpi s'e ngre dot pa dërrasa e gozhdë. Po qe se do që shtëpia të mos ngrihet, atëherë zhduk gozhdët e dërrasat. Po qe se s'do që një njeri të jetë fatkeq për motive politike, mos i jep kurrë të dyja anët e një problemi, se përndryshe e torturon; jepi vetëm njërën; apo, akoma më mirë, mos i jep asnjërën. Bëj që të harrojë se ekziston në jetë ajo që quhet luftë. Po qe se qeveria është e paaftë, e rënduar nga burokracia, që mbyt popullin me taksa, prano më mirë të tëra këto, sesa t'i japësh rast popullit të zërë të ankohet. Paqja, Montag. Jepi popullit gara ku fiton ai që mban mend më mirë fjalët e këngëve që janë më populloret ose emrin e qyteteve të shteteve të ndryshme të vendit, ose sasinë e grurit që u prodhua në Ajova vitin që shkoi. Mbushjua kokat me të dhëna që s'prishin punë, ngopi me «fakte», aq sa të mos luajnë dot nga vendi, ngaqë janë të rënduar

shumë, por, veç ama, t'u jetë mbushur mendja që janë të informuar vërtet mirë. E pas kësaj atyre do t'u jetë mbushur mendja top se mendojnë, do të kenë idenë se po lëvizin, kurse në të vërtetë janë ngulur në vend si ndonjë shkëmb. Por, ama, do të jenë të lumtur, sepse faktet e këtij lloji janë gjithnjë po ato. Mos u jep atyre asgjë që të jetë e rrëshqitshme apo e errët, si filozofia apo sociologjia, nga ku mund të nxjerrin ca përfundime, që s'të shpien gjëkundi tjetër veç në melankoli e në trishtim. Cilido që, sa herë që ka qejf, është në gjendje të hapë apo të mbyllë një paret TV (dhe sot këtë e bën pjesa më e madhe e qytetarëve), është ku e ku më i lumtur nga cilido tjetër që rreket të rregullojë e të përllogaritë, të matë e të mbyllë në ekuacione gjithësinë e tërë, gjë që, nga ana tjetër, s'bëhet dot pa i shtënë njeriut idenë e vogëlsisë e të padiţurisë së tij, e kjo të fut në një trishtim tepër të madh. E di këtë, sepse e kam provuar edhe vetë, po në dreq shkofshin gjëra të këtij lloji. Ndaj edhe qepju atyre rrathëve të tu sportivë e shëtitjeve që bën, akrobatëve e magjistarëve të tu, marrokëve, autoreaktorëve, motoelikopterëve, grave e gjithçkaje tjetër që ka të bëjë me reflekse të kushtëzuara. Në ndodhtë që komedia të mos vlejë asnjë grosh, që filmi të mos të të pëlqejë, që muzika të jetë e shurdhët, haide luajmë e bëjmë potere në pianon elektronike. Unë me veten time do të pandeh se po kënaqem nga muzika, kurse në të vërtetë kjo s'është gjë tjetër vecse një reagim ndjeshmërie ndaj vibracioneve. Po, e ç'rëndësi ka? Sido që të jetë, mua më pëlqejnë zbavitjet e forta.

Biti u çua.

— Tani më duhet të shkoj. Për sot leksioni mori fund. Shpresoj se e suarova ndonjak gjendjen. Por ajo që s'duhet ta harrosh, Montag, është se ne jemi *Happiness Boys* milicët e gëzimit, ti, unë, zjarrtarët e tjerë. Ne i kundërvihemi asaj pakice shpirtvogël që do t'i bëjë të gjithë fatkeqë me ca teori e ideologji të nga-

tërruara. Ne ia kemi vënë gishtin plagës. Të mbahemi të fortë. Të mos lejojmë që planetin ta përmbytë vërshimi i trishtimit dhe i pesimizmit. Ne kemi besim te ti. Nuk më duket se ti vetë e kupton se sa i rëndësishëm je, se sa i nevojitemi ne të gjithë kësaj botës sonë të lumtur që kemi sot.

Biti ia shtrëngoi Monagut dorën e butë. Montagu vazhdonte të rrinte ndenjur mbi shtrat, sikur e gjithë shtëpia t'i ishte shembur përreth, pa e lënë të luante më nga krevati. Mildredi ishte zhdukur që nga pragu i derës.

— Edhe një gjë tjetër të fundit, — foli përsëri Biti. — Çdo zjarrtar, të paktën një herë gjatë karrierës së tij, e ndien një ngacmim të tillë: «Për çfarë vallë rrëfejnë këta libra?» — e pyet ai veten. Oh, ç'dëshirë e madhe që të vjen për të vjedhur ndonjë, për hir të këtij ngacmimi, ëh, Montag? E pra, ja, unë, të flas hapur, Montag, në kohën time, unë kam lexuar disa libra, që të merrja vesh se kundër kujt duhet të luftoja, dhe ja ku po të them se në ta nuk flitet asgjë prej gjëje! Asgjë që ti mund ta besosh ose që të të hyjë në punë për gjëkafshë. Flasin për njerëz që nuk kanë ekzistuar, fryt i fantazisë, kur është fjala për letërsi, kurse, kur s'ke të bësh me letërsi, atëherë është akoma më keq, ka diskutime profesorësh që e quajnë njëri-tjetrin idiot, ka klithma filozofësh të kapur fytazi me njëri-tjetrin. E që të tërë rendin duke gulçuar sa andej-këndej, kush të shuajë yjet e kush të zërë diellin me dorë. E, në fund të fundit, ta pret mendja, del i humbur.

— Por në ndodhtë, ashtu rastësisht, që një zjarrtar pa dashje të sjellë në shtëpi një libër, ç'bëhet atëherë? — foli Montagu dhe ktheu menjëherë kokën. Porta e hapur tej e tej e vështronte ngultazi me atë syrin e saj të madh të zbrazët.

— Gabim i natyrshëm njerëzor. Së pari ndodh nga kureshtja, — iu përgjigj Biti. — Ne shefave as që na hyn në sy e nuk e prishim gjakun për kaq pak gjë. E lëmë zjarrtarin që ta mbajë librin për njëzet e katër orë. Nëse në krye të njëzet e katër orëve nuk e

ka djegur, ne thjesht shkojmë vetë në shtëpinë e tij dhe ia djegim.

— Natyrisht, — foli Montagu dhe e ndjeu fytin të tharë.

— E po mirë, Montag. Atëherë, do që sonte ta marrësh shërbimin me ndonjë nga skuadrat e turnit të fundit? Mbase shihemi sonte?

— Nuk e di,— tha Montagu.

— Si nuk e di?! — Biti u duk mjaft i habitur.

Montagu mbylli sytë.

— Mbase vij më vonë.

— Të siguroj se kemi për ta ndier mungesën, po s'u duke, — foli Biti duke e futur llullën në xhep me një pamje të shkujdesur.

«S'kam për t'u kthyer më kurrë, sa të jem gjallë», — mendoi me vete Montagu.

— Ki kujdes që ta marrësh veten sa më shpejt, — foli Biti.

Montagu e pa vjedhurazi Bitin se si shkoi tek ajo makina e tij jashtë serie, me një ngjyrë të verdhë, si ajo e flakës llamburitëse, me rrotat ngjyrë të zezë karboni.

Në anën tjetër të rrugës, deri në fund të saj, ngriheshin shtëpitë e tjera, me ato fasadat e tyre të rrafshta. Si i kishte thënë njëherë Klarisa? «Tani s'ka më veranda. Xhaxhai rrëfen se njëherë e një kohë shtëpitë kishin përpara veranda. Dhe shpesh familjet, kur kishin nge, i kalonin aty mbrëmjet duke bërë muhabet ose thjesht ashtu, në heshtje, përkundeshin në karriget lëkundëse, po qe se s'ua kishte qejfi të flisnin. Xhaxhai thotë se arkitektët i hoqën qafe verandat, ngaqë s'ishin estetike. Por xhaxhai thotë se ata thanë kështu vetëm sa për t'i dhënë njëfarë logjike këtij akti, ndërsa arsyeja e vërtetë, e fshehur dhe e maskuar nën të, ka mundësi të ishte se ata nuk donin që njerëzit të rrinin nëpër veranda, ashtu në paqe, pa bërë asgjë, duke u përkundur, duke kuvenduar: sepse kjo lloj jete kolektive atyre nuk u pëlqente. Në kushte të tilla njerëzit flisnin si tepër, kishin kohë të mendonin; e kështu

u erdhi fundi edhe verandave. Edhe kopshteve të vogla që kishte përpara çdo shtëpi. Tanimë s'ka më stola, s'ka më kopshte, ku të mund të ulesh për të kaluar kohën. Pastaj, i keni parë mobiljet? S'ka më karrige lëkundëse. Janë ca si tepër të rehatshme ato. Njerëzia duhet të rrijë më këmbë, duhet të rendë tërë ditën e ditës. Xhaxhai thotë... dhe... e di se ç'më rrëfeu xhaxhai?... Nga ana tjetër, xhaxhai...»

Zëri i Klarisës po zbehej gjithnjë e më shumë.

Montagu u kthye të shihte të shoqen, që po rrinte e ulur në mes të sallonit, duke kuvenduar me një nga folësit e paretit.

«Zonja Montag», — po i thoshte ai duke i folur herë për këtë e herë për atë. «Zonja Montag», dhe prapë niste të fliste për këtë e për atë.

Lidhja me konvertitorin e frekuencës, që u kishte kushtuar njëqind dollarë, e shtonte automatikisht emrin e Mildredit, sa herë që folësi i drejtohej publikut të tij të panjohur, duke bërë një pushim të vogël, që të mund të shtoheshin rrokjet që nevojiteshin. Përveç kësaj, një mekanizëm i posaçëm bënte që të ndryshonin përkatësisht në ekranin e televizorit lëvizjet e buzëve dhe të muskujve të fytyrës së spikerit. Ai ishte tanimë një mik i mirë i familjes, i afërt dhe i dashur.

«Zonja Montag, ju lutem... vështroni drejt këtu tani.» Ajo ktheu ngadalë kokën, megjithëse dukej qartë se nuk po e dëgjonte.

Montagu i tha:

— Të mos shkosh sot në punë apo të mos shkosh nesër, këto s'i ndan veçse një hap, po ashtu edhe si të mos shkosh nesër apo të mos shkosh më kurrë ndonjëherë në kazermën e zjarrtarëve.

— Po sonte, ama, do të shkosh në punë, apo jo? — foli Mildredi.

— Akoma nuk e di. Tani për tani kam përshtypjen e keqe sikur s'dua gjë tjetër veçse t'i thyej të gjitha, t'i shkatërroj të gjitha.

— Pse nuk bën një xhiro me makinë?

— Jo, falemnderit.

— Çelësat e makinës i ke mbi komodinë. Gjithnjë, kur jam në një gjendje të tillë shpirtërore, mua më hipën një dëshirë e madhe ta ngas makinën si e marrë. I jep me nëntëdhjetë e pesë milje në orë dhe e ndien veten për mrekulli. Ka pasur raste që kam ecur me makinë për tërë natën e jam kthyer, kurse ti as që e ke marrë vesh këtë. Shtyp lepuj, ngandonjëherë edhe qen. Dëgjomë mua, shko merr makinën.

— Jo tani nuk dua. Dua ta kuptoj këtë gjendje të çuditshme në të cilën jam. O zot, është diçka më e fortë se unë. E nuk e di mirë se ç'është. Di që jam shumë fatkeq. Jam shumë i acaruar e nuk e di as vetë përse. Njëlloj sikur befas të jem fryrë ngaqë mbaj shumë brenda vetes. Por çfarë, as vetë s'e di. Ndoshta do të filloj të lexoj edhe libra.

— E këshrtu kanë për të të rrasur brenda, apo jo? — Dhe ajo e vështroi sikur ai të ndodhej prapa një pareti të kristaltë.

Montagu nisi të vishej duke lëvizur nëpër dhomë si një shpirt i munduar.

— Po, mbase është një ide e mirë, të më rrasin brenda para se t'i kem bërë keq ndokujt. E dëgjove se ç'thoshte Biti? E dëgjove kur fliste? E ka gjithnjë përgjigjen në majë të gjuhës ai! Po ka të drejtë. Lumturia është gjë e madhe. Rëndësi ka të humbasësh mendjen. E megjithatë, unë, i ulur këtu mbi shtrat, vazhdoja të thosha me vete: «Nuk jam i lumtur, unë nuk jam i lumtur».

— Kurse unë jam. — Goja e Mildredit shkëlqeu e tëra nga një buzëqeshje. — Dhe jam krenare që jam.

— Unë duhet të bëj diçka, — foli Montagu, — megjithëse s'e di akoma se çfarë, por, ama, diçka duhet të bëj, diçka që të jetë mjaft e madhe.

— U lodha duke dëgjuar gjithë këto budallallëqe, — tha Mildredi dhe u kthye përsëri për nga folësi i paretit.

Montagu shtypi butonin e zërit të paretit, dhe folësi menjëherë heshti.

— Mili! — tha dhe heshti. — Kjo shtëpi është sa

jotja aq edhe imja. Ndaj dhe më duket e drejtë dhe e kam për detyrë të të them diçka. Duhet të ta kisha thënë prej kohë, por s'isha ende gati t'i hapesha as edhe vetes sime; kam diçka që dua të ta tregoj, diçka që e kam hequr mënjanë pak e nga pak, që kam një vit që e mbaj të fshehur, pa ditur as vetë përse, por këtë e bëra e ty s'ta kam thënë kurrë.

Vuri dorën te një karrige me shpinore të drejtë dhe ngadalë, por pa asnjë ngurrim, e shtyu atë drejt paradhomës, gjer afër portës së hyrjes, pastaj, si i hipi sipër, mbeti për një çast i palëvizur, si një statujë mbi piedestalin e vet, ndërkohë që e shoqja te këmbët e tij rrinte e vështronte në pritje. Më në fund, Montagu zgjati krahun, hapi me rrëmbim kapakun në formë grile të pajisjes së ajrit të kondicionuar, futi thellë brenda nga e djathta dorën, ku seç luajti, duke hapur një sportel metalik. Dora u kthye jashtë me një libër. Pa i hedhur fare sytë, Montagu e hodhi përtokë dhe e futi prapë dorën thellë brenda, nxori nga vendi i fshehtë dy libra të tjerë dhe i lëshoi dhe ata mbi dysheme. Vazhdoi kështu për një copë herë të hidhte libra përtokë, ca libra të trashë, pastaj libërtha, të çdo ngjyre: të verdhë, të kuq, jeshilë. Si mbaroi, i hodhi për herë të parë një shikim dyshemesë dhe pa aty te këmbët e Mildredit rreth nja njëzet libra.

— Më fal, — i tha. — S'e kisha menduar asnjëherë seriozisht këtë punë. Por tani del sikur ne të dy jemi ngatërruar në njëfarë bashkëfajësie.

Mildredi u zbyth, si të kishte parë befas një tufë minjsh që ishin lëshuar nëpër dysheme. Montagu e ndjeu se si ajo po gulçonte nga mundimi dhe e pa fytyrën e së shoqes se si u zbeh, me sytë të zgurdulluar e të ngrirë. Ajo e përsëriti emrin e tij, dy, tri herë. Pastaj, duke rënkuar, shkoi me vrap, rrëmbeu një libër dhe u largua po me vrap drejt hirëzuesit të kuzhinës.

Montagu arriti ta ndalonte, ndërkohë që ajo lëshoi një klithmë. E mbajti fort, kurse ajo përpëlitej, përpiqej t'i ikte duke e gërvishtur.

— Mos, Mili, mos! Prit! Mjaft, të lutem! Ti nuk e di... Po mjaft, pra!

I ra një shpullë, pastaj e kapi dhe e shkundi me forcë.

Ajo shqiptoi edhe një herë emrin e të shoqit e zuri të qante.

— Mili! — foli Montagu. — Dëgjomë këtu. Më lër një sekondë, të lutem. Ne tani s'bëjmë dot asgjë, a merr vesh? Këta nuk kemi si i djegim. Dua t'u hedh një sy, më kupton, të paktën t'i shoh njëherë. Pastaj, po qe e vërtetë ajo që thotë kapiteni, i djegim të gjithë, të dy bashkë, të jap fjalën, do t'i djegim, ti edhe unë. Por tani duhet të më ndihmosh.

Uli sytë mbi fytyrën e saj dhe e kapi nga mjekra me vendosmëri. Donte të lexonte në fytyrën e së shoqes jo vetëm atë çka ajo mendonte, por dhe atë çka ai duhej të bënte.

— Do apo s'do, në këtë punë jemi bashkë. Gjatë tërë këtyre viteve s'të kam kërkuar ndonjë gjë të madhe, por tani, të lutem, të përgjërohem, që të më ndihmosh. Njëherë të nisim të pyesim veten e të kërkojmë të marrim vesh pse jemi katandisur në gjithë këtë pështjellim, ti me ilaçet për gjumë, me makinën, unë në punën time. Jemi buzë një gremine, Mili. Dhe një zot e di se sa dua që të mos gremisem në të! E di, nuk ka për të qenë gjë e lehtë! S'kemi se ku kapemi, por, kushedi, mbase pak nga pak do të mund të gjejmë diçka të fortë, ku të mbështetemi, duke ndihmuar me sa të mundemi njëri-tjetrin. Sikur ta dije se sa ta kam nevojën në këto çaste që po kalojmë! Kam aq shumë nevojë për ty, saqë s'di as vetë se si ta shpreh. Sikur të më doje qoftë edhe fare pak, do të dije si të duroje për njëzet e katër orë, të shumtën dyzet e tetë orë; vetëm kaq po të kërkoj, pastaj të jap fjalën, të betohem, se çdo gjë do të marrë fund! Por, ama, po qe se do të zbulojmë diçka, këtu në këta libra, qoftë edhe vetëm diçka fare të vogël që të dalë jashtë këtij kaosi të stërmadh gjërash të mëdha, atëherë, kushedi, mbase do të mund të ndihmojmë edhe ndonjë njeri tjetër.

Tanimë Mildredi s'po bënte më asnjë përpjekje për të ikur, prandaj dhe ai e lëshoi. Ajo u lëkund dhe deshi të mbahej pas murit, por rrëshqiti poshtë, gjersa mbeti ashtu e ulur në dysheme, me sytë të ngulur te librat. Njëra nga këmbët e Mildredit çiku një libër, dhe ajo, sapo e pa, e tërhoqi këmbën menjëherë.

— Mili, ti nuk ishe, nuk ia pe fytyrën asaj plakës natën që shkoi. Po Klarisa! Ti as që ke folur ndonjëherë me të, kurse unë po. Njerëz si Biti kanë frikë prej saj. Dhe ja këtë unë s'arrij ta marr vesh. Pse të kenë kaq shumë frikë nga një vajzë si ajo? Mbrëmë natën unë rrija në kazermë dhe e krahasoja atë me zjarrtarët që ishin aty dhe befas vura re se nuk ndieja më për ta asnjë grimë dashurie, bile as edhe për veten s'ndieja ndonjë gjë. Dhe me vete mendova se do të bëhej shumë mirë sikur vetë zjarrtarët të përfundonin në zjarr.

— Gaj!

Zëri i portës kryesore lajmëroi ëmbël-ëmbël.

«Zonja Montag, zonja Montag, zonja Montag, keni një vizitë, keni një vizitë, keni një vizitë, zonja Montag...»

Me sa ëmbëlsi.

Të dy ata u kthyen dhe ia ngulën sytë portës, kurse librat ishin shpërndarë pirgje-pirgje nga të katër anët e dyshemesë.

— Është Biti! — murmuriti Mildredi.

— S'ka si të jetë ai.

— Është kthyer prapë! — belbëzoi Mildredi.

Zëri i portës kryesore lajmëroi prapë tërë ëmbëlsi:

«Keni një vizitë, zonja Montag...»

— Mos t'i përgjigjemi.

Montagu u mbështet i tëri pas murit dhe dalëngadalë shkau poshtë, gjersa mbeti i tulatur aty, në dysheme, dhe me një pamje të shushatur nisi të ledhatonte tërë ato libra, herë me gishtin e madh e herë me treguesin. Po dridhej, dhe atë çast më tepër se çdo gjë tjetër do të kishte dashur t'i merrte e t'i rraste prapë ata libra pas asaj trine, por, nga ana tjetër, e dinte fare mirë se s'do të ishte më në gjendje ta përba-

llonte Bitin. Ashtu i ulur përdhe, siç ishte, u mbështet me shpatullat pas murit dhe pikërisht atë çast zëri i portës foli përsëri me këmbëngulje akoma më të madhe. Montagu mori një vëllimth nga dyshemeja.

— Nga duhet t'ia fillojmë? — Belbëzoi. Hapi librin në mes dhe u hodhi një sy faqeve. — Besoj që nga kryeja...

— Kapiteni ka për të hyrë në shtëpi, — tha Mildredi, — e do të na djegë edhe ne bashkë me librat.

Më së fundi, zëri i portës u shua. Tani kishte rënë një qetësi e thellë. Montagu e ndiente aty prapa portës praninë e dikujt që mbante vesh e priste. Pastaj u dëgjua zhurma e hapave që po largoheshin nëpër rruginën, drejt lëndinës.

— Pa të shohim njëherë ç'thotë ky, — foli Montagu.

Foli me një zë të thyer, të ndrydhur nga ai turp që ndiente. Lexoi nja një duzinë faqesh, herë aty e herë këtu, gjersa, më në fund, hasi në këtë frazë:

«Është llogaritur që në raste të ndryshme, rreth njëmbëdhjetë mijë veta, pranuan më mirë të vdisnin sesa t'i bindeshin urdhrit që vezët t'i thyenin vetëm nga maja.»

Mildredi kishte ndenjur e ulur përballë tij, në anën tjetër të paradhomës.

— E ç'do të thotë kjo? Asgjë s'do të thotë! Kapiteni kishte të drejtë!

— Prit njëherë, — foli Montagu. — Ta marrim nga fillimi, që nga faqja e parë.

PJESA E DYTË

SHOSHA DHE RËRA

Gjithë atë mbasdite e kaluan duke lexuar, ndërkohë që shiu i ftohtë i nëntorit vazhdonte të derdhej nga qielli mbi shtëpinë e tyre të qetë. Po rrinin në paradhomë, ngaqë salloni u dukej aq i zbrazët e i zymtë, pa atë paretin që shndriste nga varaket e verdhë e ngjyrë portokalli, nga fushqetat, nga ato gratë petkapraruara e ata burrat veshur me kadife të zezë, që nxirrnin lepuj pesëdhjetë kilesh nga ca kapela të argjendta. Mildredi vazhdonte herë pas here të hidhte ndonjë shikim vjedhurazi, me atë fytyrën pa asnjë shprehje, nga salloni, që dukej si i vdekur, ndërkohë që Montagu vazhdonte të bariste tutje-tëhu nëpër dhomë, pastaj kthehej e vinte e ulej këmbëkryq pranë saj e niste të lexonte me zë të lartë, duke e përsëritur gjer edhe në dhjetë herë një faqe të librit.

«S'jemi dot në gjendje të themi se pikërisht në cilin çast lind një miqësi. Ashtu siç ndodh kur pikë-pikë mbush një shishe dhe është pika e fundit ajo që e derdh, po ashtu vjen një çast, në atë rrjedhë çastesh të hirshme, që e mbush zemrën plot.» Montagu rrinte ndenjur e mbante vesh shiun që binte.

— Mbase pikërisht këtë kishte ajo vajza e fqinjëve? Sa shumë u mundova që ta kuptoja.

— Për hir të zotit, lëri rehat të vdekurit tani. Të flasim të paktën për ndonjë që është ende i gjallë.

— E po, vazhdojmë, — foli Montagu me qetësinë më të madhe.

Mildredi i ra me shkelm njërit prej librave.

— Librat s'janë njerëz. Ti lexon e unë shoh përreth, por nuk dalloj dot asnjeri.

Montagu e hodhi shikimin nga salloni, që ishte më i përhimtë e i pajetë nga ç'janë ujërat e një oqeani, por që mjaftonte të ktheje dorezën e diellit elektrik që ai të niste të gëlonte tërë jetë.

— Kurse «familja ime» është plot me njerëz, — ia nisi prapë Mildredi. Njerëz që më rrëfejnë kushedi se sa gjëra, qesh unë, qeshin edhe ata! Lëri pastaj ngjyrat!

— Të kuptoj.

— Pa le pastaj sikur kapiten Biti të marrë vesh që ne mbajmë libra... — Ajo heshti për një çast, e menduar. Në fillim fytyra e saj mori një shprehje pikëllimi, pastaj në të u duk një tmerr i vërtetë. — E di ti që nga çasti në çast mund të vijnë e t'i vënë zjarrin shtëpisë e bashkë me të edhe «familjes»? Sa gjë e frikshme! Mendo gjithë ato para që kemi derdhur në këtë shtëpi! C'na duhet ne të zëmë e të lexojmë libra? Ç'fitim kemi?

— Ç'fitim kemi! Dialli e mori! — ia ktheu Montagu. — Para disa netësh pashë gjarprin më të ndyrë që mund të gjendet mbi këtë botë. Ai ishte i ngordhur, por, ama, edhe i giallë. Ishte i verbër, por prapë mund të shikonte. Do që të shkosh e ta shohësh atë gjarpër? Gjendet në një qendër të ndihmës së shpejtë, ku në një raport është regjistruar e gjithë ajo ndyrësi që të nxori prej trupit ai gjarpër! Të pëlqen të shkosh e t'u hedhësh një sy atyre regjistrave? Po deshe, shko e kërko me emrin Gai Montag, apo ndoshta me emrin Luftë ose Frikë. Apo mos mbase të pëlqen të vesh e të shohësh atë shtëpinë që u dogj mbrëmë? E të rrëmish nëpër hi, që të gjesh kockat e asaj plakës, që ia vuri vetë zjarrin shtëpisë? Po Klarisa Maklellënin nga duhet shkuar për ta kërkuar? Në morg? Pa dëgjo!

Bombarduesit po kalonin lart në qiell, tamam përmbi

kuptosh gjërat. Gjersa qenka kaq vonë, nga duhet shkuar për të kërkuar ndihmë, nga duhet kërkuar një mësues?»

Një çast! Ai mbylli sytë. Po, sigurisht! Ai vuri re se e kishte shpënë përsëri mendjen tek ai parku i bleruar i vitit të shkuar. Më se një herë e kishte sjellë ndër mend kohët e fundit, por tani po i dilte sërishmi para sysh se si kishte qenë ajo ditë, në parkun e qytetit, kur kishte parë atë zotërinë plak të veshur me të zeza se si kishte fshehur diçka me ngut nën xhaketë.

...Plaku kishte brofur në këmbë. si të donte t'ua mbathte këmbëve. Kurse Montagu i kishte bërtitur:

— Prit!

— Unë s'kam bërë asgjë! — i ishte përgjigjur plaku duke u dridhur i tërë.

— Asnjëri s'po të akuzon!

Pastaj kishin ndenjur të ulur nën atë ndriçimin e vakët, të gjelbër pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja për një copë herë, gjersa Montagu kishte nisur të fliste për kohën dhe plaku i qe gjegjur me një zë të mekur. Kishte qenë një takim i çuditshëm, tepër i qetë. Plaku pranoi se kishte qenë profesor letërsie para se ta kishin dëbuar e të kishte nisur bredhjen nëpër botë, aty nja dyzet viet të shkuar, atëherë kur ishte mbyllur edhe universiteti i fundit i lëndëve humanitare, për mungesë fondesh dhe përkrahjeje. Quhej Faber dhe, kur, më së fundi, nisi të mos kishte më frikë nga Montagu, kishte nisur t'i fliste me atë zërin e tij ritmik, duke e hedhur shikimin nga qielli, nga pemët, nga parku i gjelbër dhe pas një ore bisede kishte recituar diçka, që, me ç'kishte kuptuar Montagu, kishte qenë një poezi e parimuar. Pastaj plaku, mbasi kishte marrë akoma më tepër zemër, i kishte thënë edhe diçka tjetër, që kishte qenë edhe ajo një poezi. Me dorën e futur në xhepin e majtë të xhaketës, Faberi recitonte me aq ëmbëlsi, dhe Montagu e kuptoi se, sikur të zgjaste dorën, do të kishte mundësi të nxirrte prej xhepit të plakut një vëllim me poezi. Por nuk e bëri këtë. Qëndroi ashtu, me duart e vëna mbi gjunjë, të palëvizshme.

Montagu e vuri në vend dorezën e telefonit. Asnjë pje. Këtë gjë ai e dinte fare mirë edhe nga ato listat vëna nëpër muret e kazermës së zjarrit. Por në një-ë mënyre kishte pasur nevojë ta dëgjonte këtë nga ja e vetë Faberit.

Në paradhomë zëri i Mildredit tingëlloi tërë nga-lim:

— E di? Sot do të na vijnë për gosti zonjat!

Montagu i tregoi asaj një volum.

— Ka mundësi që kjo të jetë kopja e fundit e këtij ri që ka mbetur në këtë pjesë të botës.

— Sidoqoftë, ti duhet ta dorëzosh atë që sot, apo ' Kapiten Biti e di që e ke ti, apo s'është ashtu?

— S'ma merr mendja që ta dijë se ç'libër kam rrë.

Goja e Mildredit u spërdrodh në një ngërdheshje:

— Të paktën a e kupton se ç'je duke bërë? Po rr më qafë veten tënde e mua bashkë me ty. Kë më shumë ti, tët shoqe apo këtë libër?

Tanimë zëri i saj po bëhej gati një piskamë, tek nte e ulur aty, si një statujë dylli që qe duke u rrirë nga nxehtësia që lëshonte vetë.

Atij iu bë sikur befas dëgjoi zërin e Bitit.

«Ulu, Montag, të lutem. Ja, vështro. Ç'delikatesë, si jenë petalet e një luleje. Ndiz njëherë fletën e parë, staj të dytën. Dhe secila faqe shih si shndërrohet në flutur të zezë. Ç'gjë e bukur, apo jo? Bashkë me dytën digj edhe të tretën e kështu me radhë, një xhir i tërë, njërin kapitull pas tjetrit, të gjitha ato dallallëqe që thonë fjalët, të gjitha premtimet e rre-, të gjitha njohuritë pa shumë rëndësi, të gjitha ideo-jitë e brejtura nga koha!»

E shihte Bitin, që rrinte i ulur pa e prishur fare ezinë aty, në paradhomë, me ballë të dërsirë, mbi shemenë e stërpikur me shenja fluturash të zeza, të ordhura që të gjitha në këtë stuhi zjarri.

Mildredi reshti së bërtitur: po aq befas sa ç'kishte sur. Montagu as që ia vuri veshin fare.

— S'më mbetet të bëj veçse një gjë: — tha ai, —

para se të vijë mbrëmja e t'ia jap librin Bitit, duhet të kem bërë një kopje të tij.

— Do të vish në shtëpi sonte për «gaztorin e bardhë», se do të më vijnë për vizitë edhe zonjat? — i thirri Mildredi.

Montagu u ndal te dera dhe, duke iu drejtuar së shoqes, e pyeti:

— Mili?

Një pauzë e gjatë, pastaj u dëgjua:

— Çfarë ke?

— Mili? Të do ty «gaztori i bardhë»?

Asnjë përgjigje.

— Mili, mos vallë, — ai lëpiu buzët me gjuhë, — të do ty «familja» jote? Të të dojë shumë, me gjithë zemër e shpirt, ëh, Mili?

Ndjeu mbas qafe rrahjen e qepallave të Mildredit, të habitur.

— E pse më pyet budallallëqe të tilla?

Montagu ndjeu se si e pushtoi një dëshirë e madhe që të qante, por në sytë e në gojën e tij s'u duk asgjë.

— Po e pe gjë përjashta atë qenin, — foli Mildredi, — futi një shkelm edhe për mua.

Montagu ngurroi një çast duke përgjuar nga pas derës. Pastaj e hapi dhe doli.

Shiu kishte pushuar dhe dielli në të perënduar, dukej në qiellin e kthjelltë. Rruga, livadhi, veranda ishin të shkretë. Atëherë Montagu lëshoi jashtë frymën, që gjer atëherë mezi e kishte mbajtur, në një psherëtimë të thellë e të zgjatur.

E mbylli portën duke e përplasur fort.

Ndodhej në metro.

«Jam i trullosur, — mendoi me vete. — Që kur vallë më nisi kjo shushatje në kokën time, në trupin

tim? Duhet të këtë qenë atë natë, kur i rashë me këmbë në errësirë asaj kutisë së tabletave, që qe njësoj si t'i bija me këmbë ndonjë mine të fshehur. Por njëherë, shpejt a vonë, kjo trullosje duhet të ikë. Do të duhet kohë, por, në fund, do t'ia dal mbanë, dhe Faberi do të më ndihmojë. Dikush, nuk e di se kush, do të më kthejë edhe mua fytyrën e duart që kam pasur njëherë e një kohë, fytyrën time të vërtetë, duart e mia të vërteta. Edhe buzëqeshjen, — foli ai, — atë buzëqeshjen time të parë, që m'u dogj e m'u zhduk përbrenda. E ndiej veten të humbur pa buzëqeshjen time!»

Tuneli i hekurudhës së nëndheshme i shkiste anash me shpejtësi, pllakëza të bardha, e zezë e shndritshme, pllakëza të bardha, e zezë e shndritshme, numra dhe terr, dhe e gjithë kjo përsëritej pafundësisht.

Njëherë, kur ishte fëmijë, po rrinte i ulur mbi një pirg rëre të verdhë buzë detit në mes të një dite të kaltërremе e të përvëluar vere, duke u munduar të mbushte një sitë me rërë, meqë një kushëri i tij i lig i kishte thënë: «Po e mbushe dot me rërë këtë sitë, do të të jap dhjetë santim!» Dhe, sa më shumë rërë derdhte ai në sitë, aq më shumë rërë i rrëshqiste para syve me një fëshfërimë të thatë. Duart i kishte të lodhura, rëra ishte e përvëluar, sita ishte bosh. I ulur aty mbi pirgun e rërës në pisk të korrikut, ai ndiente se si i rridhnin ëmbëlsisht lotët mbi mollëzat e faqeve.

Dhe ja, tani, tek treni me ajër të ngjeshur po e degdiste përmes guvave të vdekura të nëntokës së qytetit, duke e përkundur sa andej këndej, atij i erdhi ndër mend logjika e tmerrshme e asaj site dhe, duke ulur sytë, pa se në duar po mbante librin e hapur. Në trenin e thithur nga zbrazëtia pneumatike kishte gjithë ata njerëz, por ai prapë vazhdoi ta mbante librin të hapur në duar dhe befas një mendim absurd erdhi dhe e goditi: «Po qe se arrin ta lexosh shumë shpejt, dhe e lexon të gjithë, kushedi mbase dhe do të mbetet ca rërë në sitë». Por ai lexonte dhe fjalët i shkisnin përmes sitës, dhe atëherë ai tha me vete: «Pas ca orësh

do të jem me Bitin dhe unë do t'i jap atij këtë libër, prandaj s'duhet të lë të më shpëtojë as edhe një frazë, çdo rresht duhet të mësohet përmendsh. Dhe unë vetë kam për ta bërë këtë.»

E shtrëngoi fort librin mes grushteve.

Fanfarat buçitën.

«Pastë e dhëmbëve Denham.»

«Mbylleni!» — urdhëroi me mend Montagu. — «Mendoni për lulet e fushave.»

«Pastë e dhëmbëve Denham.»

«Nuk njohin asnjë lodhje e as dinë...»

«Pastë e dhëmbëve De...»

«Mendoni për lulet e fushave, mjaft më me këtë heshtni!»

«Pastë e dhëmbëve!»

E hapi përsëri librin me vrull dhe filloi ta shfletonte me tërbim, duke ia prekur faqet një nga një, si të qe i verbër, duke e ndier me gishtërinj formën e secilës prej shkronjave, pa i rrahur fare qepallat.

«Denham, siç quhet zakonisht...»

«Nuk njohin asnjë lodhje e as dinë...»

Një fëshfërimë e thatë rëre të nxehtë përshkoi sitën e zbrazët.

«Vetëm Denham!»

«Por mendoni për lulet e fushave, për qetësinë e zambakëve.»

«Denhami, i këshilluar nga dentistët.»

«Oh, mjaft më, mjaft më, mjaft më!»

Ishte një përgjërim, një klithmë aq e tmerrshme, saqë Montagu s'e kishte kuptuar as vetë se si kishte kërcyer në këmbë, nën shikimin e ngulur të pasagjerëve, që, të habitur, po i largoheshin këtij njeriu me fytyrë të marri e të përvuajtur, me gojën e përtharë e belbacake, me librin të hapur me faqet që po i fluturonin ndër duar. Po ata pasagjerë që vetëm ca çaste më parë po rrinin ulur, duke rrahur këmbët përtoke, sipas ritmit të reklamës së pastës së dhëmbëve Denham, të pastruesit odontoiatrik Denham, të pastës së dhëmbëve Denham, të pastës së dhëmbëve të këshilluar

nga dentistët. Dehham për dhëmbët e dendve[1]). një dy, një dy tre, një dy, një dy tre, po ata, gojët e të cilëve kishin mbllaçitur, copëtuar fjalët, pastë dhëmbësh, pastë dhëmbësh. pastë dhëmbësh. Dhe, si për dënim, radioja e trenit të nëndheshëm volli përmbi Montagun tonelata të tmerrshme muzike të bërë nga tinguj therës, që nxirrnin instrumentet e kallajtë, të bakërt, të argjendtë, të kromtë, të bronctë. Pasagjerët e ndien veten të druajtur nën ato goditje vareie; nuk ikën, ngaqë s'kishin se nga të iknin: treni i madh me ajër të ngjeshur kridhej gjakftohtë nëpër pusin e vet në brendësi të dheut.

Lulet e fushës.

Denham.

Zambakët e qetë. ju thashë!

Njerëzit ia kishin ngulur sytë.

— Të thërresim shefin e trenit.

— Ky njeri s'është në vete...

— Stacioni i Knoll View-s!

U dëgjua fërshëllima e fortë e trenit, që frenoi.

— Knoll-View-s! — një thirrje.

— Denham. — një pëshpëritje.

Zëri i Montagut paksa u ndje;

— Zambakët e qetë...

Me një fërshëllimë gulçuese, porta e vagonit u hap teipërtej. Montagu s'luajti nga vendi. Me një gulçim tietër, porta zuri të lëvizte që të mbyllej sërishmi. Vetëm në çastin e fundit, Montagu, me një të kërcyer, u sul përpara dhe u vërvit në atë birë të hollë që po mbyllej, gjithë duke ulërirë me mendjen e vet. Zuri të ngjiste me vrap shkallët vetëlëvizëse, sepse kishte nevojë t'i ndiente këmbët në lëvizje, t'i ndiente krahët se si i përkundeshin, mushkëritë se si i gufoheshin, shtrëngoheshin, gufoheshin, gojën që ju përtha nga shkulmet e ajrit. Një zë e ndiqte nga pas, si një vazhdë: Denham. Dehham. Denham. Treni lëshoi një fërshëllimë si ndonjë gjarpër dhe u zhduk brenda vrimës së vet.

1) Dendi (anglisht dandy) njeri që kujdeset shumë për pamjen e tij të jashtme.

— Kush është?
— Montagu.
— Ç'dëshironi?
— Të hyj brenda.
— Unë s'kam bërë asgjë!
— Unë jam vetëm. Më kuptoni? Vetëm.
— Betohesh për këtë?
— Patjetër që betohem!

Porta e shtëpisë u hap ngadalë. Faberi përshëndeti me kokë, tërë kujdes, dhe, ashtu në dritën e ditës, dukej mjaft i plakur, më i brishtë dhe më i trembur se kurrë ndonjëherë më parë. Dukej sikur plaku kishte vite të tëra që nuk dilte prej shtëpie. Kishte po një çehre me suvanë e bardhë të mureve përreth. Të bardhë e kishte mishin e buzëve dhe të faqeve, të bardha i kishte flokët, sytë i qenë çngjyrosur aq shumë, saqë tanimë ngjyra e kaltërreme e tyre ishte zbardhëllyer. Dhe pastaj, po ata sy të zbardhëllyer u ndalën mbi librin që Montagu mbante nën sqetull, dhe brenda një grime pamja e Faberit s'ishte më aq e plakur dhe e brishtë. Pak nga pak atij iu zhduk frika.

— Më falni. Por duhet qenë i kujdesshëm. E hodhi prapë shikimin nga libri dhe s'u përmbajt dot pa thënë: «E pra, qenka e vërtetë?»

Montagu hyri brenda. Porta u mbyll.

— Zini vend. — tha Faberi duke u çapur mbrapsht si të kishte frikë që ai libër kishte për t'u zhdukur menjëherë, sapo ai t'ia hiqte sytë. Prapa kurrizit të tij porta e një dhome gjumi ishte e hapur tej e tej dhe pas saj dukej një numër i madh pajisjesh dhe mekanizmash çeliku, të shpërndara përmbi një bankë pune. Montagu vetëm sa mundi t'u hidhte një shikim shkarazi, sepse plaku, që e vuri re shikimin e tij, shkoi dhe e mbylli derën me ngut: pastaj, pa hequr akoma nga doreza e portës dorën, që i dridhej, e çoi prapë shikimin e tij të druajtur te Montagu, që ndërkohë ishte ulur me librin mbi prehër.

— Këtë libër... nga e keni...?
— E vodha.

Për herë të parë Faberi e ngriti shikimin dhe e pa Montagun drejt e në fytyrë.

— Qenke guximtar.

— S'është ashtu. — iu përgjigj Montagu. — Ime shoqe është gati duke vdekur. Një mikja ime vdiq. Nië tjetër që mund të më ishte bërë mike, s'ka as njëzet e katër orë që vdiq e djegur. Ju ieni i vetmi njeri që njoh që mund të më ndihmojë. Të më ndihmojë për të parë. Për të parë aty....

Faberi lëvizi nga vendi duart, që po i mbante përmbi gjunjë.

— Ka mundësi?

— Oh, më falni. — Montagu i dha librin.

Plaku i mbajti erë librit.

— E di, — vazhdoi, — që edhe librat vijnë nië çikë erë si ato arrat moskate[1]) apo si ca lloj bimësh me origjinë ekzotike, që, kur isha fëmijë, kisha qejf t'u mbaja erë. Zotëri, sa shumë libra që kishte në botë njëherë e një kohë, para se ne të lejonim që ata të zhdukeshin.

Faberi vazhdonte të shfletonte faqet.

— Zoti Montag, keni të bëni me një frikaç. Që shumë kohë më parë unë e shihja se ç'udhë po merrnin punët: por s'thashë asnjë fjalë, jam një nga ata të pafajshmit që kishin mundësi të thoshin shkoqur e troç atë që mendonin, atëherë kur askush s'ua vinte veshin «fajtorëve», por unë s'e hapa gojën, duke u bërë kështu edhe vetë fajtor. Dhe, kur, më së fundi, mbërriti puna që të organizohej ligjërisht 'diegia e kartës së shtypur, duke krijuar policinë e zjarrtarëve, unë murmurita ca e pastaj e mbylla gojën, sepse tanimë s'kishte mbetur më njeri që të murmuriste a të ulërinte bashkë me mua. Kurse tani është tepër vonë.

Faberi e mbylli librin.

— E po mirë, do të më thoni tani arsyen e vizitës suaj...

---

1) Emri i një bime që rritet në Azi, që prodhon fruta të ngjashme me arrat, mjaft aromatike.

— Është puna se nuk më dëgjon asnjeri ç'dua të them. As pareteve s'kam si u flas, se janë ato që më ulëriinë mua. Me time shoqe s'flas dot, sepse ajo e ka mendjen tek ajo që thonë paretet. Thjesht, kam nevojë të gjej një njeri që të rrijë e të më dëgjojë atë që dua të them. E, kushedi, po m'u dha mundësia, të flas për një copë herë, mbase them edhe unë ndonjë gjë me mend. Pastaj dua që ju të më mësoni të kuptoj ato që lexoj.

Faberi studioi një copë herë fytyrën e ligur dhe të ngrysur të Montagut.

— Ç'ju paska tronditur kaq shumë? Ç'paska bërë vaki që e paskeni lëshuar pishtarin nga dora?

— Nuk e di. I kemi të gjitha ç'duhen për të qenë të lumtur, e prapë s'jemi dot të lumtur. Diçka mungon. Kërkova përreth dhe pashë se e vetmja gjë që më mungonte ishin librat, ata që unë i kisha djegur gjatë gjithë këtyre dhjetë a njëzet vjetve të fundit. Dhe atëherë mendova se ndoshta janë librat ata që do të më ndihmojnë.

— Je një romantik i pandreqshëm, — i tha Faberi. — Kishte për të qenë qesharake, sikur në të vërtetë të mos ishte tragjike. Ty nuk të mungojnë librat, por ca nga ato gjëra që njëherë e një kohë i gjeje te librat dhe që fare mirë mund t'i gjeje sot edhe në «familjet e sallonit». Gjithëpo ato vecori të pafundme e ajo ndërgjegje fare mirë mund të shpërndahej e të projektohej nga radioja dhe nga televizioni. Por vecse nuk ndodh kështu. Jo, jo, s'janë aspak librat ata që duhen kërkuar. Merr atv ku ke akoma mundësi të gjesh gjësendi, në disqe të vjetra gramafoni, në filma të vjetër ose nënër mio të vjetër: kërko në natvrë, por, në radhë të parë, kërko te vetia jote. Librat nuk ishin vecse një mjet, një strehë, ku ne vinim gjithcka kishim frikë se mos e harronim. S'kanë asgjë magjike librat: magjia qëndron në atë cka ata thonë, në atë mënvrë se si ata qepin në një të tërë me gjithë ato copëra leoke të gjithësisë atë mantel me të cilin do të visheshim. Natyrisht që të gjitha këto ti s'kishe nga i

dije, ashtu si s'ke si më kupton as tani se përse e kam fjalën. Por veçse ja, me intuitë, i ke rënë në të, dhe kjo ka rëndësi. Tri janë ato gjëra që na mungojnë:

— *Së pari:* a e di pse janë kaq të rëndësishëm libra si ky? Sepse ata kanë substancë. Çfarë do të thotë në këtë rast «substancë»? Për mua do të thotë strukturë, fibër që ta mbajë. Ky është një libër që ka pore, që ka frymëmarrjen e vet, një libër që mund ta vëresh në mikroskop. Dhe ke për të parë se nën qelqin ka jetë, një jetë që rrjedh si një lumë i fryrë me një begati të pafund. Sa më tepër pore të ketë, sa më tepër veçori të jetës të ketë për çdo centimetër katror në një fije letër, aq më tepër «artistik» ai është. Sidoqoftë, ky është përkufizimi që i bëj unë substancës. Zbulo veçoritë. Veçori të reja! Shkrimtarët e mirë kanë lidhje të vazhdueshme me jetën. Mediokrët vetëm sa e cekin shkarazi. Shkrimtarët e këqij e shpërfytyrojnë dhe e braktisin.

— E kupton tani, — vazhdoi Faberi, — pse i urrejnë e ua kanë frikën librave? Njerëzve që duan rehatinë, u pëlqejnë vetëm fytyrat si një hënë e plotë, fytyra dylli, fytyra pa pore, pa qime, pa shprehje. Jetojmë në një kohë kur lulet kërkojnë të ushqehen me lule, në vend që të ushqehen me shiun e mirë e me dheun e zi pjellor. Madje, edhe fishekzjarret, me gjithë hijeshinë e tyre, prapë nga përbërja kimike e tokës i lindën. E megjithatë, as vetë s'e marr vesh sesi, po ja që ne na është mbushur mendja se do të mundemi të ecim më tej, duke u ushqyer me lule e me lojëra piroteknike, pa e përmbushur ciklin e kthimit në realitet. E di atë legjendën e Herkulit dhe të Anteut, mundësit gjigant, që kishte një fuqi të pabesueshme, mjaft që t'i kishte këmbët mbi tokë? Por, ama, kur Herkuli e mbajti Anteun lart, në ajër, kur e la atë pa rrënjë, ai shpejt mbaroi. Në mos pastë në këtë legjendë një mësim për ne që jetojmë në këto kohë, sot, në këtë qytet, atëherë do të thotë që më s'qenkam fare në rregull nga trutë. Me një fjalë,

kjo është e para nga të tri gjërat që na mungojnë. Substancë, fibër e elementeve jetësore.

— Po e dyta?

— Ngeja, koha e lirë.

— Oh, po ne kemi çdo ditë gjithë ato orë të lira.

— Orë të lira nga puna, po. Por kohë për të menduar ke? Kur s'je duke e ngarë makinën me njëqind milje në orë, me një shpejtësi ku s'ke si e çon mendjen në gjë tjetër veç rrezikut, atëherë je duke luajtur me letra ose rri i ulur në ndonjë sallon, i rrethuar nga televizioni me katër parete, me të cilin s'ke sesi të diskutosh për gjërat. E përse? Sepse ato që tregon televizori janë diçka «reale», e atypëratyshme, që ka përmasat e veta. Ta thotë ai çka duhet të mendosh, e, bile, ta thotë me një zë gjëmues. Duhet të ketë të drejtë, thua ti me vete: duket tamam sikur ka të drejtë. Të nguc me aq shpejtësi e me aq vrull, që të arrish edhe ti në përfundimet e tij, sa s'i lë kohë mendjes që të protestojë e të thotë: «Ç'budallallëqe!»

— Po ata të «familjes» janë njerëz të gjallë, me mish e me kocka.

— Si, si, më fal?

— Ime shoqe thotë se librat nuk janë «realë».

— Thuaj mirë që është kështu. Të paktën, një libër mund ta mbyllësh e t'i thuash: «Prit një minutë.» E ti bën atë që do vetë. Pa më thuaj, të lutem, kush është ai që ka arritur t'u shpëtojë kthetrave që të kllapojnë, sa vë këmbë në një sallon TV? Të sajon e të jep formë si t'ia dojë atij qejfi! Ambienti ku të fut e të mbyll, është real si vetë bota. Ashtu të bëhet, e ndaj dhe ashtu është e vërteta. Librat mund t'i mundësh me arsye. Por me gjithë ato që di e me gjithë skepticizmin tim, prapë asnjëherë s'kam qenë dot i zoti të diskutoj me një orkestër simfonike me njëqind elementë, gjithë ngjyra e tre dimensionale, që është pjesë përbërëse e atyre salloneve të çuditshëm. Ti e sheh vetë, unë në sallon s'kam veçse katër mure të thjeshta, të bëra me gëlqere e me tulla. Kurse këto, — dhe i tregoi Montagut dy tamponë të vegjël gome, —

këto i kam për këtà veshët e mi të shkretë, kur jam në vagonët e metrosë.

— Pastë e dhëmbëve Denham, — belbëzoi Montagu me sytë e mbyllur. — Ku do të përfundojmë vallë? A mund të na ndihmojnë librat?

— Veç në do të kemi atë gjënë e tretë që na mungon. E para, siç ju thashë, është substanca, identifikimi i jetës. E dyta, ngeja, koha për të menduar për këtë identifikim, për ta përvetësuar jetën. E treta, e drejta për të vepruar sipas asaj që na mëson ndikimi që mund të ushtrojnë mbi ne dy të parat. Por veç unë për vete s'e besoj që në këtë pikë ku kemi mbërritur, një plak i drobitur e një polic zjarrtar i revoltuar, të jenë në gjendje të bëjnë ndonjë gjë kushedi se çfarë...

— Unë mund të siguroj libra.

— Duke kaluar rreziqe shumë të mëdha.

— Kjo është ana e mirë që ka vdekja. Atëherë, kur s'të ka mbetur më asgjë se ç'të humbasësh, s'ke frikë më nga asnjë rrezik.

— Ja pra, — tha plaku duke qeshur. — Thatë një gjë interesante, pa e pasë lexuar gjëkundi.

— Pse ka në libra mendime të tilla? Kjo ishte diçka që u krijua vetiu brenda kokës sime.

— Aq më mirë atëherë. S'e shpike as për mua e as për kërrkënd tjetër, bile as edhe për veten tënde.

Montagu zgjati trupin përpara.

— Sot po mendoja se disa nga ata librat që kanë vlerë të veçantë, mund t'i shtypnim në ndonjë makinë tipografike...

— Ne?

— Po, ju edhe unë.

— Oh, jo! — Plaku sikur ngriu në vend.

— Më lejoni të paktën t'u parashtroj planin tim...

— Po qe se ngulni këmbë, do të jem i detyruar t'ju lutem që të më lini vetëm.

— Po pse, nuk ka interes edhe për ju e gjitha kjo?

— Jo, se muhabete të tilla vetëm të bëjnë të vdesësh i djegur. Do t'ua vija veshin, në se vërtet me

këto që po më thua do të arrihej në një mënyrë, a në një tjetër, që të zhdukej e gjithë organizata e policisë zjarrvënëse. Pra, në qoftë se ne shtypim lloj-lloj librash dhe pastaj ti vete e u a fut ata fshehur zjarrvënësve nëpër kazerma, që tërë dyshimi të bjerë mbi ta, atëherë, po, unë të them të lumtë!

— Të shkosh të fshehësh libra e, pastaj të telefonosh për t'i denoncuar, që të shohësh tërë ngazëllim se si do të digjen shtëpitë e policëve të zjarrit, këtë do të thuash?

Faberi e pa Montagun duke i mbledhur vetullat hark, si të qe duke e parë nën një dritë krejt të re.

— Bëra shaka.

— Pse shaka, po qe se vërtet ky është një plan që ia vlen ta provosh! Veçse mua më duhet të di me siguri nëse nga kjo punë mund të dalë diçka, apo jo.

— Për punë të tilla, që kurrë s'ua di ndonjëherë me siguri fundin, s'jep dot garanci! Por pastaj, ja edhe sikur t'i kemi të gjithë librat që na duhen, prapë, ja ku ta them unë, do të shkojmë të kërkojmë aty ku është maja më e lartë, që të kërcejmë prej andej e të thyejmë kësisoj kokën. Kurse ne në të vërtetë kemi nevojë të pushojmë një grimë, sa të marrim frymë. kemi nevojë për dije. Kurse, ndoshta, pas nja tri mijë vjetësh, do të mësojmë të zgjedhim ndonjë kodrinë j edhe aq të lartë, nga ku të hidhemi. Qëllimi i librav është të na tregojnë se sa gomarë, se sa të pamen jemi. Librat janë si ata pretorianët e Cezarit, që, ndërkohë që korteu ngadhënjyes kalonte gjëmimmadh. pëshpëritnin këtij në vesh: «Mos harro, Cezar, se edh ti je i vdekshëm.» Për pjesën më të madhe të njerëzv nuk është e mundur të bredhin tërë kohës sa ande këtej të flasin me të gjithë, të njohin të gjitha qytetet e tokës; as kohë s'kanë për këtë, as para. Ato q kërkon ti, Montag, i ke këtu, mbi këtë tokë, por ve për një njeri të zakonshëm e vetmja mënyrë se s mund të shohë, të paktën nëntëdhjetë e nëntë për qin të tyre, është nëpërmjet librave. Mos kërko garanci E mos prit që vetëm një gjë a një njeri, një makin

o bibliotekë e tërë të mund të të shpëtojë. Bëhuni he ju shpëtimtarë, dhe pastaj, edhe po u mbytët, të ktën do të vdisni duke e ditur se ishit në udhën që shpinte drejt bregut.

Faberi u çua nga vendi dhe zuri të bariste nëpër omë.

— E pra? — e pyeti Montagu.

— A je plotësisht dhe seriozisht i vendosur?

— Plotësisht.

— Besomë mua, është një plan i zgjuar. — Faberi hodhi një sy, i shqetësuar, derës së dhomës së tij gjumit.

— Të shohësh kazermat e zjarrit të digjen anebanë vendit, të shkatërrohen njëlloj si gjithë vatrat tjera të tradhtisë! Salamandra që ha bishtin e vet! O t i madh!

— Kam një listë me adresat e zjarrtarëve të të tha qyteteve. Bashkë me ato të një organizate klanstine...

— Veç s'i zëmë dot besë asnjeriut, kjo është e qja e kësaj pune. Ja, ti, unë, po tjetër, kush do të e që do të vërë zjarret?

— Pse, nuk ka profesorë të tjerë si ju, ish-shkrimrë, historianë linguistë...

— O kanë vdekur, o janë tepër pleq.

— Sa më pleq të jenë, aq më mirë është; do ta në më të lehtë që të mos bien në sy. Pranoje që eh duzina me njerëz të këtij lloji!

— Oh, patjetër, janë gjithë ata aktorë që kanë te që s'e luajnë dot më Pirandelon, Shoun ose Shekirin, ngaqë veprat e këtyre janë ca si tepër të vetëjshme për realitetin. Kështu që ne mund ta shfrytëjmë për qëllimet tona zemërimin që u zien përenda. Po ashtu mund të përfitojmë edhe nga mëria kanë me të drejtë tërë ata historianë që prej dyzet etësh s'shkruajnë dot asnjë rresht. Ashtu, është e rtetë, ne mund të ngrejmë, madje, edhe kurse, ku mësojmë njerëzit të lexojnë edhe të mendojnë.

— Sigurisht!

— Por, prapë, vetëm kjo s'mjafton. E tërë kultura është goditur pas shpine. Vetë skeleti i saj duhet të shkrihet që të derdhet sërishmi sipas një modeli të ri. Për zotin, që të zgjidhet problemi, s'mjafton vetëm të nisësh e të lexosh një libër që e kanë hedhur prej gjysmë shekulli më parë. Mos harro se në të vërtetë rrallë e tek ndihet nevoja për zjarrtarët. Njerëzit vetë e kanë braktisur leximin. Ndaj edhe sot janë të paktë ata që janë të gatshëm të rebelojnë. Edhe ndër këta të paktë, pjesës më të madhe i ka hyrë frika, ja kështu si mua. Se mos je i zoti ti të kërcesh më shpejt nga ç'bën «*Gaztori i bardhë*», apo të ulërish më fort nga «*Shtrigani gaztor*» e «*familjet*» e salloneve? Në je vërtet kaq i zoti, Montag, atëherë të them: do të arrish diçka. Sidoqoftë, ti je tepër i padjallëzuar. Njerëzisë i pëlqen të zbavitet.

— Duke u vrarë? Duke vrarë të tjerët? Apo duke tentuar të vetëvriten?

Gjatë gjithë kohës që kishte vazhduar biseda e tyre, një mori aeroplanësh bombardues kishte fluturuar në drejtim të lindjes, por vetëm tani ata të dy e e prenë fjalën, që të mbanin vesh, ngaqë ndien në thellësitë e vetes drithërimën e gumëzhimës së madhe të reaktorëve.

— Ki durim, Montag. Le të presim sa t'i zhdukë lufta «familjet». Qytetërimi ynë po shkatërron vetveten. Kryesorja është të dish të qëndrosh larg nga forca centrifuge që po e shkatërron.

— E prapëseprapë, dikush duhet të jetë i përgatitur për atë çast, kur gjithçka do të hidhet në erë një herë e mirë.

— E kush, njerëz që do të dinë të recitojnë Miltonin? Apo që do të thonë: «Unë di përmendsh tragjeditë e Sofokliut?» Apo që do të dinë t'u kujtojnë atyre që do të mbeten gjallë se, në fund të fundit, njeriu ka edhe anët e tij të mira? Por s'kanë për të bërë gjë tjetër veç do të zënë të kërkojnë gurë, që t'i ngrenë njëri-tjetrit lapidare! Montag, shko më mirë në shtëpi. Futu në krevat e bëhu i mbarë. Pse kërkon t'ia hel-

mosh vetes ato pak orë që të kanë mbetur, duke kërcyer vetë brenda në kafaz e duke thirrur pastaj se s'je ketër?

— Atëherë, për ty s'paska pikë rëndësie?

— Ka aq rëndësi, saqë më vjen për të vjellë nga gjithçka.

— Dhe nuk do të më ndihmosh?

— Natën e mirë, natën e mirë!

Duart e Montagut morën librin. Kur pa se ç'po shtrëngonte në duar, u duk edhe vetë i habitur.

— Të pëlqen ky libër?

— Jam gati të jap krahun tim të djathtë, mjaft që ta kem, — tha Faberi.

Montagu e vështroi ashtu i ngrirë në këmbë para tij, siç po rrinte, dhe priti sa të ndodhte diçka më tej. Duart e tij, si të kishin një vullnet të vetin, si dy punëtorë që punojnë së bashku, zunë të shkulnin faqet e librit. Ato duar shqitën faqen e ballinës, pastaj faqen e parë, pastaj të dytën.

— Idiot, i marrë, ç'po bën ashtu? — Ulëriti Faberi duke brofur, si ta kishin goditur. Iu hodh përsipër, por Montagu, duke u mbrojtur me shpatulla, i la duart të lira të vazhdonin punën e tyre shkatërruese. Edhe gjashtë faqe të tjera mbi dysheme. Nën shikimin e Faberit, ai i mori dhe nisi t'i mblidhte shuk.

— Oh, mos, mos, ndal! — iu lut plaku.

— E kush më ndalon dot? Jam zjarrtar unë! Po të dua, të djeg edhe ty të gjallë!

Plaku po e shihte ngultazi, me ata sytë e tij plot dhimbje e të zgurdulluar.

— Oh, nuk ke për ta bërë kurrë!

— Kurse, ja që unë po e bëj.

— Të lutem, mos shkul faqe të tjera nga ky libër. — Dhe Faberi u lëshua i tëri mbi një karrige, i zbehtë sa më s'bëhej, me buzët që i dridheshin. — Mos më bëj të ndihem edhe më i lodhur e i këputur nga ç'jam. Çfarë do si këmbim?

— Ty, si mësues. Që të më mësosh gjithçka që më duhet.

— E po mirë, mirë!

Montagu e lëshoi librin. Nën shikimin e kapitur të plakut, nisi të shpaloste e të sheshonte fletët e librit që aty më parë i kishte mbledhur shuk.

Faberi tundi kokën, sikur atë çast të qe duke u çuar nga gjumi.

— Montag, ke ndoca para?

— Pak. Katërqind, pesëqind dollarë e shumta. E përse?

— Silli këtu. Njoh një njeri që pesëdhjet vjet të shkuar na shtypte gazetën e universitetit. Ishte atë vit, kur, si vajta në Fakultet për të nisur simestrin e ri, gjeta vetëm një student në sallë, që ishte regjistruar në kursin e tragjedisë nga Eskili gjer tek O' Neili. E kupton? Ç'statujë e madhërishme akulli ishte, që po shkrinte nën rrezet e diellit! Më kujtohen gazetat, që vdisnin njëlloj si ca flutura të mëdha nate! Dhe asnjeriut s'i erdhi keq për to. Askush s'ua ndjeu mungesën. Dhe pas kësaj qeveria, si e pa se ç'përfitim do të kishte nga një popull të cilit i pëlqente të lexonte vetëm në buzët që puthnin tërë pasion, apo në grushtet e forta që i jepeshin stomakut, i vuri kapakun kësaj historie, duke nxjerrë zjarrvënësit tuaj. Kështu pra. Montag, kemi atë tipograf që është i papunë. Mund t'ia nisim me ndonjë libër, tek presim që lufta të shkatërrojë tërë sistemin e të na japë atë shtytje që na duhet. Ca bomba dhe menjëherë të tëra «familjeve» në paretet e të gjitha shtëpive ka për t'iu mbyllur goja! E në atë heshtje të beftë që do të bjerë, kushedi, mbase ka për t'u ndier zëri ynë.

Që të dy mbetën me shikimin të ngulur te libri që ishte mbi tryezë.

— Këto do të mundohem të mos i harroj, — foli Montagu, — por, për dreq, sa kthej kokën, çdo gjë më fluturon nga mendja. O zot, sa nevojë kam të gjej gjësendi për t'i thënë kapiten Bitit! Ai ka lexuar shumë, ndaj dhe tani e ka gjithmonë përgjigjen në majë të gjuhës, apo, të paktën, ashtu hiqet. E ka zërin si gjalpë. Unë kam frikë se mos me ato dërdëllitjet e tij

më kthen prapë e më bën ashtu siç isha njëherë e një kohë. S'ka shkuar veçse një javë që lëshoja atë pizgën e vajgurit e me vete mendoja: «O zot, ç'gjë e bukur! Ç'qejf që është!»

Plaku pohoi me kokë.

— Ai që s'krijon gjë, s'ka si rri dot pa shkatërruar. Kjo është një gjë e lashtë, po aq sa edhe vetë historia, sa edhe psikologjia e kriminelëve të mitur.

— Domethënë, unë pak a shumë i tillë jam.

— Te secili prej nesh diçka e tillë ekziston.

Montagu u drejtua për nga porta e hyrjes.

— Nuk ke mundësi që në ndonjëfarë mënyre të më ndihmosh sonte, kur të takohem me kapitenin e zjarrtarëve? Kam nevojë për një ombrellë, që të më mbrojë nga rrebeshi i fjalëve të tij. Kam shumë frikë se mos mbytem.

Plaku nuk foli, por pa edhe një herë i merakosur nga dera e dhomës së gjumit. Montagut nuk i shpëtoi ky shikim.

— E pra? — këmbënguli ai.

Plaku mori njëherë frymë thellë, e mbajti frymën për një çast, pastaj, më së fundi, e lëshoi ngadalë. Prapë mori frymë thellë, me sytë të mbyllur, me gojën të shtrënguar, gjersa, më në fund, arriti të nxirrte një gulçimë:

— Montag...

E ndërpreu përsëri fjalën, por, pastaj, si u kthye nga ai, duket e ndau mendjen:

— Ec me mua. E për pak të lashë të shkoje pa të thënë asgjë. S'jam gjë tjetër veçse një copë plak frikaman.

Faberi hapi derën e dhomës së gjumit dhe e futi Montagun në një dhomë të vogël, ku mbi një bankë shiheshin ca instrumente metalike e bashkë me to ca rrotulla me tela mikroskopikë, ca qarqe tepër të vogla, bobina, kristale.

— Ç'janë këto? — pyeti Montagu.

— Prova të paburrërisë sime të pafund. Sikur ta dije se sa vjet kam shkuar këtu në vetmi, duke i

mbuluar muret me figurat e fantazisë sime! Është pasioni im të rri e të englendisem me elektronikën dhe me zbatimet e ndryshme që gjen parimi i radiotransmetimit. Aq e madhe është paburrëria ime, saqë, duke u bashkuar me atë frymë rebelimi që kam përbrenda, por që veç rri e strukur nën hijen e saj, më shtrënguan të sajoja këtë aparat.

Mori nga banka një send të vogël metalik në ngjyrë të gjelbër, që s'e kalonte madhësinë e një fisheku të kalibrit 22.

— Dhe të gjitha këto... si i pagova, thua ti? Duke luajtur në bursë, natyrisht, në këtë strehë të fundit që ka mbetur në këtë botë për ne, intelektualët e rrezikshëm e të papunë. E pra, luajta në bursë, krijova të gjitha këto e ndenja e prita. Kam gjysmën e jetës sime që rri e pres i drithëruar që të vijë dikush e të më flasë. Vetë s'ma mbante t'i flisja njeriut. Asaj dite në park, kur biseduam bashkë, të ulur në atë stol, e dija se shpejt a vonë do të më vije në shtëpi, veç s'dija të thosha në do të më vije si mik apo si zjarrtar. Kam muaj të tërë që e kam gati këtë aparat të vogël. E megjithatë, sot për pak të lashë të ikje, kaq shumë frikë kisha.

— Duket gati si një radio me kapsulë.

— Por s'është vetëm aq, është diçka më tepër. Është një aparat për të dëgjuar! Po e fute ti në vesh. Montag, unë mund të rri rehat-rehat, në shtëpi, të ngroh këto kockat e mia të plakura, që më janë mpirë nga frika, e ndërkohë, pa asnjë zarar, të dëgjoj, të studioj botën e zjarrtarëve, t'i zbuloj asaj dobësitë. Jam bleta mbretëreshë që rri e sigurt në mes të folesë. Ju, bleta punëtore, veshi që endet e dëgjon. Me një fjalë, jam në gjendje t'i shpie veshët në çdo cep të qytetit nëpërmjet disa njerëzve që do të dëgjojnë e do të shqyrtojnë gjërat për mua. Edhe sikur bletët punëtore të vdesin, unë prapë jam i sigurt në shtëpinë time, duke e larguar frikën me një komoditet sa më të madh e me një rrezik sa më të vogël. E sheh sa i kujdesshëm që jam, sa i përbuzshëm që jam?

Montagu futi në vesh kapsulën e gjelbër. Plaku po ashtu futi në vesh një send tjetër të njëllojtë e lëvizi buzët.

— Montag!

Zëri i kumboi Montagut brenda kokës.

— U dëgjuaka për mrekulli!

Plaku zuri të qeshte.

— Edhe zëri yt për mrekulli dëgjohet! — belbëzoi ai, por ajo belbëzimë kumboi në veshin e Montagut si një ulërimë. — Kur të vijë ora, shko në kazermë, mua do të më kesh me vete. Pa të dëgjojmë ç'ka për të na thënë ky kapiten Biti. Kushedi, mbase mund të jetë edhe ai yni. Vetëm një perëndi e di! Unë do të të rrëfej se ç'duhet t'i thuash, kemi për t'ia punuar mirë. Më thuaj, më urren për këto marifetet e mia elektronike prej frikaçi? Unë vetë rri këtu, kurse ty të çoj aty ku është rreziku, në mes të natës, dhe ndërkohë vetë rri në prapavijë, me veshët e ngrehur, në pritje që ty të të presin kokën.

— Le të bëjmë aq sa kemi mundësi, — foli Montagu. — Do të mundohem t'i jap Bitit ndonjë libër tjetër në vend të këtij. Nesër...

— Unë do të takoj atë tipografin e papunë, po, po; kjo është e gjitha që mund të bëj.

— Natën e mirë, profesor!

— Jo, jo, natë të mirë nuk do të ketë. Unë do të jem me ty gjatë tërë natës, do të jem si ajo mushkonja e bezdisshme e do të të zukat në vesh sa herë që do të ma kesh nevojën. E po tani, mirë u pafshim dhe fat të mbarë, Montag!

Porta u hap dhe u mbyll. Sërish Montagu u gjend në mes të rrugës së errët, vetëm për vetëm me botën.

Atë natë ndihej se si në qiell po përgatitej lufta. Ndihej nga vetë mënyra se si retë herë largoheshin e pastaj prapë ktheheshin, nga vetë pamja që kishin marrë yjet, një milion yje, që endeshin përmes reve, si të ishin disqe të armikut, nga vetë ajo ndjenjë që kishe sikur nga çasti në çast qielli mund të lëshohej e do të binte përmbi qytet, duke mos lënë gjë tjetër përveç pluhurit të çimentos, ndërsa hëna do të shpërthente me një flakë të madhe, të purpurt. E tillë ishte kjo natë.

Montagu doli nga stacioni i metrosë me paratë në xhep. (Kishte arritur të shkonte në bankë, e cila qëndronte e hapur gjatë natës dhe ku shërbenin robotë mekanikë.) Ecte duke dëgjuar zërin e kapsulës së radios që kishte në vesh...

«Kemi mobilizuar një milion njerëz. Kurdo që të shpërthejë lufta, ne na pret një fitore e shpejtë...» Pastaj një lumë i tërë muzike e mbyti zërin që u tret në hiçgjë.

«Në të vërtetë janë mobilizuar dhjetë milionë njerëz, — i pëshpëriti Montagut në veshin tjetër zëri i Faberit, — por, kur thua një milionë, është gjë edhe më e sigurt, pastaj edhe bën më shumë efekt...»

«Faber?»

«Po?»

«Unë vetë s'mendoj. Si përhera, bëj vetëm atë që më thuhet. Më thatë të shkoj e të marr paratë dhe unë shkova dhe i mora. Vetë as që kishte për të më shkuar mendja. Kur, vallë, edhe unë do të mund të mendoj e të veproj me kokën time?»

«Ke filluar që tani, gjersa thua këtë që sapo the. Por veçse tani duhet të kesh besim te fjalët e mia.»

«Besim kam pasur edhe te fjalët e të tjerëve.»

«Dhe e pe vetë se ku po përfundoje. S'ke ç'bën. duhet të vazhdosh edhe ca të ecësh kështu, me sy mbyllur. Mbështetu te krahu im, ja ku e ke.»

«Nuk dua që të hidhem nga njëri kamp te tjetri vetëm që prapë të më diktojnë se ç'duhet të bëj. Po qe kështu, unë s'kam asnjë arsye pse të dezertoj.»

«E sheh? Sa me mend që po flet!»

Montagu ndjeu nën këmbë trotuarin, që e njihte mirë, dhe këmbët vetë e çuan në drejtim të shtëpisë.

«Vazhdo folë, të lutem!»

«Të pëlqen të më dëgjosh të të lexoj diçka, Montag? Të ta lexoj në një mënyrë të atillë që të të ngulet në mendje. Për vete, unë s'fle më shumë se pesë orë natën. S'kam se ç'bëj fare. Prandaj, po deshe, të lexoj diçka çdo natë, para se të flesh. Thonë se, po qe se dikush të pëshpërit në vesh, fiton njohuri edhe kur je duke fjetur.»

«Po, Faber.»

«Ja, pra.» — Qe shumë larg, nga ana tjetër e qytetit, në mes të hijes së mbrëmjes, erdhi fëshfërima e një faqeje që u kthye.

Në qiell po dilte hëna, dhe Montagu vazhdonte të ecte në drejtim të shtëpisë, duke luajtur buzët fare lehtë.

Po hante një darkë të lehtë në orën nëntë të natës, kur u hap duke kërkëllitur dera dhe Mildredi doli me vrap nga salloni, si të qe duke ikur, që t'i shpëtonte një shpërthimi vullkanik. Te pragu i derës u duk zonja Felps bashkë me zonjën Boulls, që u zhdukën pas pak brenda grykës së vullkanit, me nga një gotë Martini në dorë. Montagu e la darkën në mes. Ato ishin si një lampadar i përbindshëm kristali, që tringëllinte në mijëra tone nga më të ndryshmet; ai pa ato buzëqeshjet e tyre të përhershme, si ato të Maces Qeshire në «Botën e çudirave», i pa se si shndrinin nëpër paretet e shtëpisë, kurse tani ato po i ulërinin njëra-tjetrës, që të mund ta ngrinin zërin mbi poteren e madhe që bënte «familja». Montagu e kishte go-

jën akoma të mbushur plot, kur u gjend te pragu i derës së sallonit.

— Oh, ç'pamje të mrekullueshme që paskan të tërë sonte!

— Vërtet!

— Ti, Mili, njëherë, dukesh e mrekullueshme!

— Ashtu?

Montagu ndenji një copë herë duke i vërejtur.

«Ki durim,» — i murmuriti Faberi.

«S'duhet të isha këtu», — belbëzoi Montagu, thuajse po fliste me vete. «Tani duhet të isha në rrugë për te ti, të të sillja paratë.»

«S'ka pse ngutesh, Montag, silli nesër. Bëj durim!»

— A s'është një shfaqje e mrekullueshme? — thirri Mildredi.

— Fantastike!

Në një nga paretet një grua kishte vënë buzën në gaz dhe në të njëjtën kohë po pinte lëng portokalli.

«Si dreqin i bën dot të dyja gjërat njëherësh?» — i erdhi atij në mend kjo pyetje pa asnjë arsye. Në paretet e tjera bëhej radioskopia e po së njëjtës grua, ku dëftehej udha që përshkonte pija nëpër gurmaz, derisa mbërrinte në stomakun e kënaqur. Papritur dhoma u çua lart, duke fluturuar si një raketë përmbi retë, për t'u kredhur pastaj në një det llumi jeshil, ku peshq të kaltër gëlltitnin peshq të tjerë të verdhë e të kuq. Një minutë më pas, tre klounë të bardhë vizatimorë po i prisnin njëri-tjetrit këmbë e duar me sakica, mes të qeshurash të forta. Dy minuta më pas dhoma kishte dalë tashmë nga qyteti dhe kishte shkuar te ca makina reaktive, që vërtiteshin si të tërbuara nëpër një qarkore, duke u përplasur, duke u shtyrë me njëra-tjetrën, prapë pastaj duke u ndeshur. Montagut i zunë sytë ca trupa njerëzish që fluturuan përpjetë.

— Mili, i pe?

— Po, po, i pashë.

Montagu zgjati krahun për nga pareti i sallonit

dhe vërtiti dorezën kryesore... Menjëherë figurat u skeletizuan, u tretën si të kishin avulluar, thuajse një kupë e madhe, e kristaltë, e mbushur plot me peshq të tërbuar, tani ishte zbrazur nga ujët.

Të tria gratë u kthyen ngadalë nga ai dhe e panë Gaj Montagun, në filim të nervozuara, pastaj duke e shfaqur hapur tërë antipatinë që ndienin.

— Kur besoni se ka për të plasur lufta? — foli Montagu. — Me sa shoh, burrat tuaj s'paskan ardhur sonte.

— Oh, shkojnë e vijnë burrat, shkojnë e vijnë, — foli zonja Felps. — Finegani është sa brenda jashtë. Pitin e thirrën mbrëmë. Do të kthehet në shtëpi aty nga java që vjen. Të paktën, autoritetet ushtarake kështu thanë. Luftë rrufe. Dyzet e tetë orë, thanë dhe pastaj prapë në shtëpi. Kështu thanë ushtarakët. Luftë rrufe. Pitin e thirrën dje dhe i thanë se javën që vjen do të kthehet prapë në shtëpi. Luftë rrufe...

Të tria gratë tundën kokën dhe panë tërë nervat nga paretet e shkreta ngjyrë dheu.

— Unë për vete s'para bëhem merak, — foli zonja Felps. — Ia lë Pitit të gjitha andrallat. — Ajo ia shkrepi të qeshurit. — Le që e ka vetë merak Piti të rrijë e të vrasë mendjen. Unë, jo. S'e vras mendjen shumë unë.

— Ashtu është, — tha Mili, — lërja Pitit të vrasë mendjen edhe për ty.

— Është burri i ndonjë tjetrës që do të vdesë, kështu thonë.

— E kam dëgjuar edhe unë ta thonë këtë. Si s'kam njohur asnjëherë asnjë njeri që të jetë vrarë në luftë. Njerëz që të jenë vrarë, ngaqë janë hedhur nga dritarja, po, si i shoqi i Glories, javën që shkoi, por që të jenë vrarë në luftë, këtë, jo!

— Ashtu, vërtet në luftë, jo, — ia bëri zonja Felps.

— Sidoqoftë, unë me Pitin gjithnjë e kemi thënë s'është nevoja as për lot, as për zira e gjëra të këtij lloji. Si për të, ashtu dhe për mua, kjo është martesa e tretë, prandaj jemi të pavarur. Duhet të dish se si të

jesh i pavarur, e themi gjithmonë unë edhe Piti. Më
Piti mua: «Në ndodhte qe të vritem, t'i vashdo gjith
drejt në rrugën tënde, pa derdhur lot, mąrtohu së
e mos e vrit mendjen për mua.»

— Kjo më kujton diçka, — foli Mildredi. —
mban mend mbrëmë, në paret, atë rrëfimin roma
ne pasë minutat e emisionit të Klara Dovit? Flitej
një grua që...

Montagu nuk foli, por mbeti aty duke mos
shqitur syte fytyrave të grave, ashtu siç kishte m
tur njëherë, kur kishte qenë fëmijë e kishte hyrë
një kishë të çuditshme, duke parë fytyrat e shen
rëve. Asgjë prej gjëje s'i kishin thënë fytyrat e sn
tuara të atyre krijesave, edhe pse ai u kishte f
dhe kishte ndenjur gjatë në atë kishë, duke rrahu
bëhej edhe ai i asaj feje, të kuptonte se ç'ishte ajo
përmbi të gjitha, ishte munduar të mblidhte në m
këri një sasi të mjaftueshme timjani e nga ai plul
i veçantë i atij vendi, që do t'i kalonin më pas
gjak, për ta bërë të ndjeshëm ose të interesuar e
atë për çka donin të thoshin ato figura të ngjyro
burrash e grash, me sy porcelani e buzë të kuq
rubini. Por s'kishte pasur asgjë, asgjë që ai ta zbulo
kishte qenë njëiloj si të kalonte përmes reparteve të
magazine ku paratë e tij nuk shkonin, ku pasioni i
nuk u ndez, madje as edhe atëherë kur ai çikte me d
drurin, allçinë e gëlqeren.

Edhe tani po provonte po atë ndijim, këtu, në
llonin e vet, përpara këtyre grave, që shtrembërohe
nëpër poltrona nën shikimin e tij, ndiznin cigare, ç
lart re tymi, duke prekur me dorë herë pas here fl
e kuq flakë, vërenin thonjtë e shndritshëm, inkar
shentë, që të thoshe se kishin marrë flakë për sh
të shikimit të tij.

Tanimë fytyrat e tyre i kishte pushtuar heshtja.
tria gratë u zgjatën përpara për të dëgjuar zhurmën
bëri Montagu kur gëlltiti kafshatën e fundit; mba
vesh frymëmarrjen e tij të ethshme. Të tria paret
shuara të dhomës tani ishin si ballet e zbehta të

gjigantëve që flinin të pashqetësuar nga ndonjë ëndërr., Montagu pati përshtypjen se, sikur t'i çikte ato balle të braktisura, mollëzat e gishtërinjve kishin për t'iu njomur nga një shtresë e hollë djerse të kripur. Djersa sa vinte e shtohej në heshtje e me një vrumulisje subsonike, që ngjallte drithërime gjithë përreth e përbrenda grave, që po digjeshin nga tendosja e padurimi. Dukej sikur nga çasti në çast ato do të shpërthenin e të nxirrnin një fishkëllimë të zgjatur e të çjerrë.

Montagu lëvizi buzët.

— Bëjmë ca muhabet.

Gratë u rrëqethën dhe e panë të hutuara.

— Si i keni fëmijët, zonja Felps? — pyeti ai.

— Ju e dini fare mirë që unë s'kam fëmijë! E kush është ai njeri me mend në kokë sot që do të ketë fëmijë! — u përgjigj zonja Felps, e cila ende s'po e merrte dot vesh mirë se për ç'arsye ishte e nxehur me të.

— Jo, për këtë s'jam në një mendje, — ndërhyri zonja Boulls. — Unë, për vete, kam bërë dy fëmijë me operacion cezarian, se s'kishte kuptim që të hiqje gjithë ato mundime për të bërë fëmijë; se ta mendosh edhe bota duhet të riprodhohet, të vazhdojë. Pa llogaritur këtu që ngandonjëherë fëmijët të ngjasojnë, gjë që është mjaft e lezetshme. Prandaj i bëra fëmijët me operacion cezarian, pa e marrë vesh fare se si. Oh, më tha mua mjeku, ju s'keni nevojë për operacion, e keni legenin të gjerë, jeni krejt normale! Por unë ngula këmbë.

— Me operacion cezarian a pa operacion, fëmijët janë një tersllëk i vërtetë e ti duhet të jesh e luajtur gjersa arsyeton kështu si po arsyeton, — tha zonja Felps.

— Në dhjetë ditë nëntë i lë në shkollë dhe vetëm tri ditë në muaj më duhet të jem me ta, kur vijnë në shtëpi; le që pastaj s'është edhe aq keq sa ç'thua ti. Një të rrasur në sallon u bëj e një të kthyer dorezën e pareteve. Është njëlloj si të lash teshat në lavatriçe superautomatike: e mbush vaskën me teshat që ke për të larë e pastaj e mbyll mirë e mirë kapakun, — u ngërdhesh

[redacted]

— Dreqi e mori! — thirri Montagu. — Po ku dini ë ju për Porkun dhe Noblin!

— Si s'dimë! S'ka as gjashtë muaj që folën që të ı në paretet e sallonit. Njëri nga ata duke folur rrinte, inte e cimbiste majën e hundës; çudi si s'u çmenda ıke e parë!

— Po ju, zoti Montag, — foli zonja Felps, — ç'doni të ıoni, që ne të votonim për një njeri të tillë?

Mildredi shkëlqeu e tëra nga një buzëqeshje.

— Gaj, bëhu i mirë tani, largohu nga dera e mos ı i ngri nervat.

Por Montagu ndërkohë kishte ikur dhe ja ku u hye përsëri me një libër në dorë.

— Gaj!

— Oh, në djall vafshi të gjithë, në djall, në djall!

— Ç'paske ashtu në dorë, libër? Unë e di se tani ecialistët përgatiten vetëm me anë të filmave. — ɔnja Felps përpëliti qepallat. — Ç'ke ndër mend të sh tani? Do të lexosh diçka për zjarrvënësit?

— Në dreq të venë këta zjarrvënësit, — foli Mongu. — Këto janë vargje.

— Montag... — një murmuritje e Faberit.

— Më lër rehat! — Montagu e ndiente veten të përhirë nga një gumëzhimë e madhe, një zukatje, një ɔtere mendjevërdallisëse.

— Montag, mblidhe veten, nuk duhet...

— Po, a nuk i dëgjove, nuk i dëgjove këto përbinësha se si flisnin për përbindësha? O zot, t'i dëgjosh se marrin në gojë njerëzinë, vetë fëmijët e tyre, veten tyre, se si rrinë e dërdëllitin për burrat e tyre, si ërdëllitin për luftën, dreqi e mori, unë rri e i dëgjoj e marr dot vesh nëse është e vërtetë kjo që dëgjoj, ɔo jo!

— Unë s'thashë as gjysmë llafi për punë lufte, undohu ta kujtosh edhe vetë, — foli zonja Felps.

— Sa për poezinë, unë atë e urrej, — foli zonja oulls.

— Po ke dëgjuar ndonjëherë të të lexojnë ndonjë ɔezi?



— Çdo zjarrtari i lejohet një herë në mot që të sjellë me vete në shtëpi ndonjë libër nga ata të kohëve të shkuara, jo për gjë, po që t'u rrëfejë atyre të familjes se ç'marrëzi ishte ai zakoni i vjetër për të mbajtur libra e se si librat ua prishnin njerëzve qetësinë e i luanin mendsh. Ja, Gaji donte të na bënte sonte një surprizë, donte të na lexonte një pjesëz, që të na tregonte se ç'pështjellim kishin njerëzit në kokë njëherë e një kohë, që kështu asnjë prej jush të mos i turbullojë ndonjëherë ato kokat e bukura me gjepura të tilla. Apo s'është ashtu, shpirt?

Montagu e kishte shtrënguar në duar gjer në ngërç.

«Thuaj» «po»!

Dhe buzët e tij lëvizën njëherësh me ato të Faberit.

— Po.

Duke qeshur, Mildredi ia rrëmbeu librin nga dora.

— Ja, pa na lexo këtë pjesën që të bën aq shumë për të qeshur, është ajo pjesa që më lexove sot, që më shkriu së qeshuri. Keni për ta parë, — shtoi ajo dhe u kthye nga mikeshat. — S'do të merrni vesh asnjë fjalë. Është vërtet një rrëmujë që se merrni dot me mend, por, ama, të vdes së qeshuri. Eja, shpirt, ja ku e ke faqen!

Montagu vështroi faqen e hapur.

Një mushkonjë drodhi lehtë krahët brenda veshit të tij.

«Lexo!»

— Si titullohet, Gaj?

— *«Bregu i Doverit»*, — foli ai dhe gojën e kishte të mpirë.

— Tani, të lutem, lexoje shkoqur e ngadalë.

Dhomën sikur e pushtuan shkulme nxehtësie, dhe Montagu e ndjeu veten si mes flakëve, pastaj e ndjeu si të mbuluar me akuj; gratë rrinin ulur në tre kollukë, mes atij shkretimi të madh, kurse ai rrinte në tëmbë, i merreshin mendtë, rrinte e priste që zonja Pelps të mbaronte së rregulluari fundin e që zonja Boulls të hiqte gishtat nga flokët. Pastaj filloi të lexonte me

[redacted]

Zonja Felps po qante.

Të tjerat, aty mes shkretëtirës, rrinin e vërenin se si e qara e saj sa vente e shtohej, e bëhej më e zhurmshme, ndërsa fytyra e gruas shtrembërohej gjithnjë e më shumë. gjersa humbi çdo përngjasim me shëmbëlltyrën që kishte pasur më parë. Rrinin ulur e s'e preknin, të shushatura nga tronditja e saj, nga kjo shfaqje e vrullshme ndjenjash. Ajo po dëneste pa e mbajtur fare veten. Dhe vetë Montagu qe hutuar dhe e ndiente veten të trazuar.

— Sht, pusho tani, — ia bëri Mildredi. — Mblidhe veten, Klara, qetësohu. Ç'pate kështu?

— Unë... unë... — dënesi zonja Felps, — s'e di, nuk e di, po ja, unë... oh, oh...

Zonja Boulls brofi në këmbë dhe e pa Montagun gjithë tërbim.

— E. e patë tani? E dija unë. E dija unë që kështu kishte për të ngjarë! E kam thënë unë gjithnjë. e ç'është poezia — lot, poezia është vetëvrasje, të qara! Ju jeni njeri i lig, zoti Montag, shumë i lig.

«Po tani...» — foli Faberi.

Vetë Montagu e kuptoi se ishte kthyer mbrapsht e po shkonte drejt sobës, ku e lëshoi librin. nëpërmjet asaj grykës së ngushtë prej bakri, drejt flakës që e përpiu.

— Fjalë të marra, fjalë të marra, të marra e të shëmtuara. fjalë mizore. — vazhdoi si në një litani zonja Boulls. — Përse u dashka. pra, të ketë edhe njerëz që provojnë gëzim kur e lëndojnë tjetrin. Pak dhimbje ka në botë. po u dashka të trazohen njerëzit edhe me gjëra të tilla!

— Klara, mblidhe veten tani, eja, — përgjërohej Mildredi dhe njërin krah e kishte zgjatur drejt gruas që qante. — Hajde, hape vetë «familjen», që të vijmë ca në qejf, apo jo? Ec, hajde të qeshim tani. përpiqemi të argëtohemi ca. por pusho së qari njëherë. Hë, ç'thua, e bëjmë festë sonte!

— Jo, — foli zonja Boulls, — unë tani do të iki menjëherë në shtëpi. Ti, po deshe të më shohësh mua

«Sa për sonte, tha me vete, se, kushedi, Mildredit i mbushet mendja të djegë libra të tjerë.»

Hyri prapë në shtëpi.

— Mildred? — thirri kur mbërriti te dera e dhomës së gjumit, të kredhur tashmë në errësirë. Asnjë përgjigje.

Kur kaloi përmes lëndinës, për të shkuar në punë, u përpoq të mos hidhte sytë e të shihte se sa e zymtë dhe e shkretë dukej shtëpia e Klarisa Maklellënit...

Tek kishte marrë udhën që të shpinte për në qendër të qytetit, papritur e ndjeu veten aq të vetmuar, vetëm për vetëm me atë gabim të tmerrshëm që kishte bërë, saqë provoi një nevojë të çuditshme për ngrohtësinë e ngushëllimin që të përçon përherë një zë i njohur e i dashur, që të flet mes territ të natës. Vetëm pak orë kishin mjaftuar dhe atij tani i dukej sikur kishte një jetë të tërë që e njihte Faberin. Dhe vërejti se tanimë brenda tij ishin dy njerëz njëherësh, se ishte, së pari, Montagu, që s'dinte asgjë prej gjëje, madje as edhe që s'ishte veçse një copë idioti, megjithëse për këtë kishte njëfarë dyshimi. Dhe njëkohësisht ishte edhe ai plak, që i fliste e i fliste, ndërsa treni pneumatik e çonte nga një cep në tjetrin të qytetit të fjetur, duke e groshitur. Në ditët që i kishin mbetur, në netët pa hënë e në netët kur hëna e shndritshme do të ndriçonte lheun, plaku prapë do të vijonte t'i fliste, t'i fliste e të kerdhte ashtu tek ai pikë pas pike, guralec pas guraleci, petal pas petali. Dhe, ashtu, më së fundi, edhe mendja i tij do të piqej. dhe plaku i thoshte, e siguronte, i premtonte se ai s'do të ishte më ky Montag. Do të ishte Montagu plus Faberin, zjarrin plus ujin, gjersa, më në und, një ditë prej ditësh, pasi e gjithë kjo përzierje ë ishte trazuar mirë, s'do të kishte më as zjarr e as

ujë, po do të dilte verë. Nga dy gjëra të ndara e të kundërta, do të dilte një gjë e tretë. Dhe një ditë, kur të kthehej e të shihte veten, do ta kuptonte se ç'budalla kishte qenë. Madje tani ai e ndiente se e kishte nisur atë udhë të gjatë, atë largim, atë shkëputje nga vetja, nga ai që kishte qenë.

Ishte gjë e bukur të rrije e të dëgjoje shushurimën e atij aparatthi të gjelbër, zukamën e çakorduar prej mushkonje e filigramën e hollë të murmurimave të atij zëri plaku, që aty më parë po e qortonte, ndërsa tani, në këtë orë të vonë të natës, ndërkohë që ai po dilte që nga avujt e metrosë në botën e kazermës së zjarrit, po e qetësonte.

«Bëje zemrën të gjerë, Montag, bëhu i gjerë. Mos shfry e mos shaj; s'ka pak që edhe ti ishe një prej tyre. Ata janë aq të bindur se do të vazhdojnë të jenë kështu siç janë edhe për një copë herë të mirë. S'e kuptojnë se e gjithë kjo që po jetojmë, s'është veçse një meteor i vetëm e shumë i madh, që lë pas vetes në hapësirë një vragë të bukur e të shndritshme, por që, ama, shpejt apo vonë do të përplaset përtokë. Shohin vetëm vazhdën e flakës, ndriçimin, ashtu siç e shihje edhe ti. Montag, pleqtë, që rrinë tërë frikë mbyllur në shtëpi, që t'u bëjnë kujdes kockave të veta të brishta, s'kanë të drejtë të bëjnë kritika. Por, ama, ti thuajse i prishe të gjitha, pa filluar ende mirë. Ji i kujdesshëm! Unë jam me ty, mos e harro këtë; kur sjell ndër mend gjithë atë që ndodhi, duhet ta pranoj se ai tërbimi yt i verbër më mbushi me forcë. O zot, sa të rinuar që e ndjeva veten! Kurse tani dua që ti ta ndiesh veten plak, dua që ca nga ajo frika ime të hyjë sonte te ti. Pas pak, kur të shohësh kapiten Bitin, kaloji anash në majë të gishtave, lërmë mua të dëgjoj në vendin tënd, lërmë që të marr vesh se si qëndron puna. Qëllimi yné është që të mbetemi gjallë. Mos ua vër veshin se ç'thonë ca gra budallaqe.

— Kanë vite besoj që s'e kanë ndier veten ndonjëherë kaq fatkeqe sa ç'i bëra unë sonte, — tha Montagu. — Më bëri shumë përshtypje kur pashë zonjën

Felps, që po qante ashtu. Mbase kanë ato të drejtë, mbase më e mira është të mos i shohësh gjërat drejt e në sy, por të rendësh për t'u argëtuar sa të mundësh. As vetë s'e di. E ndiej veten fajtor...

— Jo, jo, s'duhet ta ndiesh veten ashtu! Sikur të mos ishte lufta, por në tërë botën të ishte paqe, edhe unë kisha për të të thënë «Argëtohu!» Shko zbavitu! Por, Montag, ti s'duhet të kthehesh mbrapsht e të mbetesh thjesht një zjarrtar. Në këtë botë s'është gjithçka në rregull...

Montagut i ishtë mbuluar balli me djersë.

— Montag, po më dëgjon?

— Këmbët, — iu përgjigj Montagu, — s'i lëviz dot më. E ndiej veten kaq të shushatur, në një gjendje kaq të çuditshme! Këmbët e mia s'duan të lëvizin më!

— Dëgjomë mua, mos u shqetëso, — i foli plaku me një zë të ëmbël. — E di, e di që ke frikë se mos bësh gabime. Por s'duhet ta kesh këtë frikë. Edhe nga gabimet mund të kesh përfitim. Miku im, kur isha më i ri, edhe unë ua përplasja njerëzve fytyrës padiskutime. E ata më zinin me dru. Por, ama, kur u bëra dyzet vjeç, i kisha mprehur mirë armët e mia të dijes. Po qe se e fsheh padiskutimin tënde, vërtet s'do të hash dru nga njeri, por, ama, as ke për të mësuar ndonjëherë kurrë. Tani luaji këmbët e shko në kazermë! Jemi dy tani, jemi binjakë, s'jemi më vetëm 'si ca më parë, të ndarë secili më vete, në sallonin e vet, pa asnjë lidhje me njeri-tjetrin. Po qe se do të kesh nevojë për ndihmë, kur Biti do të nisë të të hetojë, mua do të më kesh mu në veshin tënd e do t'i dëgjoj të gjitha!

Montagu ndjeu se si më parë këmba e tij e djathtë, pastaj dhe ajo e majta nisën t'i lëviznin.

— O plak, — i foli, — qëndromë pranë!

Zagari Mekanik kishte dalë përjashta. Kolibja e tij ishte bosh, dhe tërë Shtëpia e Zjarrit, me atë bardhësinë e saj të llaçit, ishte kredhur në heshtje, kurse salamandra ngjyrë portokalli flinte me barkun e mbushur plot me vajguri e me flakëhedhëset të kryqëzuara brinjëve; Montagu, duke hyrë në atë heshtje, u kap pas

shtyllës prej bronci e u ngjit lart, drejt errësirës, duke e kthyer kokën herë pas here, që të shihte atë kolibe të zbrazët, dhe befas zemra nisi t'i rrihte fort, pastaj i ndali e prapë nisi t'i rrihte. Tani për tani Faberi ishte për të si një flutur e hirtë nate, që i flinte brenda në vesh.

Biti rrinte dhe e priste pranë vrimës së zbritjes, por e kishte kthyer shpinën, si të qe aty rastësisht.

— E po ja, — u foli ai njerëzve, që po luanin me letra, — ja ku po vjen një kafshë shumë e çuditshme, që në të tëra gjuhët e botës e ka emrin idiot.

Zgjati dorën me pëllëmbën e shtrirë përpara, si të priste ndonjë dhuratë. Montagu i dha librin. Pa i hedhur as edhe një sy titullit të librit, Biti e flaku atë në koshin e plehrave dhe ndezi një cigare.

— Idiot më i madh është ai që i di gjërat përgjysmë. Mirë se u ktheve, Montag! Shpresoj se tani që të kaloi zjarrmia e të doli e liga, do të qëndrosh me ne, apo jo? A s'do të ulesh të bëjmë një dorë poker?

U ulën dhe nisën të shpërndanin letrat. Nën shikimin e ngulur të Bitit, Montagut i bëhej sikur edhe vetë duart i kishte fajtore. Gishtrinjtë i lëviznin si ca qelbës, që, si kanë bërë ndonjë prapësi, janë aq të shqetësuar, sa s'rrinë dot në një vend: ato duar herë fshiheshin në xhepa, herë dilnin prej aty; ishin gati të bënin çdo gjë mjaft që të shpëtonin nga vështrimi i Bitit, që i digjte si flakë e alkoolit. Montagut i dukej se mjaftonte që Biti t'u frynte njëherë, që duart e tij të nisnin të fishkeshin e të humbisnin çdo shenjë jete, duke u varrosur në thellësitë e mëngëve të xhaketës së tij, të harruara aty përjetësisht. Sepse ishin pikërisht duart ato që kishin nisur të vepronin me iniciativën e tyre, që s'kishin qenë pjesë e tij, për herë të parë tek ato ishte shfaqur ajo vetëdija e re, ajo dëshirë për të vjedhur libra, për të ikur duke marrë me vete Uiliam Shekspirin, kurse tani, këtu në kazermën e zjarrit, ato duar dukej sikur i shndritnin të lyera me gjak.

Dy herë brenda gjysmë ore Montagut iu desh të

ngrihej nga tryeza e lojës e të shkonte të lante duart. Kur kthehej, i fshihte duart nën tryezë.

Biti ia plasi të qeshurit.

— Pa na i trego njëherë duart, Montag. Jo se s'kemi besim te ti, edhe kjo na duhet, por, sidoqoftë, ti e kupton vetë...

Që të gjithë qeshën.

— E pra, — vazhdoi Biti, — ja, edhe kriza mori fund, dhe tani gjithçka shkon si jo më mirë, delja na u kthye në vathë. Që të gjithë dele jemi, dhe nganjëherë kemi dalë nga udha. E vërteta shpejt a vonë del në shesh, thërritnim ne. Nuk është kurrë i vetëm ai që ka në vete mendime fisnike, kërkonim ne të bindnim veten. «Bukë e ëmbël e shkencës ëmbëlsisht e dhuruar» kishte për të thënë sër Filip Sidnei. Por, veç, thuhet edhe kështu: «Fjalët janë njëlloj si gjethet. Sa më të dendura të jenë, aq më pak fryte të intelektit gjen mes tyre,» këtë e thotë Aleksandër Popi. Po ti ç'thua, Montag?

— Nuk e di.

— Ki kujdes! — murmurti Faberi që nga ajo bota tjetër shumë e largët ku jetonte.

— Po për këtë, Montag? «Të dish pak, është gjë e rrezikshme. Ja pi gjer në fund, ja mos shijo fare në burimin e Muzave. Se po të pish pak, veçse të turbullohet truri, kurse e pira shumë të bën të zgjuar e të hijshëm.» Prapë e Popit është, Montag. Eh, Montag, ç'ke për të thënë?

Montagu mblodhi buzët.

— Dëgjomë këtu, — filloi prapë të fliste Biti duke parë kartat që kishte në dorë. — Të gjitha këto sikur të kanë dehur ca për njëfarë kohe. Lexon pak rreshta, nja dy a tri vargje dhe ja, ty të merr koka erë. Dhe pas kësaj je gati të ndërrosh botën, të presësh koka, të shkelësh gra e fëmijë, të përmbysësh pushtetin e vendosur. E di unë, se edhe vetë e kam kaluar këtë.

— Unë jam krejtësisht i qetë, — tha Montagu, i turbulluar.

— E po atëherë, ç'ke që skuqesh! Të siguroj se

s'jam duke të ngacmuar. E di, nja një orë më parë pashë një ëndërr. Isha shtrirë për të marrë një sy gjumë e në ëndërr pashë veten dhe ty që ishim kredhur në një diskutim të zjarrtë për punë librash. Ti shkumëzoje i tëri nga tërbimi e më citoje duke ulëritur poetë e mendimtarë. Kurse unë, pas çdo fjale që ti më vërvitje, të përgjigjesha po njëlloj, qetë-qetë: «*Pushteti!*» — të thosha. Ti më citoje doktor Xhonsonin: «Dija është diçka më shumë se sa forca!» Kurse unë: «Ashtu është, por, ama, po ai Xhonson ka thënë, mor djali im i mbarë: «S'është i zgjuar ai që lë diçka të sigurt për diçka të pasigurt!» Mbaj anën e policisë së zjarrit, Montag. Gjithçka tjetër s'është veçse kaos, një kaos i tmerrshëm!

— Mos i zër besë, — murmuriti Faberi. — Po përpiqet të të ngatërrojë. Është dredharak si ndonjë rrëshqanth. Ki kujdes!

Biti qeshi.

— Kurse ti ma ktheje gjithnjë duke cituar: «E vërteta del në dritë, krimi s'qëndron dot i fshehur përgjithnjë!» Dhe unë të thërrisja me dashamirësi: «O zot, po ky njeri po flitka për veten e vet!» Pastaj shtova: «Dhe vetë djalli di hera-herës t'u drejtohet shkrimeve të shenjta, kur ia do interesi!» Ndërsa ti më ulërije: «Në këtë kohën tonë vlerësohet më mirë idioti i veshur me mëndafsh, sesa i urti i veshur me lecka!» Dhe atëherë unë të murmurita ëmbël-ëmbël: «E vërteta e humb tërë dinjitetin e vet, kur nis e proteston shumë.» Dhe pas këtyre fjalëve ti nise të thërrisje: «Kufomat kullojnë gjak në sy të vrasësit të tyre.» Kurse unë, duke të rënë krahëve: «Mos vallë po të them se vuan nga angina ulcero-membranoze?» Kurse ti duke thirrur gjithnjë e më tepër: «Të dish, do të thotë të kesh fuqi!» Dhe pastaj: «Një xhuxhmaxhuxh që ka hipur mbi supet e një gjiganti, është ai që sheh më larg ndër ata të dy!» Dhe atëherë unë e përmblodha gjithë mendimin tim, duke të thënë me një gjakftohtësi të rrallë: «Mania për të ngatërruar një metaforë me një provë, një rrëke fjalësh me një burim të vërtetash të gjithërëndësishme

dhe për ta hequr veten si orakull, është gjë e lindur te njeriu», — ka thënë njëherë e një kohë zoti Valeri.

Montagu e ndiente se si po i vërtitej koka rrëmbimthi. Ndiente një mizëri goditjesh në ballë, në sy, mbi buzë, mbi mjekër, mbi supe, mbi krahët, që i lëviznin qorrazi. Do të donte të thërriste: «Jo, hesht, ti po m'i ngatërron të gjitha me mjeshtëri! Pusho!» Gishtërinjtë e gjatë dhe të ndjeshëm të Bitit u zgjatën dhe i shtrënguan atij pulsin.

— O zot, pa shiko ç'puls! Të paskan prishur gjakun, eh, Montag? Të rreh pulsi si i një njeriu një ditë pasi ka mbaruar lufta! Vetëm sirenat dhe kambanat mungojnë! Të të them edhe një gjë tjetër? Po më pëlqeka kjo shprehje paniku në fytyrën tënde. Suahilin e zezakëve, indiançen, anglishten klasike, janë të gjitha gjuhë që unë i flas mirë.

«Montag, mos e lër që të të ngatërrojë!» — Flutura e natës përsëri i furfulloi Montagut në vesh. — «Kërkon që të turbullojë ujët!»

— Oh, ishe shushatur fare nga frika, — ia nisi prapë Biti. — Sepse unë po bëja një gjë të tmerrshme, duke përdorur vetë librat për të të ngatërruar! Eh, ç'tradhtarë që mund të jenë librat! Ti kujton se ata të mbështetin, kurse në të vërtetë ata të kanë dalë kundër. S'je vetëm ti, ka edhe të tjerë që i përdorin librat, dhe ja ku e gjen veten të mashtruar, të kredhur në llum gjer në grykë, të zhytur në një moçal me emra, me folje, me mbiemra. Tamam në përfundim të ëndrrës, unë erdha me salamandrën dhe të thashë: «Një rrugë me mua ke?» Ti hipe dhe ne erdhëm bashkë në kazermë në një heshtje të bekuar, tanimë të paqëtuar në shpirtin tonë të polemikës. — Biti ia lëshoi Montagut pulsin, ia lëshoi dorën, dhe ajo ra e flashkët përmbi tryezë.

— Gjithçka është e mirë, kur përfundon mirë.

Heshtje. Montagu rrinte i ulur si një copë gur i bardhë, i skalitur. Jehona e afyre goditjeve të fundit të çekiçit mbi kafkë sapo vinte e po largohej në ato guvat e errëta, ku Faberi po priste gjersa të shuhej edhe jehona e fundit. Dhe, kur, më në fund, pluhuri

i ngritur zuri vend përsëri në mendjen e Montagut, Faberi nisi t'i fliste me një ton të ëmbël!

«E po, mirë, gjer tani foli ai. Këtë s'duhet ta harrosh. Ca orë më vonë edhe unë do të të them atë që kam për të të thënë. Dhe atë duhet ta mbash mend. Dhe pastaj duhet të përpiqesh të peshosh fjalët e tij dhe fjalët e mia, që të vendosësh se në cilën anë do të shkosh të përplasesh. Por dua që këtë vendim ta marrësh ti dhe jo unë dhe aq më pak jo kapiten Biti. Sidoqoftë, mos harro që ky Biti i përket skotës më të rrezikshme të armiqve të së vërtetës dhe të lirisë. Që të gjithë ne jemi të detyruar të zgjedhim një avaz për të kënduar. Tani të erdhi radha ty të zgjedhësh se me cilin vesh të leverdis më mirë që të dëgjosh?»

Montagu hapi gojën që t'i kthente përgjigje Faberit dhe vetëm kambana e alarmit që ra e shpëtoi nga ky gabim që do të kishte bërë në prani të të tjerëve. Zëri i alarmit jehoi zvargur nëpër tavan. U dëgjua një trokëllimë kumbuese, kur telefoni i lidhur me thirrjen e alarmit në anën tjetër të sallës zuri të shkruante adresën.

Me kartën e pokerit në atë dorën e tij të skuqur dhe të mbufatur, Biti iu afrua me një ngadalësi të shtirë teleshkruesit dhe shkuli prej tij fletën mbi të cilën ishte shkruar denoncimi. I hodhi një sy pa shumë interes asaj që ishte shkruar aty dhe e futi copën e letrës në xhep. Pastaj u kthye te tryeza dhe u ul përsëri. Të tjerët po e vështronin.

— Mund të presë edhe nja dyzet sekonda sa do të më duhen për t'ju mundur ju të gjithëve, — foli Biti me një pamje të gëzuar.

Montagu i la kartat e tij.

— Je i lodhur, Montag? Po e lë lojën?

— Po.

— Një minutë. Tani që po e mendoj, këtë dorë mund ta mbarojmë edhe më vonë. I lëmë kartat mbi tryezë kështu siç janë, të përmbysura, dhe fillojmë të vishemi. Mos harroni se e lamë në dorën e dytë. — Biti

u ngrit përsëri në këmbë. — Montag, mos nuk je mirë? Nuk dua që të të zënë përsëri ethet...

— Nuk kam asgjë.

— Atëherë në rregull. Kësaj here kemi të bëjmë me një rast të veçantë. Eja, shkojmë, pra!

Brofën në këmbë, si të ishin ca toptha gome, e u kapën fort pas kolonës së bronctë, sikur ajo të ishte e vetmja shpresë shpëtimi që u kishte mbetur nga ajo dyndje e baticës, që po u vinte që përposh këmbëve, e kolona i lëshoi poshtë, duke ua dridhur ca zemrën, drejt thellësisë së errët, nga ku vinte gjëmimi fërshëllyes e kollitjet e dragoit me benzinë, që ishte duke u zgjuar.

— Ehi!

Morën një kthesë, mes zhurmës rrapëllitëse, ulërimës së sirenave, piskamës së frenave, llokoçitjes së vajgurit brenda rezervuarit të madh prej bakri, si ushqimi në stomakun e një gjiganti, ndërkohë që gishtërinjtë e Montagut befas u shkëputën nga leva e argjendtë ku ishin kapur e u shkëpurdhën të mpira nëpër boshllëkun e akullt; era ua fshikullonte flokët dhe ua hidhte prapa, u frëshëllente përmes dhëmbëve, kurse ai vazhdonte të mendonte për gratë, për ato gra shpirtvogla që kishin qenë dje mbrëma në sallonin e tij, ku shkulmet e erës së neonit ua kishin shkundur edhe ato pak grimca truri që u kishin mbetur, kurse ai, si ndonjë i marrë e histerik, kishte nisur t'u lexonte atyre një libër. Njëlloj si të kërkoje që me ndonjë nga ato revolet me ujë të shuaje një goxha zjarr; gjëja më bajate e më e pamend që mund të bëhet! Një tërbim që bëhet shkak për një tërbim tjetër. Një zemërim që i zë vendin një tjetri. E sa kohë do të vazhdonte të ishte një i marrë i tillë, sa kohë do të duhej që të bëhej edhe ai njeri i qetë e i përmbajtur, madje sa më i qetë e i përmbajtur që të ishte e mundur?

— Ja ku u nisëm!

Montagu ngriti sytë. Biti s'ngiste thuajse kurrë vetë, por kësaj here ai e kishte marrë vetë timonin, duke e përplasur salamandrën pas trotuarit, sa herë që

merrte kthesë, i tendosur i tëri përpara, ashtu i ulur, siç ishte, në fronin e lartë të pilotit, me atë pelerinën e zezë e të rëndë, që i valëvitej bollshëm përmbi shpatulla, aq sa e bënte t'i ngjasonte një lakuriqi nate gjigant, që fluturonte përmbi makinën, përmbi numrat e bronctë, duke e çarë erën mes për mes.

— Ja ku u nisëm, Montag, që të mbrojmë këtë botë të lumtur!

Mollëzat e trëndafilta të Bitit, të bëra gati fosforeshente, shndritnin në errësirë, sa herë që kapiteni vinte buzën në gaz, thuajse me histeri.

— Mbërritëm!

Salamandra e ngadalësoi shpejtësinë, u ndal me një gumëzhimë të zgjatur e nisi të pështynte mbi trotuar njerëz që zinin të hidhnin ngadalë çape të ngathëta. Montagu mbeti me sytë, që i digjnin, të ngulur në atë udhë që kishin përshkuar përmes erës, me gishtat e mbërthyer te leva e ftohtë dhe e shndritshme.

«S'mundem, s'e bëj dot», — mendoi me vete. — «E si ta kryej unë këtë detyrë të re, si të vazhdoj prapë t'u vë zjarrin gjërave? S'më ka mbetur më forcë që të mund të shkel në këtë shtëpi.»

Biti, që kundërmonte njëlloj si era mes së cilës kishin vrapuar, iu avit dhe e zuri për bërryli.

— E po, Montag?

Zjarrtarët, që, me ato çizmet e tyre të rënda, dukeshin si çalamanë, rendnin sa andej këtej, të heshtur si merimanga.

Dhe, më së fundi, Montagu i hoqi sytë nga leva dhe u kthye.

Biti po e vërente me kujdes.

— Ç'ke kështu, Montag?

— Po kjo, ç'do të thotë? — foli ngadalë Montagu. — Ne paskemi qëndruar para shtëpisë sime.

PJESA E TRETË

FLAKA QË SHNDRIT

Në shtëpitë përgjatë rrugës njerëzit ndezën dritat e hapën portat për të parë fillimin e festës së mrekullueshme të zjarrit. Biti e Montagu ia kishin ngulur sytë, njëri me një gëzim të përmbajtur e tjetri pa u besuar akoma syve të vet, asaj shtëpie që kishin përpara, atij cirku të madh, në arenën e të cilit do të dilnin pas pak për të luajtur me pishtarët e flakëruar e çdo gjë do të gëlltitej nga zjarri.

— E, pra, ja, — foli Biti. — Ja ku ia arrite qëllimit. Montagu i mbarë na donte të fluturonte gjer pranë diellit, kurse tani, që iu dogjën ato të nëmura flatra, do që të marrë vesh arsyen përse iu dogjën. A nuk të fola vallë shkoqur, kur të dërgova Zagarin rrotull shtëpisë?

Fytyra e ngrirë e Montagut nuk shprehte asgjë; ai ndjeu se si koka e tij e rëndë si një copë gur u kthye përkundrejt asaj shtëpie të zymtë e të errët të fainjit, të rrethuar me lehe lulesh shumëngjyrëshe.

Biti shfryu me përbuzje:

— Pa shiko! Mos t'i mori gjë mendtë ajo e çmendura e vogël me ato metodat e saj, Montag? Lule, gjethe, flutërza, perëndime të bukura dielli, oh, djalli e marrtë! I di, i di të gjitha janë të shkruara në dosjen e saj! Me sa duket, i paskam rënë pikës! Mjafton të shohësh cehren tënde prej të vdekuri! Për ca fijëza

bari e pak drapërinj hëne, apo s'është ashtu? Ç'gjepura! E ç'nxorri me të gjitha këto ajo çupëlinë?

Montagu u ul mbi parafangon e ftohtë të salamandrës, duke e luajtur kokën pak nga e djathta, pak nga e majta, djathtas, majtas, djathtas, maj...!

— I shihte të gjitha ajo vajzë. Dhe asnjeriut s'i bëri gjë. S'i bëri keq askujt ajo!

— Pa shih, s'i bëri keq askujt, thua ti, ëh! Po ty ç'të bëri, a nuk të përpiu pak e nga pak? Ajo ishte një nga ato fanatiket e mallkuara, që, me atë heshtjen e tyre fodulle e virtytet e shtira, në të vërtetë nuk kanë veçse një talent: ta bëjnë tjetrin ta ndiejë veten gjithnjë fajtor, sa kohë që është në prani të tyre. Djalli i marrtë! Shtiren sikur janë si ai dielli në mesnatë vetëm e vetëm që të të bëjnë ty të vdesësh i mbytur në djersë, brenda në shtrat!

Porta e shtëpisë u hap. Mildredi zbriti me vrap shkallët, me një valixhe të shtrënguar fort në dorën e ngrirë, dhe po në atë cast një taksi reaktive u ndal para trotuarit me një fërshëllimë frenash.

— Mildred!

Ajo kaloi para tij si e ngurosur, me fytyrën krejt të zbardhur nga pudra, kurse gojë thuajse nuk kishte më, meqë kishte harruar të lyente buzët.

— Mildred, nuk më ke spiunuar ti, apo jo?

Ajo hodhi valixhen në taksinë që po e priste, hipi edhe vetë në të dhe u ul duke murmuritur me vete:

— E shkreta familje, ohu, e shkreta familie, u prish e gjitha, e gjitha, i mori lumi të gjitha tanimë...

Biti e zuri Montagun për supi, po atë çast që taksia u nis duke gumëzhitur e u zhduk shpejt matanë fundit të rrugës.

U ndje një zhurmë e mbytur, sikur u shemb e u bë copë e çikë një ëndërr, e sajuar me kristal, me pasqyra e prizma kuarci. Montagu bëri disa çape, si ta kishte shtyrë nga pas një vorbull ajri e pashpjegueshme, që të kthehej andej për të parë Stounmenin e Bllekun se si po vringëllonin sëpatat, duke thyer

xhamat e dritareve, që të linin ajrin të hynte brenda shtëpisë lirisht.

Frushullima e një fluture nate, që përplasej pas një ekrani të shuar, të ftohtë.

«Montag, më dëgjon, po të flas unë Faberi? Ç'po ndodh aty?»

— Tani më erdhi radha mua, — i foli Montagu.

— Ç'e papritur e dhimbshme, ëh? — tha Biti. — Tanimë të gjithë e dinë se s'mund të jesh kurrë fare i sigurt e të thuash mua s'më ndodh dot gjë. Ka të tjerë që lënë kokat, por, ama, unë rri i paprekur. S'ekzistojnë pasoja, përgjegjësira për mua. Por ja që paska! Po le që kot të flasim, ëh? Se, kur pasojat të vijnë e të bien mbi kokë, atëherë është gjithnjë tepër vonë, apo s'është ashtu, Montag?

«Montag, a nuk ke mundësi të ikësh, t'ia mbathësh vrapit?» i tha Faberi.

Montagu eci në drejtim të shtëpisë, por pa e ndier se si këmbët i çiknin në fillim çimenton, pastaj barin e njomë. Vetëm një çap larg tij Biti ndezi flakëhedhësen, dhe ai s'mundi ta largonte dot shikimin nga ajo flakëzë ngjyrë portokalli.

— Ç'të ketë vallë zjarri që i bën njerëzit ta adhurojnë aq shumë? Ç'është ajo që na tërheq aq shumë tek ai, të rinj apo pleq qofshim? — Biti e shuajti flakën me një të fryrë, pastaj shpejt e ndezi prapë. — Është lëvizja e përhershme, ajo që njeriu gjithnjë ka dashur ta shpikë, por që kurrë s'ka mundur. Apo një lëvizje thuajse e përjetshme. Po e le të ndezur, ai do të vazhdojë të digjet, përsa kohë do të jemi ne gjallë. E ç'është zjarri? Mbetet një mister. Shkencëtarët na tregojnë një mal të tërë me absurditete, jo punë fërkimesh, jo punë molekulash. Por në të vërtetë as ata vetë s'e dinë. Bukuri e vërtetë e zjarrit qëndron në atë që ai i shkatërron të gjitha edhe përgjegjësirat edhe pasojat. U bë një çështje ca si shumë e ngatërruar? Shpejt, hidhe në zjarr e mos e zër më në gojë! E, pra, Montag, dua të të them se edhe ti u bëre ca si shumë i ngatërruar. E tani zjarri do të ma heqë nga supet kë-

të peshën tënde, në një mënyrë të pastër, të shpejtë e të sigurt; s'lë gjë pas ai që të qelbet. Edhe higjenik, edhe estetik, edhe praktik.

Montagu u ndal që të shihte brenda asaj shtëpie tanimë të huaj, që ia kishin bërë të tillë kjo orë e vonë e natës, murmurima e zërave të fqinjëve, xhamat e thyer; kurse atje tej, mbi dysheme, dukeshin kapakët e librave të shqyer e të shpërndarë gjithë përreth, si ca pendë mjellme, ata libra absurdë, që kishin marrë një pamje aq qesharake, sa të thoshe, ç'është e drejta, se nuk ia vlen të shqetësoheshe kaq shumë për ta, sepse, fundja, s'ishin gjë tjetër veçse kartë e nxirë, kartë e zverdhur e kopertina të shqitura.

Me siguri që Mildredi do ta kishte parë kur i kishte fshehur librat në kopsht, e atëherë do t'i kishte shkuar në mend t'i merrte e t'i fuste në shtëpi. Ah, Mildred, Mildred!

— Do të doja që këtë punë ta bëje të gjithë ti vetë, Montag. Dhe jo me vajguri e shkrepëse, por t'i marrësh një për një e t'i djegësh me flakhedhëse. Jotja është shtëpia, ty të takon ta spastrosh.

«Montag, mundohu të ikësh, t'ia mbathësh.»

— Jo! — thirri Montagu me një zë të dëshpëruar. — Zagari! Duhet të jetë diku këtej rrotull.

Faberi e dëgjoi, e dëgjoi edhe Biti, që duket pandehu se ato fjalë i drejtoheshin atij, se pohoi me kokë.

— Po, Zagari është këtej, nga këto anë. prandaj kujdes, Montag, mos bëj marrëzira. Je gati?

— Gati jam, — Montagu i hoqi flakëhedhëses siguresën.

Një gjuhë e madhe flake gulçoi e frushkulloi librat, duke i vërvitur pas murit. Montagu hyri në dhomën e gjumit dhe e lëshoi dy herë atë flakë: krevati dopio u çua përpjetë, i përfshirë nga flakët, me një fëshfërimë kërcëllitëse, duke lëshuar më shumë nxehtësi, pasion e ndriçim nga ç'i kishte shkuar ndonjëherë atij ndër mend se mund të gjendej në atë shtrat. Po njëlloj dogji muret e dhomës së gjumit e dollapin, e

tualetin, sepse donte t'i ndryshonte të gjitha, me karrige, me komodinat e enët e argjendta dhe vazot plastike në dhomën e bukës, gjithçka që mund të dëshmonte ndonjëherë që ai kishte jetuar brenda kësaj shtëpie të zbrazët, me një grua të huaj, e cila që nesër as do ta sillte ndër mend, ashtu e kredhur e tëra në atë që kufja e radios i derdhte e i derdhte pareshtur përbrenda kokës, ndërkohë, që, e vetme, përshkonte qytetin me një taksi. Dhe, ashtu si njëherë e një kohë, e ndjeu prapë se ç'gjë e bukur ishte të digjje, iu bë sikur e gjithë qenia e tij po tretej në kreshpërimën e zjarrit, tek shqyente, çante, ndante më dysh me flakë, duke i dhënë zgjidhje kësisoj atij problemi të pakuptim që e mundonte. Gjersa s'kishte zgjidhje, kjo donte të thoshte se nuk kishte asnjë problem! Zjarri ishte ilaçi më i mirë për të gjitha!

— Librat, Montag!

Librat hovnin përpjetë e kërcenin si ca zogj që duan t'i djegin, me ata krahët pendëverdhë e pendëkuq që u digjeshin.

Tani ai mbërriti në sallon, ku dergjeshin në gjumë, me ato mendimet e tyre të zbërdhylëta e ëndrrat e bardha borë, ata përbindëshat e mëdhenj idiotë. Montagu lëshoi nga një breshëri zjarri kundër secilit prej pareteve televizive pa jetë, dhe boshllëku prapa ekranëve konakëve të copëtuar iu përgjigj duke fërshëllyer. Vakumi nxori një fërshëllimë akoma më të zbrazët, një klithmë të pakuptim. Ai kërkoi ta shpinte mendjen tek ajo zbrazëti ku kishte parë të shfaqej hiçgjëja, por s'mundi. E mbajti frymën, që të mos e linte zbrazëtinë t'i futej brenda në mushkëri. E largoi nga vetja atë zbrazëti të tmerrshme, duke u zbythur ca, dhe pastaj i dha si shpërblim të gjithë dhomës një lule të madhe, të verdhë, inkandeshente, prej zjarri. Veshja me lëndë plastike kundër zjarrit, që mbulonte gjithçka, u hap në një të çarë të madhe, dhe gjithë shtëpisë i hynë të dridhurat e flakëve.

— Kur të kesh mbarur, — i tha befas që prapa kurrizit zëri i Bitit, — mos harro se je i arrestuar.

Shtëpia po shembej mes një zurkaje thëngjijsh të ndezur e hiri të zi. Më së fundi, ai u ul përdhe, mbi një shtrat të përgjumur hiri të murrmë në të trëndafiltë, dhe një shtëllungë tymi, që shpërdridhej përmbi të, shkoi duke u luhatur lehtë-lehtë e u shpërnda aty-këtu përmbi qytet. Ishte ora tre e gjysmë pas mesnate. Turma u fut prapë nëpër shtëpitë e veta, nga tendat e mëdha të cirkut tanimë s'kishin mbetur veçse pirgje thëngjijsh e rrënojash dhe shfaqja kishte marrë fund.

Montagu kishte mbetur me flakëhedhësen në ato duart e tij të flashkëta, ndërkohë që ishuj të mëdhenj djerse po përhapeshin duke i njomur sqetullat e fytyrën e ndotur nga bloza.

Zjarrtarët e tjerë prisnin në errësirë, pas kurrizit të tij, me fytyrat e ndriçuara paksa e rrëshqanthi nga thëngjijtë e fundit të prushit.

Dy herë u bë gati Montagu të fliste, por, vetëm pasi vuri rregull në mendimet që kishte në kokë, tha:

— Ishte ime shoqe, që më denoncoi, apo jo?

Biti pohoi me kokë.

— Veçse ato mikeshat e saj kishin bërë qysh më parë një denoncim, që unë s'e mora parasysh. Shpejt a vonë do të bije brenda. Ishte një marrëzi e tërë ajo që bëre ti, të vesh e të recitosh vargje mu para tyre, kështu, pa e prishur fare terezinë. Një dreqo gjest snobi. Jepi një njeriu nja dy a tri vargje, dhe atij ka për t'iu mbushur mendja se ja, na u bë zot i gjithësisë. Mos beson gjë se me ata librat e tu tani je i zoti edhe të çapesh përmbi ujë? Apo s'është ashtu? Kurse në të vërtetë bota mund të ecë përpara fare mirë edhe pa ta. Bën mirë të shohësh se ku të katandisën librat: të kanë kredhur në llucë gjer në grykë. Mjafton që unë ta trazoj ca llucën, ja, me këtë gishtin e vogël këtu, që të shoh se si do të mbytesh.

Montagu s'ishte në gjendje të luante nga vendi. Një tërmet i madh kishte ardhur bashkë me zjarrin, që të rrafshonte shtëpinë, dhe Mildredi ndodhej di-

ku nën ato rrënoja, e bashkë me Mildredin e tërë jeta e tij ishte aty nën to; ja përse ai s'ishte në gjendje të luante nga vendi. Tërmeti vazhdonte ende ta shkundte të tërin përbrenda, duke bërë që të binin e të shembeshin sa e sa gjëra, kurse Montagu rrinte aty i palëvizur, me gjunjët gjysmë të përthyer nën peshën e madhe të lodhjes, të habisë e të rrënimit, duke e lënë Bitin që t'i jepte goditje pas goditjeje.

— Montag, o idiot, Montag, o leshko, pa më rrëfe arsyen e vërtetë pse e bëre këtë?

Montagu nuk e dëgjonte, ai s'ishte ai, ndodhej shumë larg, po rendte tutje me mendimet, kishte shpëtuar duke lënë pas vetes atë trup pa jetë, të mbuluar nga bloza, që po përkundej sa në njërën anë në tjetrën para trupit të një tjetri, që e kishte humbur arsyen nga tërbimi që e kishte zënë.

«Montag, ik që aty»! — i foli Faberi.

Montagu ngrehu veshët.

Biti i dha një goditje të fortë kokës, që e detyroi të zmbrapsej. Tubthi i gjelbër, nga ku vinte gumëzhima e zërit të Faberit, ra mbi trotuar. Biti e mori me ngut, duke u ngërdheshur, dhe e afroi pranë veshit.

Montagu dëgjoi zërin e largët që po e thërriste: «Montag! Montag, mos të ndodhi gjë?»

Biti zhvidhosi fishekthin, duke ia shkëputur kontaktin dhe e futi në xhep.

— Ah, mirë! Paska më shumë nga ç'e pandehja në këtë mes! Pata vënë re se anoje ca kokën, si të doje të dëgjoje më mirë. Në fillim kujtova se mos kishe ndonjë kufje. Por pastaj, kur të pashë që po sillesh si ndonjë budalla, nisa të dyshoja. Por mos u bëj merak, me këtë send kemi për ta gjetur edhe mikun tënd!

— Jo! — tha Montagu.

Dhe i hoqi siguresën flakëhedhëses. Biti e hodhi menjëherë shikimin te gishti i Montagut, dhe sytë e tij u zgjeruan paksa. Montagu lexoi habinë në ata sy, dhe ai vetë uli sytë te duart e veta, që të shihte se ç'gjë të re kishin bërë ato? Kur më pas solli ndërmend

këtë çast, asnjëherë s'qe në gjendje të thoshte nëse kishin qenë duart e tij apo reagimi i Bitit ndaj duarve që e kishin shtyrë atë, së fundi, të kryente krimin. Ushëtima e fundit rrëkëllyese e ortekut i shpërtheu pranë veshëve, por orteku atë vetë s'e preku.

Biti e vuri buzën në gaz në mënyrën më joshëse.

— E po, edhe kjo është një mënyrë se si t'i bësh njerëzit të të mbajnë vesh. Drejtoju një armë, dhe do ta shikosh si kanë për të dëgjuar. E, pra, nise ligjërimin. Përse është fjala kësaj radhe? Pse nuk provon të dërdëllitësh ca Shekspir, mor snob i mjerë?

«S'më tremb dot, Kas, me këto kërcënime. Me nder jam armatosur aq fort, sa më kalojnë si një er' e kotë, që veshi s'ma përfill...» Êh, si të duket? Hë, tani, mor letraruc i dorës së dytë, qëllo!

Dhe bëri një çap drejt Montagut.

Montagu tha vetëm kaq:

— Ne gjithmonë kemi djegur atë që s'duhet djegur...

— Ma jep këtu flakëhedhësin, Gaj, — i tha Biti me atë buzagazin e tij të ngrirë.

Dhe atë çast ai u shndërrua në një flakë të shndritshme, një maniken që përkundej e dridhej, që s'ishte më as njerëzor e as i njohshëm, por veçse një flakë që drithërohej mbi lëndinë, ndërkohë që Montagu i lëshonte një çurk të vazhudueshëm zjarri të lëngshëm. U dëgjua një fërshëllimë si ajo e një pështyme të madhe që bie mbi sobën e nxehtë, një vlim i ankthshëm, i drithëruar, sikur të qe derdhur kripë mbi një kaçamill të zi, të përbindshëm, për të sjellë një lëngëzim të tmerrshëm, bashkë me një gurgullimë shkume të verdheme. Montagu mbylli sytë e ulëriti, ulëriti me sa zë që kishte, duke shpënë duart te veshët me një sforcim të dëshpëruar, për ta mbytur, për ta mbajtur larg vetes atë ulërimë. Biti u lëshua, u mblodh kruspull si ndonjë kukull dylli e mbeti i palëvizur.

Të dy milicët e tjerë kishin ngrirë në vend, nuk po lëviznin.

Montagu mezi arriti ta mposhtë neverinë që ndie-

nte gjer në atë çast, kur e drejtoi flakëhedhësen nga ata të dy.

— Kthehuni mbrapa!

Ata i kthyen kurrizin, me ato fytyra që u ngjasonin dy copave mishi të zier, që kullonin djersë; Montagu i përplasi ato dy koka, ua hoqi atyre helmetat me një të goditur të dorës e i hodhi njërin mbi tjetrin. Ata ranë dhe mbetën aty, përtokë, të palëvizur.

Shushurimë e një gjetheje të vetme vjeshtake. Montagu u kthye, dhe Zagari Mekanik ishte aty, mu përpara tij.

Ndodhej thuajse në mes të lëndinës, pasi kishte dalë nga hijet e përfundme e tani po bënte përpara me një elegancë aq të shkrifët, sa të thoshe se në të vërtetë s'qe veçse një re e lëndëzuar prej tymi të murrmë, që, pa u ndier, po shkapërderdhej drejt tij.

Me një kërcim të fundit, ai u lëshua mbi Montagun, duke u hedhur nja një metër mbi kokën e tij, me ato gjymtyrë merimange të zgjatura përpara, me atë thumbin me prokainë që i dilte jashtë, si të qe një dhëmb i vetëm i helmët. Montagu e priti me një shkulm flake që kur qe ende në ajër, një shkulm të vetëm të hatashëm, që u spërdrodh në ca petale të verdha, të kaltra e të portokallta përreth qenit metalik dhe e veshi atë me një lloj korace të re, po atë çast kur ky ra mbi Montagun, duke e flakur atë nja dhjetë hapa mbrapa, duke e përplasur pas trungut të një peme, gjithnjë me flakëhedhësin në dorë. Montagu e ndjeu se si Zagari po lëvizte si i tërbuar, se ai e rroku nga njëra këmbë dhe kishte zënë tashmë t'ia ngulte agen — edhe një çast e ajo do t'i futej në këmbë: por pikërisht atëherë shkulmi i flakës e ngriti Zagarin përpjetë, ia pëlciti eshtrat e metalta mu në nyjë, ndërkohë që të brendshmet i shpërthyen në një flakadan të vetëm të kuq, si të qe një fushqetë ajrore e hedhur aty, mbi rrugë. Montagu, ashtu i shtrirë përdhe, e pa atë krijesë as të gjallë e as të vdekur se si po merrte fund. Por edhe tani praë dukej sikur donte t'i sulej, që ta çonte gjer në fund

injektimin, të cilit Montagu tani kishte nisur t'ia ndiente pasojat në këmbë. Atë çast ai ndjeu t'i përzihej lehtësimi me llahtarën, kur kujtoi se qe zbythur tamam në kohë, e s'ndjeu veçse dhimbjen e gjurit, si t'ia kishte dërrmuar parafangoja e një makine që i kishte kaluar përbri me nëntëdhjetë milje në orë. Kishte frikë të çohej, frikë se s'do të ishte më i zoti të mbahej me atë këmbë të anestezuar. Mpirja sikur po e pushtonte të tërin...

Po tani?

Rruga e shkretë, si të qe një dekor teatri i vjetër e i panevojshëm, godinat e tjera të kredhura në terr, këtu Zagari, ca më tutje Biti, akoma më tutje zjarrtarët e tjerë, kurse aty Salamandra... Vështroi makinën e madhe. Edhe ajo duhej zhdukur. «E po, — i tha vetes, — pa të shohim si të kanë katandisur. Jepi, çohu. Ngadalë, ngadalë... ja... kështu.» Ndenji ngritur, por duke u mbështetur vetëm në njërën këmbë. Tjetrën e kishte si ndonjë copë dru pishe të djegur, që ai e mbante ngjitur pas vetes për kushedi ç'lloj mëkati të panjohur. Kur provoi të lëshonte mbi të gjithë peshën e trupit, një zurkajë e tërë agesh të argjendta e shpoi që nga mesi i pulpës gjer lart, te gjuri. E çoi këmbën. Jepi! Lëviz! Lëviz, s'mund të rrish dot këtu përjetë!

Në disa nga shtëpitë përfund rrugës u ndezën prapë dritat, ja ngaqë ndodhia tashmë kishte marrë fund, ja për shkak të heshtjes së pazakontë që pasoi plojën, këtë as vetë Montagu s'e thoshte dot. Eci çalë-çalë aty-këtu përmbi rrënoja, duke e mbajtur me duar këmbën e mpirë, duke i folur, duke rënkuar, duke i ulërirë urdhra, duke e mallkuar e duke iu përgjëruar që t'i shërbente, tani që prej saj varej jeta e tij. Dëgjoi disa njerëz që po bërtisnin përmes errësirës, ata diç thoshin duke thërritur. Më së fundi, Montagu mbërriti në kopshtin që ndodhej nga prapa shtëpisë, përgjatë rrugicës. «Biti, — mendoi me vete, — tanimë ti s'përbën më asnjë problem. E thoshe gjithnjë edhe vetë: «Një problem që ke, nuk shqyrtohet, por

digjet.» E pra, ja unë bëra dy punë njëherësh. Lamtumirë, kapiten!»

Dhe u largua duke çaluar përgjatë rrugicës, në errësirë.

Sa herë që e mbështeste këmbën përtokë, i bëhej sikur ia kishin mbushur me saçme, e çdo herë ai i thoshte vetes: «Budalla i djallit, i marrë, e asgjë tjetër, shih se ç'katranose, si do t'ia bësh hallit tani? Shih në ç'belara e fute veten, po tani ç'ke ndër mend të bësh? I prishe të gjitha, e mori dreqi, e të gjitha këto nga mendjamadhësia e nga gjaknxehtësia. E prishe çdo gjë pa e filluar ende. Është e vërtetë se t'u vërsulën të gjithë menjëherë, njëri pas tjetrit: Bïti, gratë, Mildredi, Klarisa, gjithçka. Dhe prapëseprapë, s'ke justifikim, e di apo jo, nuk ke justifikim! I trashë që je, tamam budalla, shko me vrap e dorëzohu tani!

Jo, të shpëtojmë ç'ka mbetur ende për t'u shpëtuar. Në u dashtë të përfundojmë mbi turrën e druve, le të marrim edhe ca të tjerë me vete. Ashtu, vërtet!»

Iu kujtuan librat dhe u kthye mbrapsht. S'u dihet punëve! Gjeti disa libra aty ku mendonte se do t'i gjente, pranë gardhit të kopshtit. Falë zotit, Mildredi ata nuk i kishte parë. Katër libra gjendeshin të fshehur aty ku i kishte vënë ai. Zëra gugitnin nëpër natë, drita makinash shponin errësirën. Të tjera salamandra gumëzhinin nëpër rrugë, tepër larg, dhe sirenat e policisë vikatnin nëpër gjithë qytetin, duke e çarë rrugën me goditje sakice.

Montagu i mori të katër librat dhe, ashtu çalë-çalë, duke fërgëlluar i tëri, u shty gjer në fund të rrugës, ku befas u shemb, sikur dikush t'ia kishte këputur kokën dhe aty përdhe të dergjej vetëm trupi i tij. Diçka përbrenda e kishte detyruar të ndalej ashtu menjëherë,

me një fërgëllimë, dhe pastaj e kishte flakur përdhe. Mbeti i shtrirë aty ku ra dhe zuri të dëneste, me këmbët të mbledhura, me fytyrën të rrasur verbërisht në zhur.

Biti kishte dashur vetë të vdiste!

Në mes të asaj të qare, Montagu e kuptoi se kjo ishte e vërteta. Biti kishte dashur vetë të vdiste. Ai kishte qëndruar para tij i palëvizur, pa bërë asnjë orvatje që të shpëtonte, kishte ndenjur ashtu në këmbë, duke i hedhur thumba, duke bërë shaka. Nga ky mendim, Montagut iu mor fryma, iu shfaq një lemzë që s'i linte kohë të merrte frymë. Ç'gjë e çuditshme, sa e çuditshme, të dëshirosh aq shumë që të vdesësh, sa të lejosh një njeri të të sillet rrotull i armatosur, e pastaj, në vend që ta mbyllësh sqepin për të shpëtuar kësisoj lëkurën, të vazhdosh t'i hedhësh me të thirrura ca tallje të pacipa, gjersa t'ia kesh ngritur nervat, gjersa...

Nga larg, zhurmë hapash që vraponin.

Montagu u ngrit ndenjur. «Ik që këtej. Shkojmë, çohu, çohu, s'qëndron dot i ulur këtu, si të mos ketë ndodhur asgjë!» Prapë kishte nisur të qante, por duhej mbledhur vetja.

Ja, tani kriza po i kalonte. Ai s'kishte dashur asnjëherë të vriste njeri, as edhe Bitin. Iu mizërua mishtë, ndjeu ca të shpuara, si ta kishin kredhur në acid. U zhyt në një dallgë neverie. Iu shfaq Biti i shndërruar në një flakadan, i palëvizur, i mbledhur kruspull në lëndinë. Kafshoi duart, që të mos bërtiste. Ç'dhimbje, o zot, ç'dhimbje e ç'brengë...!

U përpoq të rindërtonte gjithçka, plotësisht, të kthehej me mendje në atë jetë që kishte bërë dy a tri ditë më parë, para sitës dhe rërës, para pastës së dhëmbëve Denham, para zërit si fëshfëritja e një fluture nate, para alarmeve e vrapeve dhe, deri në ngjarjen e kësaj nate; qenë si tepër të gjitha këto vetëm për dy a tri ditë, tepër bile edhe për një jetë të tërë.

Zhurmë hapash që nguteshin kumboi nga ana tjetër e rrugës.

«Çohu! — e urdhëroi ai këmbën. — Djalli e mori, çohu!» dhe sërishmi u ngrit. Të therurat ishin bërë tashmë ca gozhdë që i ishin ngulur te kupa e gjurit, pastaj vetëm gjilpëra të zakonshme, pastaj ca pickime dhe, më së fundi, pasi bëri nja pesëdhjetë hapa, herë duke kërcyer e herë duke e tërhequr këmbën zvarrë, ndërkohë që dora iu mbush me spica druri nga dërrasat e stazhionuara, ku mbahej, s'ndjeu veçse një të djegur, sikur t'i kishin hedhur ujë të valuar përmbi këmbë. Ajo pak nga pak u bë prapë këmba e tij. Tani, duke e thëthirë me gojën e hapur natën e tërë e duke e nxjerrë pastaj të zbërdhylët, e, megjithatë, terri që i kishte mbetur përbrenda i rëndonte vazhdimisht, ai nisi të ecte me hap të vendosur e të ritmuar, ndonëse ende çalonte. Në duar mbante librat. I vajti mendja te Faberi.

Faberi kishte mbetur aty, në atë bllok sere që nxirrte tym, që s'kishte më as emër e as njihej dot më. I kishin vënë zjarrin edhe Faberit! Papritur e ndjeu veten aq të tronditur nga ky zbulim që bëri, saqë iu duk sikur Faberi kishte vdekur me të vërtetë. I pjekur si një insekt në atë copë lëndë të vogël e të gjelbër, të mbetur në xhepin e një njeriu që tashmë ishte katandisur në një skelet, të cilin s'e linin të shpërbëhej vetëm ato pejëzat e serës.

«Mos e nxirr nga mendja, ja digji ti, ja të dogjën ata, — mendoi me vete. — Tanimë, gjithçka është bërë fare e thjeshtë.»

Rrëmoi nëpër xhepa dhe gjeti aty paratë; në një xhep tjetër gjeti atë kufjen e zakonshme, ku qyteti i fliste vetvetes në atë mëngjes të ftohtë e të mugët.

«Komunikatë e policisë. Kërkohet një njeri që është fshehur brenda në qytet. Është fajtor për vrasje dhe për krim kundër shtetit. Emri, Gaj Montag. Punonte si polic zjarrtar. Për herë të fundit është parë...»

Montagu përshkoi një largësi prej gjashtë bllokesh, gjersa befas rrugica u zgjerua e u kthye në një auto-

stradë të gjerë e të shkretë e ngjasonte me një lumë të gjërë pa barka, të ngrirë nën ndriçimin e qashtër të llampadarëve të bardhë në formë harku. Ka mundësi që edhe të mbytesh, kur të përpiqesh ta kalosh, i tha ai vetes. Ishte tepër e gjerë, tepër e hapur. Ishte një skenë e gjërë, pa perde e pa dekore, që e ftonte ta kapërcente, aty ku ai do të ishte aq i dukshëm nën atë ndriçim verbues, ku aq lehtë mund ta kapnin, ku aq lehtë do ta kishin ta qëllonin me armë zjarri.

Kapsula nisi t'i zukaste në vesh:

«...mos lejoni të shpëtojë një njeri që do të arratiset... kujdes se mos shihni një njeri që vrapon... mos e lini të ikë një njeri të vetëm... në këmbë... që do të arratiset.»

Montagu u tërhoq në hije. Përpara kishte një stacion furnizimi për atutomjete, një godinë të madhe prej porcelani të shndritshëm e të bardhë borë, dhe dy makina ngjyrë argjendi, që ishin ndalur për t'u mbushur me benzinë. Tani, po qe se do të provonte të çapej me nge, pa rendur më, si të kishte dalë shëtitje qetë-qetë nëpër atë xhade të gjerë, atëherë duhej të dukej i pastër dhe i paraqitshëm. I larë e i krehur, do të ishte më i sigurt... po ku do të shkonte?

«Vërtet, — tha me vete, — po nga dreqin do të shkoj?»

Asgjëkundi, s'kishte asnjë vend ku të fshihej, asnjë mik ku me të vërtetë mund të strehohej. Përveç Faberit. Dhe befas vuri re se vetvetiu kishte marrë udhën drejt shtëpisë së Faberit. Po Faberi s'e fshihte dot; kjo do të ishte për të një vetëvrasje. Por e dinte se, sidoqoftë, prapë te Faberi kishte për të shkuar, qoftë edhe vetëm sa për ta parë për ca minuta. Shtëpia e Faberit ishte vendi ku Montagu mund të rifitonte prapë atë besimin për të jetuar, që tani gati sa s'i qe shuar. Thjesht, kishte nevojë të dinte se në botë kishte një njeri si Faberi. Donte ta shihte që ishte i gjallë dhe që s'kishte mbetur i djegur, aty, në atë vend që ai kishte lënë pas, si një trup i mbërthyer pas një trupi tjetër. Dhe një pjesë të paravе, natyrisht, duhej t'ia

linte Faberit, që t'i shpenzonte pasi Montagu të kishte marrë përsëri udhën e arratisë. Mbase mund t'ia arrinte të dilte jashtë qytetit e të jetonte në breg të lumit, apo aty pranë, buzë autostradave, nëpër fusha, nëpër kodra...

Një pështpërimë e fuqishme vorbullitëse e shtyu të ngrinte kokën e të shihte lart nga qielli.

Helikopterët e policisë, që u ngritën në fluturim, ishin aq larg, sa të dukej sikur dikush me një të fyrë të fuqishme kishte hedhur tej e kishte ngritur lart kokën e përhimtë të një lule radhiqeje të fishkur. Ishin njëzet e katër helikopterë që fluturonin, duke valëzuar, të pasigurt, tri milje larg, si ca flutura që vjeshta i kishte trullosur; pastaj, ata ja ku lëshoheshin vertikalisht drejt tokës, njëri pas tjetrit, ca këtu e ca aty, fër koheshin lehtë-lehtë pas xhadeve, ku si të ktheheshin në automobila, kalonin duke fërshëllyer ose, gjithë me po atë shpejtësi, befas çoheshin përpjetë në ajër, që të vazhdonin kërkimin e tyre.

Dhe ja tani stacioni i furnizimit me benzinë: ata që punonin aty, ishin tepër të zënë me punë për të kënaqur klientelën. Montagu hyri nga prapa dhe u drejtua për nga tualeti për burra. Përmes murit prej alumini dëgjoi një zë që po lajmëronte në radio:

«Lufta u shpall.»

Përjashta benzina pompohej në serbatorët e makinave. Njerëzit në makina flisnin me shërbyesit për motora, për benzinën, për paratë që do t'u paguanin. Montagu ndenji një çast duke u rrekur të kuptonte tërë rëndësinë e lajmit që sapo e dha radioja, por ishte e pamundur. Lufta le të priste. Për të ajo do të fillonte pas një apo ndoshta dy orësh.

Lau duart dhe fytyrën pastaj i fshiu mirë e mirë, duke u munduar të bënte sa më pak zhurmë që të qe e mundur. Doli nga tualeti dhe, si e mbylli portën me mjaft kujdes, eci nëpër errësirë, gjersa mbërriti në skaj të xhadesë së shkretë.

E kishte aty, përpara vetes, atë fushë loje, ku atij i duhej të dilte, që ta fitonte ndeshjen, e kishte për-

para atë fushë të gjërë për të luajtur me boçe në atë mëngjes të shkretë. Xhadeja qe e pastër, e qëruar, si ajo sipërfaqja e një arene nja dy minuta para se në të të shfaqen ca viktima pa emër e ca vrasës të panjohur. Ajri i tërë përmbi lumin e gjerë prej çimentoje drithërohej nga nxehtësia që fluturonte nga trupi i Montagut: ishte e pabesueshme ajo që ndiente ai: temperatura e trupit të tij kishte aq fuqi sa të bënte të drithërohej gjithë bota përreth! Ai ishte bërë një shenjë fosforeshente, e dinte këtë, e ndiente. Dhe tani i duhej të niste shëtitjen e tij të vogël përmes rrugës.

Nja tri billoqe shtëpish më tej disa fenerë automobilash shndritnin duke lëshuar fasho drite të palëvizshme. Në mushkëri i bëhej sikur po e fshiknin ca furça, që i përcëllonin gjoksin. Gojën e kishte të tharë. të zhuritur nga gulçimet përvëluese të vrapit. Në fyt ndiente atë shijen e hekurit të ndryshkur. kurse këmbët i bëhej sikur i kishte prej çeliku të ndryshkur.

Ç'donin të thoshin ata fenerë të ndezur? Para se të kalonte rrugën, duhej të përcaktonte mirë se me ç'shpejtësi po aviteshin ato makina. E po mirë. e sa mbante akoma gjer te trotuari tjetër? Nja tetëdhjetë metra, do të thoshe. Po mbase s'ishin tetëdhjetë dhe ai duhej ta llogariste më mirë atë copë udhë, meqë për të, që do të ishte i shtrënguar ta kalonte duke ecur qetë-qetë, pa u ngutur, si një njeri që shkon për qejf të vet, do të duheshin nja tridhjetë, dyzet sekonda për të mbërritur në bregun tjetër të atij lumi çimentoje. Me shpejtësinë që kishin ato makina. brenda pesëmbëdhjetë sekondash do t'i kishin kaluar të tri billoqet e godinave. Prandaj, edhe sikur në mes të rrugës ai t'ia fuste vrapit...?

Hodhi përpara këmbën e djathtë. pastaj të majtën, pastaj prapë të djathtën. Po ecte përmes xhadesë së shkretë.

Edhe sikur krejt bosh të ishte xhadeja. prapë s'ishe dot asnjëherë i sigurt se do ta kaloje pa asnjë rrezik, sepse papritur e papandehur, ja. mund të shfaqej ndonjë makinë në krye të së përpjetës, nja ka-

tër blloqe më tutje, që të të shtypte e të vazhdonte më tej, para se ti të kishe pasur kohë të merrje frymë nja një duzinë herë.

Vendosi të mos i numëronte hapat. Të mos vështronte as majtas e as djathtas. Drita e lampadarit, që varej mbi rrugë, po i dukej e shndritshme dhe zbuluese niëlloj si ajo e diellit të mesditës e gjithë po aq e nxehtë.

Mbajti vesh zhurmën e makinës, që sa vinte e po shtohej nja dy blloqe larg tij, në të djathtë.

Fenerët e saj të lëvizshme befas rrëshqitën sa para mbrapa dhe zbuluan Montagun.

Ai vazhdoi të ecte.

Për një çast ngurroi, shtrëngoi më fort librat, por e detyroi veten të mos rrinte si i ngrirë. Instiktivisht bëri nja tre a katër çape të shpejta, thuajse me vrap, pastaj, duke i folur vetes me zë të lartë, e detyroi prapë veten të ecte me çape të qeta e të ngeshme. Tanimë ndodhej në mes të rrugës, por gumëzhima e motorëve të makinës po bëhej gjithnjë e më e mprehtë dhe vajtuese. sa më shumë që shtohej shpejtësia.

Pa dyshim, policia. Më panë. Ngadalë, ec ngadalë tani, i qetë, mos e kthe kokën, mos shiko mbrapa, mos u duk i shqetësuar. Ec si për shëtitje, a merr vesh? Ec sikur je duke shëtitur me nge!

Makina po e shtonte shpejtësinë. Makina uturinte. Makina nxitohej. Makina rënkonte zëmprehtë. Makina ishte një gjëmim i zgjatur. Makina po mbërrinte rrëshqitazi, si patinat e një hidroplani përmbi ujë. Makina po mbërrinte nëpër një trajektore fërshëllyese, si një fishek i shtënë nga një karabinë që s'dukej. Po vinte me jo më pak se 120 milje në orë. Mbase edhe me 130. Montagu shtrëngoi fort nofullat. Nxehtësia e fenerët që e ndriçonin, i dogji faqet, e detyroi të picërronte sytë. ia shpërndau djersën e dylltë nëpër gjithë trupin.

Montagu nisi të tërhiqte këmbët zvarrë, si ndonjë idiot, pastaj zuri të fliste me vete, gjersa, më në fund, s'duroi dot më dhe ia dha vrapit... E zgjaste ça-

pin sa mundte, e lëshonte poshtë këmbën, e prapë e zgjaste sa mundte, e ulte këmbën përpara e pastaj poshtë! Ja! Zot! O zot! Një libër i ra përtokë. Montagu ngatërroi hapin e për pak sa s'u kthye, por ndërroi mendje, u lëshua prapë përpara, duke uluritur në zbrazëtinë e çimentos, ndërkohë që makina, e ngjashme me një buburec, që, i shpejtë e tërë uri, lëshohet në ndjekje të presë që i ikën, tashmë ishte shtatëdhjetë, tridhjetë metra, njëzet, dhjetë metra larg tij. Montagu gulçonte, i luante krahët si i marrë, njërën këmbë gjithnjë e më përpara, pastaj poshtë, përpara këmbën, poshtë, përpara, poshtë, makina gjithnjë e më afër, ulërimë e burisë, ulërimë e njeriut, sytë që i dogjën nga verbimi i fortë, i bardhë, sapo ktheu një hop kokën të shihte fenerët inkandeshente dhe makinën, që ishte gëlltitur në vetë dritën e vet e s'qe më veçse një pishtar, që po i binte atij përsipër, tërë zhurmë, tërë potere.

Ja, tani e kishte thuajse mbi vete!

Montagu u pengua dhe ra.

Vdiqa! Çdo gjë mori fund!

Por kjo rënie e kishte shpëtuar. Sa qe duke e shtypur, kur befas makina e çmendur kishte marrë kthesën e kishte kaluar mënjanë, mu para tij. Tani s'dukej më. Montagu mbeti ashtu i shtrirë, me fytyrën përmbi rrugë. Ca të qeshura u derdhën mbi të bashkë me gazin kaltërosh të lënë pas nga skapamentoja e makinës.

Dorën e djathtë e kishte të nderë përpara. Tek e çonte atë dorë, mu në majë të gishtit të mesit pa një rripth të zi njëmilimetërsh, shenjë nga goma e makinës. Tek po ngrihej më këmbë. Montagu vështronte atë rripth aq të hollë, pu u zënë dot besë syve.

Nuk ishte policia, tha me vete.

Vështroi xhadenë e gjerë. S'dukej asgjë. Jo, ajo makinë s'kishte qenë e policisë, por kishte qenë e mbushur me djem të moshave të ndryshme, o zot i madh, që nga të dymbëdhjetat e gjer te të gjashtëmbëdhjetat, që kishin dalë të bënin xhiro, që kishin qenë duke ulërirë, duke fërshëllyer, duke bërtitur urra,

kur ja, u kishin zënë sytë një njeri, një njeri që çapej me nge, më këmbë, një gjë vërtet e rrallë, e atëherë kishin thënë: «Ta palosim!»; pa ditur se ai ishte Montagu, që ndiqej; thjesht s'kishin qënë veçse nja katër e pesë djem që kishin dalë për qejf, për të kaluar atë natë me hënë duke udhëtuar për nja pesë ose gjashtëqind milje gumëzhitëse me shpejtësi maramendëse, me fytyrat e ngrira nga era, që pastaj më të gdhirë të ktheheshin në shtëpi apo ndoshta dhe të mos ktheheshin, të ktheheshin të gjallë apo jo të gjallë, se, fundja, këtu qëndronte gjithë bukuria e aventurës.

«Donin të më vrisnin!» — foli Montagu me vete, duke ecur qorrazi, ende me fytyrë të prishur e të tronditur, përmes shtjellave të pluhurit, duke prekur me dorë faqen që i dhimbte. «Donin të më vrisnin pa pasur asnjë arsye.»

Po ecte drejt trotuarit të largët, duke e urdhëruar secilën nga këmbët që të ecte, të vazhdonte të ecte. Kishte bërë si kishte bërë dhe kishte arritur të mblidhte librat e shpërndarë mbi çimento, por vetë s'mbante mend se si ishte përkulur, se si i kishte marrë në dorë. Vazhdonte t'i kalonte nga njëra dorë te tjetra, si të mbante një dorë pokeri që s'donte t'ia shihnin.

Mbase kishin qenë po ata që kishin vrarë Klarisën e shkretë...

U ndal në vend dhe mendja e tij përsëriti fort:

Mbase ishin po ata që kishin vrarë Klarisën!

Donte t'i ndiqte pas duke ulërirë.

Sytë i ishin mbushur me lot.

E kishte shpëtuar ajo rënia e befasishme. Atij që kishte pasur në duar timonin e asaj makine, kur kishte parë Montagun të shtrirë sa gjërë gjatë, instiktivisht do t'i kishte shkuar ndër mend se me atë shpejtësi që kishte makina, po të kalonte mbi atë trup, fare mirë mund të përmbysej. Por sikur Montagu të kishte mbetur një shenjë e drejtë, me këmbët të ngulura mirë përdhe?

Montagu mezi e mbajti një klithmë.

Në fund të rrugës katër blloqe më tutje, makina

e kishte ulur shpejtësinë dhe pastaj, si kishte marrë kthesën mbi dy rrota, tani po drejtohej përsëri për nga ai, duke ecur në krahun e kundërt të rrugës, me shpejtësi që sa vinte e rritej.

Por Montagu tanimë ishte zhdukur, ishte fshehur në hijet e një rrugice, të cilën për ta arritur kishte bërë gjithë atë udhë, aty një orë më parë (apo mos vallë kishte qenë para një minute?). Ndenji e priti duke u dridhur në atë natë të ftohtë, duke zgjatur kokën që të shihte makinën që po kalonte, që mbajti frenat e u ndal në mes të xhadesë, pas një shkarjeje të gjatë, dhe që pastaj, mes gajasjesh të marra, u nis prapë, u zhduk.

Ca më tej, tek ecte nëpër errësirë, Montagut i zunë sytë helikopterët, që zbritnin e zbritnin, si ata flokët e parë të borës të dimrit të gjatë, që ishte më të ardhur...

Shtëpia e gjithë ishte kredhur në qetësi.

Montagu iu avit nga ana e prapme. duke sjellë me vete një kundërmim të fortë lulesh narcisi, trëndafilash dhe bari të qullur nga nata. Provoi portën e prapme prej qelqi, që ishte e hapur, dhe hyri brenda. përshkoi verandën, duke mbajtur vesh.

«Zonja Bleik, je duke bërë gjumë të thellë brenda në shtëpinë tënde, — tha Montagu me vete. — Kjo që po bëj, s'është ndonjë punë e bukur, por yt shoq ua ka bërë të tjerëve, pa ndier asnjëherë ndonjë mëdyshje, ndopak pendim apo ndopak keqardhje. Dhe ja, tani, meqë je gruaja e një zjarrtari, i erdhi radha shtëpisë sate, të erdhi ty radha, për tërë ato shtëpi që yt shoq ka djegur e për tërë ata njerëz, të cilët ai i ka bërë të vuajnë, pa e vrarë mendjen për asgjë.»

Shtëpia nuk u përgjigj.

I fshehu librat në kuzhinë dhe doli prapë në rrugë, ku u kthye e ndenji të shihte shtëpinë: ajo ishte gjithnjë e errët, e heshtur, e kredhur në gjumë.

Pastaj eci përmes qytetit me helikopterët, që valëviteshin lart, në qiell, si ca fletushka të grisura, dhe nga një kabinë e vecuar pranë një dyqani të mbyllur mo-

ri në telefon për të bërë denoncimin. Pastaj qëndroi një çast në mes të natës së ftohtë, në pritje, dhe befas dëgjoi që larg sirenat e milicisë së zjarrtarëve se si po e shtonin vikamën e tyre e po aviteshin, ndiheshin salamandrat që po vinin, salamandrat që ngutëshin të shkonin e t'i vinin zjarrin shtëpisë së Bleikut, që vetë ishte në shërbim, salamandrat e sirenat e tyre që vinin të ngrinin nga gjumi zonjën Bleik, ta linin më këmbë, duke u dridhur e tëra, aty në atë mëngjes të ftohtë, ndërkohë që çatia rrëzohej, shembej përmbi zjarr. Por tani ajo ishte ende e kredhur në gjumë.

«Natën e mirë, zonja Bleik», — mendoi Montagu.

— Faber!

Një tjetër trokitje në portë, një pështëritje, një pritje e gjatë. Më së fundi, një minutë më pas, një dritëz e drithëruar feksi në shtëpinë e vogël të Faberit. Pas pak porta e prapme u hap. Një copë herë Faberi e Montagu ndenjën aty në gjysmëterr, me sytë të ngulur te njëri-tjetri, sikur asnjëri prej të dyve s'po i besonte dot ekzistencës së tjetrit. Pastaj Faberi bëri një lëvizje, zgjati dorën, e kapi Montagun nga jaka dhe e tërhoqi brenda, e uli dhe pastaj u kthye me të shpejtë te porta dhe mbajti vesh. Sirenat sa vinin e dobësoheshin. Po afronte agimi. Më së fundi, Faberi u kthye në sallon dhe mbylli portën.

— S'bëra dot asgjë tjetër veç njërin budallallëk pas tjetrit, — i tha Montagu. — S'duhet të qëndroj shumë këtu. Kam marrë udhën për një zot e di se, ku.

— Së paku ke bërë budallallëqe për gjëra të drejta, — iu përgjigj Faberi. — Të kujtoja të vdekur. Ajo audiokapsula që të kisha dhënë...

— U dogj.

— Dëgjova kapitenin që po të fliste, kur, papritur, s'kuptova dot më asgjë se ç'ndodhi. Gati sa s'dola që të vija e të të kërkoja.

— Biti vdiq. Më zbuloi audiokapsulën, dëgjoi zërin tënd dhe kishte ndër mend ta identifikonte. Atëherë m'u desh ta digjja me flakëhedhësen.

Faberi u ul dhe për një copë herë nuk foli.

— O zot, si ndodhi e gjithë kjo? — foli Montagu. — Dje mbrëma gjithçka ishte më së miri, ndërsa sot e ndiej se më erdhi fundi. Sa herë mundet një njeri t'i afrohet vdekjes, e prapë të mbetet i gjallë? Unë s'mbushem dot me frymë. Biti s'është më, kurse njëherë e një kohë ai ishte miku im. Mili më braktisi e unë kujtoja se ajo ishte gruaja ime; por tani s'jam më i sigurt as për këtë. Shtëpia m'u dogj. Vendin e punës e humba. Tani jam duke ikur për të shpëtuar kokën dhe rrugës për këtu vajta dhe fsheha ca libra në shtëpinë e një zjarrtari. O zot, ç'nuk kam bërë brenda vetëm një jave.

— Ke bërë atë që s'kishe si të mos e bëje. Të gjitha këto njëherë do të ndodhnin.

— Po, ashtu mendoj edhe unë. Ishte diçka që, pa e ditur as vetë, po përgatisja prej kohësh. U mblodh ashtu siç mblidhen paratë që vihen mënjanë, pa u kuptuar, shkoja sa andej këtej, bëja një gjë, kurse në të vërtetë bëja diçka tjetër. Zot, të gjithë këtë e kisha brenda vetes. Çudi është si s'dukej edhe që nga jashtë. Dhe ja, tani jam këtu, që të shkatërroj edhe jetën tënde. Ka mundësi që të më kenë ndjekur kur erdha.

— Për herë të parë në kushedi sa vjet po e ndiej veten të gjallë, — tha Faberi. — E ndiej se po bëj atë që duhet ta kisha bërë këtu e pesëdhjetë vjet. Ka ca kohë që s'kam më frikë. Ndoshta ngaqë tani po bëj atë që duhet. Ndoshta ngaqë tani që përdora dhunën, nuk dua që të më marrin më për një frikacak. Besoj se tani e tutje unë do të bëj gjëra edhe më të guximshme, që janë me rrezik, që të mos kem mundësi më pas të braktis detyrën time e të bie pre e frikës. Po ti ç'mendon të bësh?

— Do të fshihem, do të zhdukem.

— E di që plasi lufta?

— E dëgjova.

— Nuk është për të qeshur? — foli plaku. — Vetëm se ngaqë tani kemi hallet tona, lufta na duket një gjë kaq e largët!

— As që kam pasur kohë për të menduar. — Montagu i zgjati një kartmonedhë njëqinddollarëshe. — Dua që t'i marrësh ti e t'i përdorësh si të të duket më mirë, kur unë të kem ikur.

— Por...

— Gjer në mesditë mund edhe të më kenë vrarë, përdori të paktën këto për çështjen tonë.

Faberi pohoi me kokë.

— Po munde dot, bën mirë të ndjekësh bregun e lumit, gjersa të gjesh atë linjën e vjetër të hekurudhës, që të shpie për në brendësi të vendit. Ndiq hekurudhën. Megjithëse tani praktikisht i gjithë komunikacioni është ajror dhe thuajse të gjitha linjat hekurudhore nuk përdoren më, shinat janë akoma, kanë mbetur që të ndryshken. Kam dëgjuar të thonë se aty-këtu, nëpër gjithë vendin, ka kampe endecakësh, apo ca lloj kampe lëvizëse, siç i quajnë, kështu që, po vazhdove udhën dhe po i mbajte sytë mirë hapur, përgjatë binarëve të hekurudhës së vjetër për në Los Anxheles, me siguri do të gjesh shumë ish-të diplomuar të Universitetit të Harvardit. Pjesa më e madhe e tyre ndiqen nga policia e qyteteve të ndryshme, por megjithatë prapë disa kanë mbetur. Tanimë s'duhet të jenë edhe aq shumë dhe, me sa duket, qeveria s'i ka menduar asnjëherë si ndonjë rrezik të madh, aq sa të shohë të nevojshme të dërgojë ndonjë ekspeditë ndëshkuese kundër kampeve të tyre përgjatë hekurudhës. Ti mund të bashkohesh me ta për ca kohë dhe pastaj lidhu me mua në Sent-Luis. Që sot në mëngjes, me autobusin e orës pesë, do të nisem për në Sent-Luis, që të takohem me një ish-tipograf; siç e sheh, edhe unë kam vendosur të dal më së fundi nga strofka! Dhe ke për të parë që këto para kanë për t'u përdorur mirë. Dhe tani, mos do të flesh një çerek ore?

— Jo, është më mirë që të iki.

— Prit të shohim njëherë se ç'bëhet.

E çoi me të shpejtë Montagun në dhomën e gjumit dhe aty ngriti kornizën e një pikture, pas së cilës u duk ekrani i një televizori, jo më i madh sesa një kartolinë postale.

— Gjithmonë kam dashur të kem një aparat fare të vogël, diçka që, po të dilte nevoja, mund ta fshihja edhe në pëllëmbë të dorës, diçka që të mos ishte si ato paretet ulëritëse, përbindshmërisht të mëdha. Ja e shikon...

E ndezi.

«Montag, — tha TV duke u ndriçuar. — M-O-N--T-A-G.» — Emri u rrokëzua nga një zë autoritar. — «Gaj Montag. Akoma nuk është kapur! Helikopterët e policisë po e kërkojnë. Nga një rajon tjetër u soll një tjetër Zagar Mekanik.»

Montagu dhe Faberi vështruan njëri-tjetrin.

«Zagari Mekanik nuk dështon kurrë. Asnjëherë që nga hera e parë kur u përdor për të kapur prenë, kjo shpikje e pabesueshme nuk ka bërë as edhe një gabim. Sonte rrjeti ynë televiziv është krenar që ka mundësi të ndjekë Zagarin kur ky do të lëshohet kundër presë me anë të një telekamere të montuar në një helikopter».

Faberi nxori dy gota me uiski.

— Të bën mirë.

E pinë.

«... një nuhatje e tillë e hollë si ajo e Zagarit Mekanik është në gjendje të kujtojë e të identifikojë dhjetë mijë lloj erërash të dhjetë mijë njerëzve, pa qenë nevoja për regjistrim të ri!»

Një drithërimë e lehtë përshkoi trupin e Faberit. Ai pa përreth, vështroi shtëpinë e tij, muret, portën, dorezën e portës dhe karrigen, ku atë çast rrinte i ulur Montagu. Montagu e vuri re atë shikim. Pastaj që të dy hodhën edhe një vështrim përqark, dhe Montagu i ndjeu hojëzat e hundës se si iu hapën, sikur ai vetë të ishte duke nuhatur gjurmët e veta, dhe papritur iu duk sikur hunda e tij ndjeu atë shteg që ai kishte

hapur në ajrin e dhomës, ato pikëza djerse që dora e tij kishte lënë mbi dorezën e portës, të padukshme, por të shumta, si ato kristalet e një shandani, pra ai ishte kudo në atë dhomë, brenda, sipër, përreth gjithçkaje, ishte një e re e shndritshme, një fantazmë e shkrirë në ajrin e dhomës. Pa Faberin se si embajti frymën nga frika se mos e tërhiqte atë fantazmë mbi veten, nga frika se mos molepsej nga ai flurim që del prej një njeriu që ikën.

«Zagari Mekanik tani po zbret nga helikopteri në vendin e zjarrit.»

Dhe ja, në ekranin e vogël u duk shtëpia e vogël, turma e mbledhur dhe diçka e mbuluar me një çarçaf, ndërsa nga qielli, si një lule gjigante, duke u dridhur e duke u vërvitur, po zbriste helikopteri.

«Pra, dashkan edhe spektakël, — mendoi Montagu me vete. — Cirku duhet të vazhdojë shfaqjen, paçka se një luftë ka shpërthyer...»

E vështroi atë skenë si i magjepsur, pa qenë i zoti të lëvizte nga vendi: një skenë shumë e largët, që s'ishte pjesë e tij, një komedi që luhej diku, e veçantë, e jashtëzakonshme për ta parë, së cilës s'i mungonte një lloj bukurie perverse. «Dhe e gjithë kjo bëhet për mua, — mendoi, — e gjithë kjo po ndodh vetëm për hirin tim, o zot!»

Sikur të donte, mund të kishte qëndruar aty, i patrazuar, për të parë ndjekjen me të gjitha ato fazat e saj nëpër rrugina, nëpër rrugët e gjera, përgjatë bulevardeve të mëdha, të shkreta, përtej shesheve të ndërtimit e kopshteve për fëmijë, që ndërpritej herë pas here nga ato reklamat e pashmangshme tregtare, pastaj prapë nëpër rrugica të tjera, gjer te shtëpia e Bleikut, e kështu me radhë gjersa të mbërrinte në shtëpinë e Faberit, ku ai me Faberin po rrinin ndenjur duke pirë, ndërkohë që Zagari Mekanik nuhaste atë shteg të hapur tani shpejt, i heshtur si vetë firoma e vdekjes, gjersa befas të ndalej para asaj dritareje, aty, mënjanë. Dhe atëhere, sikur të donte, Montagu

mund të çohej, të shkonte gjer te dritarja, duke mos e hequr njëkohësisht njërin sy nga ekrani i televizorit, të hapte dritaren, duke u zgjatur përjashta, duke e pasur shikimin njëherësh edhe brenda dhomës te ekrani, për të parë veten ashtu të dramatizuar, të komentuar, të transmetuar, ashtu në këmbë pranë dritares, i pikturuar në atë televizor të vogël, që ndriçohej nga jashtë, një dramë që ia vlente ta shihje objektivisht, me vetëdijen se në sallone të tjera kishin për ta parë me ngjyra, në madhësi natyrale, në mënyrë të përkryer nga ana e përmasave! Dhe mjaft që ta kishte shikimin të shpejtë, dhe do të kishte kohë, madje, edhe që ta shihte veten pak çaste para se të humbte në harresë, të shihte se si do t'i futej gjilpëra me prokainë, për hir të gjithë atyre njerëzve të salloneve, që vetëm pak minuta më parë i kishin shqitur nga gjumi ato piskamat e tërbuara të pareteve të salloneve, që të vinin e të admironin atë gjah të madh, atë gjueti njeriu, atë shfaqje madhështore, të luajtur nga një njeri i vetëm.

Kushedi, vallë, në do t'i dilte koha për të mbajtur një fjalim?

Ndërkohë që Zagari do ta mbërthente, në prani të nja njëzet apo tridhjetë mijë spektatorëve, a nuk do të kishte ai mundësi ta përmblidhte gjithë jetën e tij të asaj jave me një frazë të vetme apo qoftë edhe me një fjalë të vetme, që t'u mbeste atyre e ngulitur në kujtesë edhe për mjaft kohë pasi Zagari, si ta rrokte me ato kthetrat e tij metalike, do ta tërhiqte me të shpejtë drejt errësirës? Dhe ndërkohë telekamera do të ishte aty e palëvizshme drejt e mbi bishën, që zvogëlohej në largësi, — ç'fund plot efekt! E ç'mund të thoshte me pak fjalë që të mund t'i plagoste, t'i gërricte të gjitha ato fytyra, që t'i zgjonte të gjithë ata njerëz, që të shihnin realitetin?

— Ja, — belbëzoi Faberi.

Që nga helikopteri rrëshqiti poshtë diçka që s'ishte makinë, që s'ishte kafshë, diçka që s'ishte as e gjallë dhe as e vdekur, nga e cila dilte një ndriçim i

zbehtë i verdhemë. Zagari mbeti për një copë herë aty pranë gërmadhës së shtëpisë së Montagut, që tymoste ndërkohë që njerëzit i avitnin pranë feçkës zjarrhedhësin që kishte lënë Montagu: dhe atëherë u dëgjua diçka si një dridhje e rimtuar, gumëzhitëse.

Montagu tundi njëherë kokën dhe, duke u çuar nga vendi. ktheu pijen që i kishte mbetur në gotë.

— Erdhi koha që të iki. Më vjen keq që për fajin tim...

— Për çfarë të vjen keq? Për mua? Unë meritoj jo vetëm kaq, por edhe më tepër. Por tani, ama, për hir të zotit, vrapo! Kushedi do të mund t'i vonoj një çikë...

— Jo, prit një çast. Nuk ka asnjë dobi që të zbulosh veten. Sa të kem ikur unë, digj kuvertën e këtij shtrati, që e preka unë, edhe karrigen në sallon hidhe bashkë me kuvertën në shkrumbuesin e kuzhinës. Lyej me alkool të gjitha mobiljet, bashkë me dorezat e dyerve. Aparatin e ajrit të kondicionuar hape në maksimum në të gjitha dhomat dhe atë trotuarin para shtëpisë spërkate sa më shumë që të mundësh me pompën automatike të kopshtit. Ndoshta arrin të zhdukësh gjurmët.

Faberi i shtrëngoi dorën.

— Lërma mua këtë. Fat të mbarë. Gaj. Po qe se do të jemi që të dy shëndoshë e mirë, e lëmë të takohemi pas pesëmbëdhjetë ditësh në Sent-Luis, më shkruaj me postën restante. Më vjen keq që kësaj here nuk është e mundur të kemi lidhje me audiofon. Do të ishte diçka me shumë dobi për të dy, por pajisjet e mia teknike gjithmonë kanë qenë shumë të kufizuara. E kupton, as që më kishte shkuar kurrë në mend që do të lindte nevoja për to. Ç'plakush budalla që jam! S'më vinte kurrë në mend! Budalla, budalla kam qenë! Ja, tani nuk kam qoftë edhe një fishekth tjetër të verdhë, të atij tipi që do të na bënte shumë punë. Shko, tani!

— Dhe një gjë! Shpejt! Më duhet një valixhe, ku të vësh brenda gjithë rrobat e tua më të ndotura që ke, një kostum të vjetër, që, sa më i ndotur të jetë, aq

më mirë është, një këmishë, një palë pantallona të vjetra, këpucë...

Faberi sa doli u kthye. Valixhen prej fibre e puthitën buzëve me një shirit ngjitës.

— Që të mos i iki era e parë e zotit Faber, natyrisht, — tha plaku, — i bërë tërë djersë.

Montagu e spërkati pjesën e jashtme të valixhes me uiski.

— S'dua që Zagari të identifikojë dy erëra njëherësh. Mund të marr këtë uiskin? Më vonë kam për t'ia pasur nevojën. O zot, të shpresojmë që gjithçka do të vejë mbarë!

I dhanë edhe njëherë dorën njëri-tjetrit dhe, para se të dilnin nga dhoma, i hodhën edhe një herë sytë nga televizori.

Zagari ishte lëshuar me vrap nëpër rrugicën e parë, i heshtur, e po nuhaste erën e fortë që frynte nëpër natë, i ndjekur pas nga telekamerat e montuara nëpër helikopterë.

— Mirupafshim!

Dhe, duke rendur në majë të gishtave, me valixhen gjysmë të zbrazët në dorë, Montagu doli nga porta e prapme. Nga pas dëgjoi se si u zgjua pajisja e ujitjes, duke paqtuar terrin me një shi të butë, që pas pak u shpërnda përreth si një erashkë, duke përmbytur trotuarin me ujë, i cili pastaj vinte e derdhej si të qe një prroskë në rrugicën nga pas shtëpisë. Montagu mori me vete mbi fytyrë ca pika të këtij shiu. Iu bë sikur e dëgjoi plakun që po i thërriste akoma mirupafshim, por s'qe i sigurt.

U largua nga shtëpia e Faberit sa më shpejt që mundi, duke marrë drejtimin e lumit.

Montagu rendte.

E ndiente Zagarin se si po e mbërrinte, i ftohtë, i pashpirt, i shpejtë, si ajo era aq e lehtë, sa as barin nuk e bën dot të shushurijë, as xhamat e dritareve s'i bën dot të drithërohen, as atë hijen e gjetheve përmbi trotuaret e bardheme, mbi të cilët kalon, s'e trazon. Zagari s'e prekte botën. Me vete mbartte heshtjen, aq sa

e ndieje se si nga prapa teje sa vinte gjithnjë e më shumë shtohej heshtja nëpër tërë qytetin; Montagu e ndiente ngutjen t'i shtohej nga çasti në çast dhe vraponte e vraponte.

Duke rendur në drejtim të lumit, u ndal një grimë sa për t'u mbushur me frymë, sa për të hedhur një sy aty përtej xhamllëkut të ndriçuar të shtëpive që sapo ishin zgjuar, për të parë brenda tyre ravijëzimet e njerëzve, me fytyrat e kthyera nga paretet e salloneve, ku Zagari Mekanik, një firomë avulli neonesh, që përshkonte ekranin si rrufe, herë dukej e herë zhdukej! Tani, ja ku po kalonte nëpër Elm Terrace, nëpër Linkoln, në Oak Park, ja ku po merrte përpjetë rruginës, drejt shtëpisë së Faberit! «Kalo më tej, — mendonte Montagu me vete, — aty mos u ndal, vazhdo, në atë shtëpi mos hyr!»

Mbi paretet e sallonit doli shtëpia e Faberit, me atë makinën, që, duke rregëtirë, spërkaste natën përreth me ujë.

Zagari u ndal duke u dridhur i tëri.

Mos! Montagu e puthiti trupin pas parvazit të dritares. Këtej, këtej duhet të vish! Këtu!

Thumbi me prokainë hynte e dilte, hynte e dilte, si ndonjë kamë. Një pikëz e vetme, e kulluar, e narkotikut të ëndrrave i pikëzonte nga maja e ages, pikërisht atë çast kur ajo zhdukej përsëri në brendësi të feçkës së Zagarit.

Montagu e mbajti frymën, e ndjeu atë në gjoks, si një grusht të mbyllur.

Zagari Mekanik u kthye me të shpejtë dhe u largua nga shtëpia e Faberit, duke u lëshuar sërish tatëpjetë rruginës.

Montagu e çoi menjëherë shikimin drejt qiellit. Helikopterët ishin afruar edhe më, një re e madhe insektesh, të grumbulluara rreth një burimi të vetëm drite.

Me zor, Montagu ia kujtoi vetes se s'ishte duke parë një episod, fryt të fantazisë së ndonjërit, aty në udhën që të shpinte për në lumë; përkundrazi, kjo

ishte loja e tij e shahut, që ai tani po luante me vetë vdekjen, që ai po e vërente se si po luhej lëvizje për lëvizje.

Lëshoi një ulërimë, për t'i dhënë vetes atë impuls të nevojshëm, që të mund të shkëputej nga kjo dritare e fundit dhe nga ajo shfaqje magjepsëse, që zhvillohej përtej saj dhe ja, përsëri ishte larg prej andej, në atë rendje të dëshpëruar. Rrugina nga prapa shtëpisë, një rrugë, rrugina, prapë një rrugë, dhe, më së fundi, era e lumit. Njëra këmbë i shtrihej përpara sa mundej më shumë, pastaj ajo ulej, përpara këmba tjetër, ulej, përpara, ulu, përpara, ulu. Njëzet milionë Montagë, të lëshuar në atë vrap të marrë, do të dilnin ekraneve, nëse telekamerat do të mbërrinin, më së fundi, ta inkuadronin. Njëzet milionë Montagë, që iknin, që iknin nga sytë këmbët, si në ata filmat e vjetër komikë, ku policë e hajdutë, ndjekës e të ndjekur, gjahtarë bashkë me prenë e vet, që të gjithë silleshin e silleshin vërdallë në një karosel të marrë. E kishte parë me mijëra herë ai këtë skenë. Nga pas, tani kishte njëzet milionë Zagarë, që heshtazi lehnin, që kërcenin nga njëri ekran i salloneve te tjetri, nga pareti i djathtë tek ai që ishte në qendër e prej aty në të majtin, dhe pastaj zhdukeshin, e prapë shfaqeshin në faqen e djathtë, në të qendrës, në paretin e majtë, ja, u zhdukën! Montagu futi në vesh fishekthin e kufjes së radios:

«Policia porosit gjithë banorët e lagjes «Elm Terrace» të veprojnë si vijon: të hapin portat kryesore dhe ato të prapme të shtëpive dhe të bëjnë roje në dritaret. Po qe se secili, duke nisur që nga ky çast, do të vrojtojë mirë copën e rrugës që ka para shtëpisë së tij, krimineli nuk ka se si të na shpëtojë. Këtë duhet ta bëni të gjithë në-një kohë. Jeni gati?»

Po, natyrisht! Çudi si s'u kishte vajtur në mend ta bënin këtë punë qysh më parë? Përse vallë s'e kishin provuar ndonjëherë këtë lojë të re për tërë këta vjet? Që nga ky çast, të gjithë do të marrin pjesë në këtë lojë! Tani krimineli s'ka nga ikën! Një njeri

që vrapon i vetëm nëpër qytet, natën, i vetmi njeri që është duke vënë në provë këmbët e veta.

«Tani do të numërojmë gjer në dhjetë! Një! Dy!»

Montagu e ndjeu se si i tërë qyteti u çua në këmbë.

«Tre!»

Montagu ndjeu se si qyteti i tërë vrapoi drejt mijëra dyerve.

Më shpejt! Çoje përpara këmbën, ule shputën!

«Katër!»

E tërë popullata vërtitej nëpër paradhomë, si një mori somnambulësh.

«Pesë!»

Montagu ndjeu se si duart e tyre kapën dorezat e dyerve.

Aroma e lumit ishte diçka e freskët, si e një shiu të rrëmbyer. Për shkak të vrapimit, Montagu e kishte gojën të tharë, të lëmashkët, sytë i digjnin, i lotonin. Lëshoi një ulërimë, sikur ajo ulërimë të kishte fuqinë ta shtynte përpara për të përshkuar ato njëqind hapa të fundit që i kishin mbetur me shpejtësinë e një rakete.

«Gjashtë, shtatë, tetë!»

Në mijëra dyer dorezat u rrotulluan.

«Nëntë!»

Montagu u largua me vrap nga rreshti i fundit i shtëpive... dhe u lëshua poshtë, drejt masës së errët të ujit.

«Dhjetë!»

Portat u hapën.

Montagu përfytyroi mijëra fytyra që vëzhgonin kopshtet para shtëpive, rrugicat pas tyre, qiellin, fytyra të fshehura pas perdeve të zbehta, fytyra të trembura nga nata, si ca kafshë të murrme që rrinë e përgjojnë nga strofullat e tyre elektrike, fytyra me sy të shpëlarë, të hirtë, me gjuhë të hirta, me mendime të hirta, që nxirrnin krye mbi mishin e përgjumur të fytyrave të tyre.

Por tashmë ai kishte mbërritur lumin.

E çiku si për t'u bindur se ishte real.

U fut në ujë e u zhvesh aty në terr, krodhi trupin, krahët, kokën në atë ujë të kulluar; ca ujë e piu e ca e thithi me hundë. Pastaj veshi rrobat e vjetra të Faberit, ato këpucët e tij të vjetra, kurse rrobat e tij i hodhi në lumë dhe ndenji dhe i pa se si u larguan shpejt, përgjysmë të zhytura në ujë. Pas kësaj, duke shtrënguar fort valixhen, bëri disa hapa drejt mesit të lumit, gjersa këmbët s'i çiknin më shtratin, e atëherë rrjedha e ujit e mori me vete në errësirë.

Kishte notuar nja treqind metra në drejtim të rrjedhës së lumit, kur në breg ia mbërriti Zagari. Sipër tij vërtiteshin tërë zhurmë helikat e mëdha të helikopterëve. Një shtrëngatë e tërë drite ra përmbi lumë, dhe Montagu u krodh i tëri nën atë ndriçim të fortë, si të vinte nga vetë dielli, që befas kishte dalë mes reve. Ndjeu se si lumi e mori me vete dhe e çoi më tej, përgjatë rrjedhës, aty ku ishte terri. Pastaj drita u largua përsëri në drejtim të bregut, helikopterët u kthyen për në qytet, si të kishin gjetur një shteg tjetër për të ndjekur; ata po largoheshin dhe shpejt u zhdukën në mes të natës. Edhe Zagari ishte zhdukur. Kishte mbetur vetëm lumi i ftohtë dhe Montagu, që, i çuditur edhe vetë, po notonte i qetë, tutje nga ai qytet, nga dritat, nga ndjekja, tutje nga gjithçka.

I dukej sikur kishte lënë pas vetes një skenë të mbushur plot e përplot me aktorë. Sikur sapo ishte larguar nga një seancë spiritike, nga ato fantazmat e saj murmuritëse. Po shkonte nga një gjendje ireale e frikshme drejt një realiteti që atij i dukej ireal, pikërisht sepse për të ishte diçka e re.

Bregu i errët i lumit i rrëshqiste përbri, ndërkohë që lumi po e shpinte tutje, përmes fushës e kodrinave. Për herë të parë pas aq e aq vjetësh po shihte përmbi kokë yjet, korteun e pafund të zjarreve qerthulluese. Shihte një koçi të stërmadhe yjesh, që rrokullisej nëpër qiell e që i kanosej t'i shembej përsipër e ta bënte copë e çikë.

Po pluskonte përmbi ujë, i kthyer në kurriz, si të qe i vdekur, kur befas ndjeu se valixhja, e mbufatur

nga uji, u krodh brenda; lumi rrokulliste tërë përtim valët e veta, duke e larguar atë gjithnjë e më tepër nga ata njerëz. Lumi ishte tepër real, e përkundte atë tërë kujdes në krahët e vet e i linte kohë të mendohej më nge për tërë atë muaj, për tërë atë vit, për tërë jetën e tij. Ndjeu se si zemra i ngadalësoi të rrahurat. Edhe mendimet e tij tashmë s'po rendnin më me ritmin gulçues të gjakut.

Shikonte hënën që varej në qiell. Kjo ishte hëna, po drita e saj nga vinte vallë? Natyrisht që nga dielli. Po vetë dielli nga e merrte dritën? Nga askush. Ai digjej vetë. Dhe nga dita në ditë dielli vazhdonte të digjej e të digjej. Dielli dhe koha. Dielli, koha, zjarri. Zjarri përvëlues. Lumi po e përkundte lehtë-lehtë dhe po e çonte më tej. Një zjarr që s'kishte të sosur. Dielli lart në qiell, dhe gjithë orët që janë mbi tokë, u shkrinë në mendjen e tij, u bënë një e tërë. Dhe pas kaq vjetësh që jetonte në tokë e nga ajo copë herë aty në lumë, ai e kuptoi përfundimisht se kurrë më në të ardhmen, sa të ishte gjallë, s'duhej të digjte.

Dielli digjte çdo ditë. Ai digjte Kohën. Bota rendte e shpejtë në një elips, duke u vërtitur rreth aksit të vet, ndërsa koha digjte vitet e njerëzit, digjte veten e vet e për këtë s'kishte nevojë për ndihmën e tij, të Montagut. Ndaj dhe në se ai, Montagu, bashkë me zjarrtarët e tjerë do të vazhdonin të digjnin gjërat që kishin krijuar njerëzit, ndërkohë që dielli do të digjte Kohën, atëherë s'kishte për të mbetur më asgjë prej gjëje!

Njëra prej të dyja palëve duhej të ndalonte. E, meqë natyrisht këtë s'do ta bënte dielli, atëherë duhej ta bënte Montagu bashkë me ata njerëz, me të cilët kishte punuar gjer para pak orësh. Diku duhej prapë të fillonte mbledhja dhe ruajtja e vlerave që kishte krijuar njeriu, kudo që ato të ndodheshin, në librat, në regjistrat, në kujtesën e njerëzve, duheshin ruajtur ato nga mola, nga ndryshku, nga myshku e nga njerëzit e armatosur me shkrepëse. Bota ishte e mbushur plot me zjarre të mëdha dhe të vogla. Dhe tani

punëtorët e endjes e të thurjes duhet t'ia nisnin sa më shpejt punës për t'i bërë botës një petk të ri, zjarrdurues, prej asbesti.

Ndjeu befas se këmbët i çikën në tokë; shollët e këpucëve, që zunë t'i kërcisnin nëpër gurë e guralecë, ngritën lart rërën. Lumi e kishte nxjerrë në breg.

Përpara vetes pa atë krijesë të stërmadhe e të zezë, pa sy e pa fytyrë, që rendte e rendte, duke përshkuar me mijëra milje, duke kaluar përmes kodrash të gjelbëruara e pyjesh, pa u ndalur asnjëherë, duke pritur me padurim atë, Montagun.

Ngurroi njëherë të dilte nga ato ujëra të qeta. Kishte frikë se mos i dilte përsëri përpara Zagari. Se mos befas shihte barin e bimët të rënkonin kryevarura nën erën e madhe që sillte reja e helikopterëve.

Por në rrafshirë s'ndihej asgjë tjetër veç flladit të zakonshëm vjeshtak, që rridhte i qetë, njëlloj si edhe lumi. Përse vallë Zagari s'po dukej asgjëkundi? Përse kërkimet kishin zënë të bëheshin prapë në drejtim të qytetit? Montagu mbajti vesh. Asgjë s'ndihej.

«Mili, — mendoi me vete. — Shiko këtë fushë, këtu përreth. Dëgjo! Çfarë qetësie! Asgjë s'ndihet. Mili, nuk e përfytyroj dot ç'do të bëje ti në një rast si ky! Mos vallë do të zije t'i ulërije heshtjes: «Pusho! Pusho! Ah, Mili, Mili!» Dhe Montagu e ndjeu veten të trishtuar.

As Mili nuk ishte aty, as Zagari, por vetëm aroma e thatë e sanës që vinte nga kushedi se ç'fushë e largët e që e bënte Montagun të zbriste sërish përmbi tokë.

Iu kujtua ajo ferma që kishte vizituar njëherë, kur kishte qenë fare i ri, në një nga ato ditët e rralla, kur ai kishte parë me sytë e tij se si dikur, pas atyre shtatë vellove të irrealitetit, mbrapa pareteve televizive të sallonit, matanë Kështjellave të kallajta të qyteteve, kishte një tjetër botë, ku lopët kullotnin në barin e lëndinave, ku derrat leroseshin në mesditë në pellgje me ujë të ndenjur e qentë lehnin duke u vajtur nga pas deleve bardhoshe.

Dhe ja tani, ishte kjo aromë e thatë sane. kjo për-

kundje e lehtë e ujit, që i shtinë ndër mend të vinte e të flinte në mes të sanës së freskët të një plevice të veçuar, larg nga xhadeja poteremadhe, aty prapa një ferme të paqtë, nën një mulli ere të vjetër, që dridhej i tëri tek vërtitej duke kërkëllitur përvajshëm për vitet që shkonin. Për tërë natën ai do të rrinte shtrirë aty lart, në plevicë, duke mprehur veshët të dëgjonte angullimat që vinin nga kafshë të largëta, nga drurë e insekte, të dëgjonte dridhjet e frushkullimat e lehta të krahëve.

Por gjatë natës, mendoi ai me vete, ndoshta do të dëgjonte ndonjë zhurmë si ajo e hapave që ecin vjedhurazi. Dhe ai, me një nderje të beftë, do të çohej ndenjur. Por zhurma do të qe shuar, dhe atëherë ai, disi i qetësuar, do të hidhte një sy jashtë dritares së plevicës e aty, mes territ të thellë, do të shihte se si fikeshin njëra pas tjetrës dritat në shtëpinë e fermerit, kurse më pas, në një dritare pa dritë, do të dilte një vashëz shumë e bukur, që do të zinte të mblidhte flokët gërshetë. Ishte e vështirë ta shihje, por prapë fytyra e saj seç i kujtonte fytyrën e asaj vajzës që kishte ikur e s'kthehej më, por që ndodhej diku thellë në qenien e tij, atë vajzë që i ngazëllohej natyrës, që s'e kishte prekur zjarri i zjarrtarëve, që kishte ditur se ç'donte të thoshte po të fërkoje pas gushës një lule radhiqeje. Pastaj ajo do të zhdukej nga ajo dritare dritëpakë e do të shfaqej më sipër, në dhomën e saj të zbardhëllyer nga hëna. Dhe, më së fundi, nën zërin e vdekjes, nën ulërimën e avionëve reaktivë, që e shqyenin qiellin në dy pjesë të zeza, gjer tutje, në fund të horizontit, ai do të vazhdonte të rrinte i shtrirë përmbi barin e thatë, i siguruar e i fshehur mirë, e do të shihte prej andej se sa të çuditshëm e të panjohur do t'i dukeshin ato yje aty në fund të qiellit, që do të zhdukeshin dalngadalë për t'i lënë vendin dritës së ëmbël të agimit.

Në mëngjes s'do të ndiente më gjumë, sepse ajo mori aromash të këndshme e ato vegime të paqta të

tërë asaj nate të shkuar në fshat do ta kishin çlodhur, njëlloj sikur të kishte fjetur me sytë hapur, kurse goja do t'i hapej nga një buzagaz i lehtë.

Dhe ja, aty përfund shkallëve të plevicës, do ta priste edhe një gëzim tjetër, diçka e pabesueshme. Ai do t'i zbriste ato tërë kujdes, njërën shkallinë pas tjetrës, nën dritën e kuqërreme të agut të parë, gjersa do të ndalej përmbi një mrekulli të vogël, që do të përkulej e do ta prekte: një gotë me qumësht të freskët, të ftohtë, ndonjë mollë, ca dardha e prisnin aty në fund të shkallëve.

Kaq donte ai. Një shenjë që t'i rrëfente se bota e madhe e mirëpriste, e pranonte dhe i jepte gjithë atë kohë që do t'i duhej për të menduar gjithçka duhej menduar.

Një gotë qumësht, një kokërr mollë, një kokërr dardhë.

Ai doli nga lumi.

Toka i vërshoi përballë, njëlloj si dallgët e një deti. Atij iu bë sikur u dërrmua nga ajo dyndje e territ, nga pamja e fushës që kishte përreth, nga ato miliona aroma që vinin me krahët e erës vjeshtake, që i fusnin të ftohtin. Ai u zmbraps nga terri, nga ato zhurma, nga ato erëra, me një gumëzhimë të madhe në vesh. Gjithçka i sillej vërdallë. Yjet rrëzoheshin drejt tij si meteorë të përflakur. Do të donte të kridhej sërish në lumë, që ta linte rrjedhën ta merrte me vete, ashtu lehtë-lehtë, e ta çonte më tej, përgjatë asaj lugine, diku në vend të sigurt. Ajo tokë e zezë, që i ngrihej përballë e që kushedi se nga vinte, i kujtoi Montagut atë ndodhinë e fëmijërisë, kur ai ishte duke u larë në det dhe përmbi të i kishte rënë dallga më e madhe që ai mbante mend ndonjëherë; ajo e kishte shembur në një pështjellim terri të verdhemë e llumi të mjelmët, uji i digjte hundën e gojën, ia trazonte stomakun, mes ulërimash tërë dëshpërim. Shumë ujë kishte pasur atëherë! Shumë tokë kishte tani!

Dhe nga ai muri i errët që kishte përpara, doli

një murmurimë. Një formë. Nga forma, dy sy. Nata ia kishte ngulur sytë. Pylli po e shihte.

Zagari!

Tërë ky vrap, ky stërmundim, të fshihesh kaq larg, të vuash kaq shumë, dhe atëherë, kur veten e quan jashtë rrezikut dhe me një psherëtimë lehtësimi del, më në fund, në breg, të të shfaqet para teje...

Zagari!

Montagu lëshoi një ulërimë të fundit plot dëshpërim, si të donte të thoshte ashtu se kjo ishte me të vërtetë tepër për një njeri.

Por forma u shpërbë menjëherë. Sytë u zhdukën. Grumbujt e gjetheve të thara u shpërndanë, si një dush i thatë shushuritës.

Montagu ishte prapë vetëm mes shkretëtirës.

Një dre. Ishte një dre. Ndjeu aromën e rëndë të myshkut, si një parfum i përzier me gjak, dhe flurinin që dilte nga fryma e kafshës, nga gjithë ato kardamone, myshqe e kryqza fletëgjera të kësaj nate të pafund, kur drurët i suleshin përballë, zmbrapseshin, pastaj prapë nisnin vrapin, e prapë tërhiqeshin, të shoqëruara nga rrahjet e zemrës, që i rektinte aq fort.

Një miliard gjethe duhet të ishin aty, përmbi tokë, ai po kalonte në atë vaun mes tyre, duke trazuar rrëkenë e tyre të thatë, që mbante erë karafil hindi dhe pluhuri të nxehtë. Po ato aromat e tjera! Ishte një si prej patateje të prerë në mes, që çohej thuajse nga të katër anët e dheut të ashpër, të ftohtë, të bardhemë, ngaqë gjatë tërë natës mbi të varej hëna. Ishte pastaj një erë si ajo që del kur hapet një enë me turshi, si dhe ajo e majdanozit në shtëpi mbi tryezën e kuzhinës. Ishte edhe një aromë tjetër e lehtë, si ajo e mustardës. Një tjetër si ajo e karafilave të kopshtit të shtëpisë fqinje. Montagu uli dorën dhe ndjeu se si nën të u shtriq bari, si një fëmijë që po e ledhatojnë. Në gishta i mbeti një aromë jamballi.

Ndenji aty duke thëthirë aromat që vinin nga toka dhe, sa më shumë merrte frymë, aq më shumë mbushej

me gjithë ato çudi të tokës. Montagu tashmë s'e kishte atë ndjenjë boshllëku. Kishte aty, madje, më tepër nga ç'nevojitej për t'u ndier i nginjur. Gjithnjë kishte për të pasur më shumë nga ç'i duhej.

Duke iu marrë këmbët, shkoi e u fut në atë zbaticë gjethesh.

Dhe ja, në mes të gjithë gjërave të panjohura, gjeti diçka të njohur.

Këmba iu përplas pas diçkaje, që nxori një tingëllimë të mbytur.

Atëherë u ul dhe preku me dorë tokën, një metër nga njëra anë, një metër nga ana tjetër.

Linja hekurudhore, që dilte prej qytetit e që e çonte ndryshkun e vet përmes gjysmës së kontinentit, nëpër pyje e korije, tashmë qëndronte e braktisur anës lumit.

Kjo ishte udha që ai duhej të ndiqte, pavarësisht se nga do ta shpinte. Ja ku ishte ajo gjë e njohur, e vetmuar, ajo joshje aq magjiplote, që ai do të kishte nevojë ta prekte herë pas here, që të bindej se e kishte aty, nën këmbë, se po i printe përmes dritave dhe pellgjeve të aromave, të ndijimeve e ledhatimeve, mes shushurimave dhe mërmërimave të gjetheve.

Po ecte përmbi shinat.

Dhe u habit kur papritur e papandehur kuptoi se sa të sigurt e ndiente veten për një fakt të cilin kurrë ndonjëherë s'do të mund ta provonte. Se njëherë e një kohë, por, ama, shumë e shumë kohë më parë, Klarisës i ishte dashur të ecte këtu, ku ai po ecte tani.

[redacted]

Gjysmë ore më pas, tek po dridhej i tëri nga të ftohtët, duke ecur me kujdesin më të madh mbi binarë, thellësisht i vetëdijshëm që kishte një trup, një

fytyrë, gojën e sytë të mbushur me errësirë, veshët që i kumbonin plot tinguj, këmbët të gërvishtura nga ferrat dhe nga hithrat, befas i zunë sytë përpara vetes një zjarr.

Ishte një zjarr, që dukej e zhdukej, si të qe dikush që po ia bënte me sy. Ai u ndal, si të kishte frikë se mos e shuante atë zjarr me frymën e tij. Por zjarri ishte real dhe ai iu avit tërë kujdes, ashtu larg e larg. Iu desh nja një çerek ore gjersa iu afrua disi, dhe atëherë u ndal për ta përgjuar, pa e diktuar kush. Ajo luhatje e lehtë e flakës, ai ngjyrim bardhë e kuq zbulonin para tij një zjarr të çuditshëm, sepse zjarri për të ishte diçka krejt tjetër.

Dhe me të vërtetë, ai pa shumë duar të zgjatura drejt ngrohtësisë së flakëve, duar pa krahët, që kishin mbetur të fshehur në hije. Mbi duart, fytyra të palëvizshme, që luanin vetëm me hovje të befta, bashkë me ndriçimin e zjarrit. Montagu asnjëherë s'e kishte ditur që zjarri mund të ishte edhe i tillë. As që i kishte shkuar ndonjëherë ndër mend se zjarri mund të jepte po njëlloj siç merrte. Madje, edhe aromën ai e kishte krejt ndryshe.

Se sa ndenji ashtu duke përgjuar, s'e mori vesh, por seç kishte një ndjim sa foshnjarak, aq edhe të këndshëm, tek e përfytyronte veten si një kafshë që kishte ardhur gjer aty, që nga thellësitë e pyllit, e joshur nga ai zjarr. Montagu ishte një krijesë e mbuluar me gëzof me qime, me ca sy të squllët, me feçkë e me kthetra, që, po qe se do të dergjej përdhe i gjakosur, edhe gjaku i tij do të mbante erë vjeshte.

Qëndroi aty gjatë, duke dëgjuar kërcëllitjen e përzemërt të flakëve.

Një heshtje e madhe ishte mbledhur përreth atij zjarri dhe po ajo heshtje ishte në fytyrat e njerëzve dhe kishte, pra, kohë për t'u ulur ndanë atyre shinave të ndryshkura, nën pemët, e të vështroje prej andej botën, sikur ajo të qe përmbledhur e gjitha në flakët e atij zjarri, sikur bota të mos ishte gjë tjetër veç një copë çelik, që ata njerëz e kishin marrë dhe

e kishin shkrirë që pastaj t'i jepnin formë sërish. Dhe jo vetëm zjarri ishte i ndryshëm aty, por edhe heshtja. Dhe Montagu iu avit asaj heshtjeje aq të re, që kishte të bënte me gjithçka të kësaj bote.

Befas zërat u ndien përsëri dhe ishin zëra që flisnin, por Montagu s'i dëgjonte dot se ç'thoshin. Tingëllima e tyre herë ulej, herë çohej qetë-qetë, dhe ishin ata zëra që po e vërtitnin botën aty nën sytë e tij, dhe po ata që po e vështronin; ata zëra e njihnin tokën, dhe pemët, dhe qytetin, që shtrihej në fund të atyre shinave, pranë lumit. Zërat flisnin për gjithçka, s'kishte asgjë për të cilën ata të mos dinin të flisnin, kjo dukej në atë gjallërinë me të cilën flisnin, dukej në çdo lëvizje të tyre, dukej në atë lëvrim të pareshtur kureshtjeje e mrekullimi që ndihej në ta.

Befas, njëri nga njerëzit ngriti sytë dhe e pa, ndoshta atë çast për herë të parë a ndoshta për kushedi të satën herë, dhe një zë i thirri Montagut:

— E pra, dil tani që andej!

Montagu u zbyth duke u rikredhur në errësirë.

— Të them unë që s'ke pse të kesh frikë! — foli po i njëjti zë. — Këtu je i mirëpritur!

Montagu iu afrua ngadalë zjarrit dhe të pesë burrave të vjetër që po rrinin të ulur përqark tij, të veshur me pantallona ngjyrë blu, me xhupa prej po të njëjtit stof e këmishë blu mjaft të errëta. Montagu s'diti ç'të thoshte.

— Ulu, — foli burri që dukej si i pari i atij grupi. — Do një gotë kafe?

Montagu vështroi lëngun e zi, që nxirrte avull nga një gotë metalike, e zbukuruar me një rrip që e qarkonte si një spirale e që ia zgjatën menjëherë.

Nisi të gjerbte me kujdes dhe gjatë gjithë kohës ndiente se si sytë e atyre njerëzve i ishin ngulitur tërë kureshtje. Kafeja i digjte buzët, por edhe i bënte mirë, sepse e ngrohte. Fytyrat përreth ishin mjekroshe por, ama, ishin mjekra të pastra, të rregullta, edhe duart e atyre njerëzve ishin të pastra. Që të gjithë ishin çuar

nga vendi, si për të pritur një mik, kurse tani u ulën përsëri. Montagu vazhdonte të pinte kafenë.

— Falemnderit, — tha, — ju falënderoj me gjithë zemër.

— Mirë se erdhe, Montag. Mua më quajnë Grenxhër.

Tjetri i zgjati një shishkë të mbushur me një lëng pa ngjyrë.

— Pi edhe një gllënjkë nga kjo. Të ndryshon treguesin kimik të frymëmarrjes. Brenda gjysmë ore era që do të dalë prej teje do të jetë ajo e dy personave të tjerë. Por, kur ke Zagarin nga pas, e mira e të mirave do të ishte ta thaje të gjithë shishkën.

Montagu e piu atë lëng, që ishte shumë i hidhur.

— Do të kutërbosh më keq nga një mace e egër; por, sidoqoftë, më mirë kështu, — foli Grenxhëri.

— Me sa shoh, ma ditke emrin, — tha Montagu.

Grenxhëri dëftoi me gisht një televizor portativ, të vendosur prapë zjarrit.

— Pamë aty se si po të ndiqnin. E morëm me mend se do t'ia mbathje përgjatë lumit, në drejtim të jugut. Pastaj, kur të ndiem se si po rendje andej-këtej, nëpër pyll, si ndonjë dre i dehur, nuk u fshehëm, siç bëjmë zakonisht. Kur pamë helikopterët të ktheheshin mbrapsht, në drejtim të qytetit, e morëm me mend se do të ishe fshehur në lumë. Kur e mendon, të vjen për të qeshur. Ndjekja vazhdon akoma, por, ama, në drejtim të kundërt.

— Në drejtim të kundërt?

— E po, le ta shohim njëherë.

Grenxhëri ndezi televizorin. Pamja që doli ishte një makth, që ai ekran i lëvizshëm, që kalonte nga dora në dorë, dukej sikur e përhapte nëpër pyll.

Një zë po thërriste:

«Ndjekja po vazhdon në lagjet jugore të qytetit. Helikopterët e policisë po grumbullohen në Evënju 87 dhe në Elm Grouve Park.»

Grenxhëri tundi kokën.

— Është një truk, — tha. — Gjurmët e tua ata i

humbën në lumë, por këtë s'e pohojnë dot. Po ata e dinë edhe që s'kanë sesi ta mbajnë publikun të ngrehur edhe për mjaft kohë. Spektakli duhet të marrë fund në një mënyrë të jashtëzakonshme e fare të shpejtë. Që të nisin e të rrëmojnë nëpër lumë, kushedi se sa orë të tjera do të duhen. Kështu që tani janë duke kërkuar një rrugëzgjidhje, që t'u japë fund kërkimeve në një mënyrë sa të kënaqshme, aq edhe të bujshme. Vëreje! Pas pesë minutash krimineli Montag do të jetë kapur!

— Po si?...

— Vështro!

Syri i telekamerës së vendosur në barkun e njërit prej helikopterëve u lëshua me të shpejtë në një rrugë të shkretë.

— E shikon? — murmuriti Grenxhëri. — Ai aty je ti; ja aty, në fund të asaj rruge, gjendet viktima e zgjedhur. E sheh si po zhvendoset telekamera? Kështu krijohet skena; formohet edhe një tension gjithnjë në rritje. E gjithë kjo zhvendosje e telekamerës do të përfundojë me një plan të parë. Në këtë çast ndonjë derdimen do të ketë dalë për të bërë nja dy çape. Një rast tepër i rrallë. Ndonjë tip ekscentrik. Mos kujton ti se policia nuk i njeh zakonet e të gjithë njerëzve ekscentrikë të qytetit, për shembull të atyre njerëzve që u pëlqen të bëjnë shëtitje të gjata në të aguar, thjesht ngaqë ua ka ënda të ecin apo ngaqë vuajnë nga pagjumësia. Sido që të jetë, policia e ka në listat e veta këtë të shkretë prej muajsh, në mos prej vitesh. Fundja, s'i dihet asnjëherë se si mund të hyjnë në punë ca të dhëna të tilla! E, me sa duket, sot qenkan vërtet me dobi. Të bëjnë t'i shpëtosh turpit. Oh, zot, pa shiko!

Njerëzit që ishin përqark zjarrit, u përkulën përmbi ekran.

Në të dukej një njeri që po merrte kthesën e një rruge. Befas në ekran u duk Zagari Mekanik, që ishte lëshuar në një vrap të çmendur. Prozhektorët e helikopterëve lëshuan menjëherë një duzinë kolona drite

trullosëse, që formuan një si farë kafazi përreth njeriut.

Një zë thirri:

«Ja Montagu! Ndjekja mori fund!»

Njeriu i pafajshëm u ndal në vend, i hutuar, me një cigare të ndezur mes gishtërinjve. Çapëleu sytë, kur pa Zagarin, pa e marrë vesh se ç'ishte. Ndoshta kurrë s'e mori vesh ndonjëherë. Njeriu ngriti sytë nga qielli, ku ishin sirenat që vikatnin. Telekamera vazhdonte të afrohej me shpejtësi. Zagari kërceu përpjetë me një ritëm e me një saktësi veprimi që përmbanin në vetvete një bukuri të papërshkrueshme. Ageja e zhveshur u vërvit përpara. Një çast qëndroi ashtu pezull, si të donte t'i linte ata miliona spektatorë të shijonin çdo gjë, atë shprehjen e tromaksur të viktimës, rrugën e shkretë, bishën e çeliktë, të shndërruar tashmë në një predhë që godet me feçkë drejt e në shenjë.

«Montag, mos luaj!» — thirri një zë që lart nga qielli.

Në çast telekamera u hodh mbi viktimën bashkë me Zagarin.

Viktima ishte zënë në një shtrëngim mortar mes Zagarit dhe objektivit, në një vërtitje këmbësh merimange. Njeriu lëshoi një ulërimë. Dhe një ulërimë tjetër. Dhe pastaj një ulërimë të fundit!

Skenë e errët.

Heshtje.

Terr.

Montagu dënesi një herë mes asaj heshtjeje dhe e ktheu kokën mënjanë.

Heshtje.

E, më së fundi, pas një copë here të gjatë pritjeje nga ata njerëz të ulur përreth zjarrit aty në pyll, me fytyrat të ngurosura, në ekranin e errësuar doli një spiker që kumtoi:

«Operacioni i policisë mori fund, Montagu vdiq. Një krim kundër shoqërisë u ndëshkua.»

Terr.

«Tani po ju shpiem në kopshtet e varura të Hotel

Luksit për të parë një gjysmë ore program «Pak para se të gdhihet», një program i...»

Grenxhëri ktheu butonin dhe e shuajti televizorin.

— E vutë re? Fytyrën e atij njeriut asnjëherë nuk e treguan në fokus. Makar edhe miku yt më i ngushtë s'do të ishte i zoti të thoshte me bindje nëse ishe ti aty apo jo. E kishin bërë atë skenë rrëmujë, aq sa ç'duhej që të ngjallej përfytyrimi. Dreq o punë! — murmuriti ai.

Montagu s'foli, por u kthye përsëri dhe ndenji ashtu i ulur, me sytë të ngulitur te ekrani i shuar, duke u dridhur i tëri.

Grenxhëri e çiku pak në krah.

— Mirë se mbërrite mes nesh nga mbretëria e të vdekurve.

Montagu pohoi me kokë e Grenxhëri vijoi:

— Tani ia vlen që ti të njihesh me ne të gjithë. Ky është Fredi Klement, ish-titullar i katedrës me emrin e Tomas Hardit në Universitetin e Kembrixhit, para se ai të bëhej Instituti i Teknologjisë Atomike. Ky tjetri është profesori Sajmons i Universitetit të Los Anxhelesit, specialist për veprën e Ortega i Gasetit; kurse profesori Uest e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në fushën e etikës, të kësaj disipline kaq të lashtë tashmë e të harruar në Universitetin e Kolumbies. Kurse unë kam botuar një libër të titulluar «Gishtat në dorezë. Marrëdhëniet e drejta mes individit dhe shoqërisë», e për këtë, siç e sheh, ja ku më ke këtu. Mirë se erdhe, Montag!

— Por unë s'i përkas kësaj botës suaj, — foli ngadalë, më së fundi, Montagu. — Unë gjatë gjithë jetës sime s'kam bërë veçse idiotësira.

— Oh, kushedi sa herë kemi dëgjuar të flasin kështu. Që të gjithë ne i kemi bërë këto lloj gabimesh që thua ti, ndryshe s'kishim pse të ishim këtu. Sa kohë që ishim vetëm, individë të veçuar, s'ishim të zotë për gjë tjetër veçse të tërboheshim përbrenda vetes. Vite më parë unë e zura me grushte një polic zjarrtar që kishte ardhur të më digjte.. bibliotekën. Dhe që prej

asaj kohe jetoj jashtë ligjit. E pra, do të bashkohesh me ne, Montag?

— Po.

— Ç'ke për të na ofruar?

— Asgjë. Kujtoja se do të kisha t'ju jepja një pjesë të një libri, por tashmë as atë s'e kam më.

— Po si munde ta ruash atë libër?

— E kam këtu, — dhe Montagu preku ballin me dorë.

— Ah, — buzëqeshi Grenxhëri duke pohuar me kokë.

— Pse, ka ndonjë gjë të keqe? Mos ndoshta s'kam vepruar drejt? — foli Montagu.

— Drejt sa s'ka ku të shkojë më drejt, shkëlqyer fare, Montag! — dhe Grenxhëri e kapi fort për supi. — Shëndeti mbi të gjitha.

— Po mua tani s'më kujtohet më!

— S'ka gjë. Në të vërtetë asgjë nuk humbet. Pastaj ne dimë një metodë se si të të çlirojmë nga vështirësitë që ke për të na e transmetuar neve atë që di.

— Por unë jam munduar aq shumë për ta sjellë ndër mend!

— Mos e sfilit veten kot, kur të kemi nevojë, do të të vijë vetë ndër mend. Kujtesa e njeriut i ngjan filmit fotografik, por veç ne e kalojmë jetën duke u munduar të shlyejmë mbresat që kanë mbetur në të. Sajmensi ynë, ky që sheh këtu, ka punuar njëzet vjet të tërë për të zgjidhur këtë problem, dhe kështu tani ne kemi mundësi të ringjallim në kujtesë gjithçka që ke lexuar ndonjëherë. Të pëlqen që në ndonjë nga këto ditë, Montag, të lexosh *«Republikën»* e Platonit?

— Sigurisht.

— Unë jam *«Republika»* e Platonit. Po «Mark Aurelin» të pëlqen ta lexosh? Profesor Sajmonsi është Mark Aureli

— Gëzohem që ju njoh, — tha Sajmonsi.

— Gjithashtu, — foli Montagu.

— Dua të të prezantoj gjithashtu edhe me Xhonatan Suiftin, autorin e atij libri të mbrapshtë politik që titullohet *«Udhëtimet e Guliverit»*, kurse ky tjetri është Çarl Darvini, e ky këtu Ajnshtajni, një mendim-

tar me zemër vërtet të madhe! Të gjithë këtu jemi, Montag.

Të tjerët qeshën me zë të ulët.

— Nuk ka mundësi, — tha Montagu.

— Ka mundësi që ç'ke me të! — ia ktheu Grenxhëri me buzën në gaz. — Sepse edhe ne jemi djegës librash. I lexonim njëherë librat e pastaj i digjnim, nga frika se mos vinin na i gjenin në shtëpi. Mikrofilmat s'na hyjnë në punë, se ne tërë kohën jemi në udhë dhe s'kemi qejf që t'i lëmë mikrofilmat të groposur gjëkundi, e ata të na presin ne gjersa të kthehemi. Le që pastaj kështu gjithnjë ka rrezik që të na zbulojnë! E mira e të mirave është ta mbash gjithçka në kokë, aty ku askush s'ka si të vijë të të shohë se ç'ke a të dyshojë për gjëkafshë! Ne që të gjithë s'jemi gjë tjetër veçse vidha e rrotëza që i shërbejnë historisë, letërsisë, kodeve ndërkombëtare. Kjo është e gjitha. Por tani ka shpërthyer lufta. Ne rrimë këtu në pyll, kurse qyteti është aty përtej, i mbështjellë i tëri me atë mantelin e vet nëmijë ngjyrësh. Ç'mendon ti, Montag?

— Mendoj se ishte një marrëzi e tërë ajo që doja të arrija unë me ato metodat e mia, duke futur libra nëpër shtëpitë e zjarrtarëve, që pastaj të veja dhe t'i denoncoja.

— Ti ke bërë atë që mund të bëje. Sikur të ishte e mundur ta vije në zbatim një gjë të tillë në shkallë kombëtare, kishte për të dhënë rezultate të mrekullueshme. Kurse ne, që na sheh këtu, kërkojmë të bëjmë diçka që është më e thjeshtë e, me ç'na duket neve, edhe më e mirë. Ne duam që të ruajmë të paprekur, të sigurt, atë kulturë, që, pas mendjes sonë, ka për të na u dashur më vonë. Në këtë mënyrën tonë, siç e shoh, ne jemi qytetarë shembullorë, baresim nëpër këto shina të vjetra, netve flemë nëpër kodrinat, kështu që s'i lëmë popullsisë së qyteteve asnjë shkas pse të na trazojë. Herë pas here vijnë e na kontrollojnë, por me vete ne s'kemi asnjëherë asgjë për të cilën mund të na fajësojnë. Organizata jonë

është e shpërndarë, është tepër elastike dhe e shtrirë në të tëra anët e vendit, disa prej nesh kanë qenë të shtrënguar të bëjnë edhe operacione plastike, qoftë në mollëzat e gishtave. Tani na pret një detyrë e tmerrshme, të presim që të fillojë e të mbarojë lufta. Kushedi, mbase atëherë bota do ta ndiejë nevojën edhe për ne.

— Besoni vërtet se atëherë bota ka për t'ju dëgjuar?

— Po qe se s'na dëgjon, atëherë ne do të presim akoma. Do t'ua kalojmë librat bijve tanë, gojarisht, dhe bijve tanë do t'ua lëmë amanet që të bëjnë të njëjtën gjë me pasardhësit e tyre. Natyrisht që në këtë sistem shumë gjëra kanë për të humbur. Por, po qe se njerëzit s'duan, s'ke si i detyron dot që të të dëgjojnë. Por me kohë ata do të vijnë vetë te ne që të na pyesin se ç'ka ngjarë me të vërtetë dhe përse bota nën këtë lloj qeverisjeje u hodh në erë. Kështu nuk mund të zgjatë përjetë.

— Po ju sa jeni?

— Me mijëra, nëpër autostrada, përgjatë hekurudhave të braktisura. Nga jashtë dukemi endacakë, nga brenda jemi në bibliotekë. Kjo s'është një gjë që u mendua e u planifikua që në fillim kështu siç e sheh tani. Gjithsecili kishte nga një libër që donte të mos e harronte kurrë. Ne u takuam me njëri-tjetrin, gjatë atyre njëzet vjetve dhe kështu lidhëm atë rrjetën tonë mjaft të gjerë e elastike dhe hodhëm themelin e një plani. Gjëja më e rëndësishme që na bëri të hiqnim shumë gjersa arritëm ta ngulitnim mirë në kokë, qe bindja se ne vetë nuk ishim kushedi çfarë të rëndësishëm, se ne nuk duhej ta mbanim veten e nuk duhej të hiqeshim si mësues: nuk duhet ta ndienim veten mbi të tjerët. Ne s'jemi veçse kapakët e vëllimeve, e, si të tillë, s'kemi tjetër vlerë veç asaj për të mos e lënë pluhurin të mbulojë librat. Disa prej nesh jetojnë në qytete të vogla, në fshatra. Kreu i parë i «Uolldenit»[1]) të Toro-

1) «Uollden ose jeta në pyje» është titulli i veprës së shkrimtarit klasik amerikan të shek. 19 Henri Devid Toro.

së banon në Grin River, kreu i dytë në Uillou Farm, në shtetin Mein. Djalli e mori, është një fshat në Merilend, që ka vetëm njëzet e shtatë banorë, asnjë bombë s'ka për ta goditur ndonjëherë këtë fshat, ku ruhet përmbledhja e plotë e veprës së Bertrand Rasëllit. Dhe, kur në ndonjë nga këto ditë a në ndonjë nga këto vite lufta do të mbarojë e atëherë po do të mund t'i shkruajmë prapë librat, këta njerëz do të thirren e ata do të vijnë të recitojnë një nga një atë që dinë e ne do t'i shtypim. Pastaj, edhe sikur të ndodhë që terri i një mesjete të re të na detyrojë të fillojmë gjithçka sërish nga e para, pikërisht kjo është ana e mrekullueshme e natyrës njerëzore, që njeriu s'e humbet kurrë kurajën, nuk e lëshon asnjëherë zemra gjer në atë shkallë sa të heqë dorë nga mundësia për të filluar të bëjë gjithçka prapë nga e para, sepse ai e di se sa rëndësi ka, se sa ia vlen ta bësh një gjë të tillë.

— Po tani ç'duhet bërë? — pyeti Montagu.

— Do të presim, — foli Grenxhëri. — Dhe do të zhvendosemi ca më tej, në luginën e lumit, se s'i dihet...

Ai nisi të mbulonte zjarrin me dhe. Të tjerët zunë të bënin po të njëjtën gjë, edhe Montagu bëri si ata, e aty, në shkretëtirën e tyre prej heremiti, njerëzit punuan të gjithë bashkë, me duart e tyre, gjersa e shuan zjarrin.

Tanimë ishin në breg të lumit, nën dritën e yjeve.

Montagu vështroi kuadratin e shndritshëm të orës së dorës. Pesë. Pesë. Pesë e mëngjesit. Një tjetër vit kishte shkuar brenda atij tiktaku të një ore të vetme e aty, pas bregut më të largët të lumit, e priste agimi.

— Pse më besuat kaq menjëherë? — foli Montagu.

Një njeri luajti nga vendi në terrin e dendur.

— Na mjaftoi të të shihnim në fytyrë. Këto kohët

e fundit ma pret mendja se s'e ke parë ndonjëherë veten në pasqyrë. Pastaj qytetit asnjëherë s'i është bërë shumë vonë për ne, aq sa të marrë mundimin të ndërmarrë ndonjë ndjekje kushedi se çfarë për të na dëbuar nga strofkat tona. Fytyra tënde flet shkoqur, për mrekulli.

Po çapeshin përgjatë bregut të lumit, në drejtim të jugut. Montagu përpiqej të shihte fytyrat e njerëzve, ato fytyra të plakura, të lodhura e të rrudhosura, që mbante mend t'i kishte parë nën dritën e zjarrit. Kërkonte në ato fytyra një gjallëri, një vendosmëri, një ngadhnjim në të nesërmen, që zor se mund ta gjente. Ndoshta priste që t'i shihte fytyrat e tyre të shndritnin, të digjeshin nga kultura që fshihnin përbrenda; të ndriçonin si fenerë nga flaka që ruanin brenda. Por i gjithë ndriçimi në të vërtetë s'vinte veçse nga zjarri, kurse këta njerëz nuk dukej të ndryshonin nga të tjerë, që, njëlloj si ata, kishin kryer një udhë të gjatë, kishin kaluar sa e sa vite të jetës së tyre në kërkim të gjërave të mira e të bukura që kishin parë të shkatërroheshin, dhe ja, më në fund, pleq, ata ishin mbledhur që të shihnin se si do të binte perdja e do të shuheshin dritat. Dhe as që ishin të bindur se ato çka ata mbartnin në tru, do të ishin të afta të sillnin një agim që të shndriste me një dritë më të qashtër, nuk ishin më të sigurt për asgjë, veç faktit që ata libra, që rrinin të radhitur në arkivin e fshehur, pas syve të tyre të qetë, ata libra prisnin, ashtu ende të paprekur, prisnin blerësit që mund të vinin më pas, vite e vite më pas, kush me duar të pastra e kush me gishtërinj të ndotur.

Montagu, duke ecur, e kalonte shikimin me të shpejtë sa në një fytyrë te tjetra.

— S'duhet gjykuar libri nga kopertina, — se kush foli.

Dhe të gjithë qeshën mbyturazi, ndërkohë që kishin marrë udhën drejt luginës.

Një piskamë therëse, dhe aeroplanët reaktivë, që vinin nga qyteti, kishin kaluar tutje, atje lart, në qiell, para se ata të kishin pasur kohë të ngrinin makar e-

dhe sytë. Montagu u kthye dhe vështroi për nga qyteti, që ishte shumë larg, atje tej mbi lumë, e që tani s'dukej veçse si një njollë llamburitëse.

— Ime shoqe ndodhet aty, — foli ai.

— Më vjen keq. Në ditët që vijnë qyteti s'do ta ketë jetën shumë të lehtë, — u përgjigj Grenxhëri.

— Është e çuditshme, por unë as që e ndiej mungesën e sime shoqeje, s'ndiej ndonjë gjë kushedi se çfarë, pothuaj se asgjë, — tha Montagu. — S'ka veçse pak minuta që po mendoja se, edhe sikur të ndodhë që ime shoqe të vdesë, unë prapë s'kam për të ndier ndonjë pikëllim kushedi se sa të madh. Dhe kjo nuk është e drejtë! Seç ka brenda meje që nuk shkon.

— Dëgjo, mbamë vesh mirë, — foli Grenxhëri e, si e kapi për krahu, zuri të ecte në një hap me të, ndërkohë që me dorë largonte shkurret, që i pengonin. — Unë isha ende fëmijë kur më vdiq gjyshi, një skulptor i njohur. Por ai s'ishte vetëm skulptor i mirë, por edhe njeri aq shpirtmirë, që kishte aq shumë dashuri për t'i dhënë botës dhe që, në të vërtetë, kishte ndihmuar mjaft për ta bërë më të lehtë mjerimin në lagjen e varfër të qytetit tonë. Bënte lodra për ne dhe kishte bërë një milion gjëra të mira në jetën e vet. Ishte një tip që s'i rrinin duart asnjë çast të qeta, pa bërë ndonjë gjë. E pra, kur ai vdiq, befas unë pashë se nuk isha duke qarë për të, por për gjithë ato gjëra që ai kishte bërë. Qaja, sepse e dija se ai nuk do t'i bënte dot më kurrë ato gjëra, nuk do të skaliste e gdhendte më asnjëherë një copë dru, nuk do të na ndihmonte dot më kurrë të rritnim përlumba në kopshtin e shtëpisë, as do t'i binte dot violinës, ashtu siç dinte t'i binte, aq bukur, as do të na rrëfente më ato gjëra aq për të qeshur. Ishte bërë pjesa jonë gjyshi, e, kur ai vdiq, të gjitha veprimet e tij ngrinë, vdiqën, edhe ato, se s'kishte më asnjeri që t'i bënte njëlloj si i kishte bërë ai. Ai ishte i veçantë, s'ngjante me njeri. Ishte një njeri që i nevojitej shumë jetës. Unë asnjëherë në të vërtetë s'kam arritur ta marr veten që nga vdekja e tij. Mendoj shpesh për tërë ato skulptura të mrekullueshme që nuk e pa-

në dot dritën për shkak të vdekjes së tij. Sa shumë gaz e fjalë të këndshme i mungojnë botës, ngaqë s'është më ai, e sa pëllumba ngrejnë foletë nëpër shtëpi, por s'e provojnë më atë ledhatimin nga duart e tij! Ai i jepte diçka botës. Dhe atë natë kur im gjysh vdiq, bota humbi menjëherë dhjetë milionë vepra të bukura.

Montagu vazhdoi të ecte në heshtje.

— Mili, Mili, — belbëzoi ai, — Oh, Mili!

— Çfarë the?

— Ime shoqe, ime shoqe! E shkreta Mili, oh, e shkreta, e shkreta Mili! S'mbaj mend asgjë të saj. Sjell në mend duart e saj, por, veç, nuk i shoh duke bërë diçka. Shoh t'i varen anash të braktisura o t'i dergjen të flashkëta përmbi prehër, o tek mbajnë një cigare mes gishtave, kjo është e tëra.

Montagu u kthye përsëri dhe pa nga mbrapa.

Po ti, Montag, ç'i ke dhënë qytetit?

Male me hi.

Po të tjerët ç'të kanë dhënë si shkëmbim?

Asgjë.

Grenxhëri u ndal dhe u kthye të shikonte edhe ai nga pas, bashkë me Montagun.

— «Gjithkush duhet të lërë diçka pas vetes kur vdes,» — thoshte përherë im gjysh. — «Qoftë një fëmijë o një libër, o një pikturë, o një shtëpi, o një mur, që e ka ngritur me duart e veta, një palë këpucë të qepura vetë. O një kopsht të mbjellë me djersën e tij. Me një fjalë, diçka që ta ketë prekur dora e tij, diçka për të cilën të na kujtojnë, kur ne të vdesim, që më pas, kur njerëzit të vështrojnë pemën e lulen që ne kemi mbjellë, të na gjejnë edhe ne vetë aty. S'ka rëndësi ajo që bën, — thoshte im gjysh, — mjaft që diçka të ndryshojë nga ajo që ishte para se ne ta preknim, të ndryshojë e të kthehet në diçka tjetër, pasi dora jonë ta ketë lëshuar. Ndryshimi mes njeriut që kufizohet me kositjen e një livadhi dhe një kopshtari të vërtetë që ndron në mjeshtërinë e tyre, — thoshte ai. — Ai që pret barin, është njëlloj si të ishte, si të mos ishte në lëndinë, por, ama, ai që është kopshtar i vërtetë, mbetet aty një jetë të tërë.»

Bredbëri, R.

451° fahrenhajt. (Vitet e Feniksit)
Roman fantastik. E përkth P. Misha [Red.
Y. Doksani] T., «Naim Frashëri» 1983.

188 f.

(Bm.) dhe
(Bv.): 820(73)-31
B 83

Tirazhi 10000 kopje Format 78x109/32 Stash: 2304-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re Tiranë, 1983